



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2012**

**PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
28. JUNA 2012. GODINE**

**QERSHOR - JUNI
2012**

R e n d i i d i t ë s

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Votimi i raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për metrologji,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi,
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave,
9. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

D n e v n i r e d

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Glasanje o izveštaju rada Saveta Kosova za kulturno nasleđe za 2011. godinu,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o ličnoj karti,
6. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama i dopunama Zakona o metrologiji,
7. Prvo razmatranje N/zakona o zdravstvu,
8. Razmatranje predloga-odluke Vlade Republike za imenovanje članova Nezavisnog borda za razmatranje žalbi,
9. Formiranje ad hoc komisije za izbor članova Borda RTK-a.

Seancën e drejton nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI XHAVIT HALITI: Të nderuar deputetë,
Kabinet i Qeverisë,
Të nderuar ministra,
Zëvendëskryeministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Dua të ju njoftoj që janë parashtruar edhe dy kërkesa me shkrim për plotësimin e rendit të ditës për mbledhjen e sotme, të cilat do t'i procedojmë në vijim, sipas procedurave dhe pas miratimit të procesverbaleve. Një kërkesë drejtuar ministrit të Brendshëm ka kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe unë ia kam miratuar që ta bëjë kërkesën në emër të Grupit Parlamentar.

Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, zoti nënkryetar!

Kabinet qeverisë,

Të nderuar kolegë,

Ne kemi një situatë të re të krijuar në Merdar, ku sipas informacioneve sot kemi disa policë të plagosur, prandaj vlerësoj se është me interes të gjithëve, edhe të deputetëve edhe të gjithë qytetarëve që të kërkohet nga ministri i Punëve të Brendshme që të na jap një informacion për rrjedhat e fundit dhe situatën e krijuar. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Besoj që ministri dhe deputetët janë dakord që pas dy pikave të rregullta ta bëjë informimin e duhur.

Po fillojmë me pikën e rregullt:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

I dimë të gjithë rregullat e kësaj pike. Fjalën e ka kërkuar në emër të Grupit Parlamentar, deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Falemnderit, nënkryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Diskutimi im në seancën e sotme për “Rastin Kiçina” padrejtësinë prej më të rëndave në Republikën e Kosovës ndaj Burim e Arsim Ramadanit, Arben e Blerim Kiçinës dhe të tjerëve, shënon një moment kyç, ku institucionalisht duhet të reagojmë për dhënien fund të kësaj historie që zgjati për një dekadë në gjykatat tona.

Është bërë shumë zhurmë dhe nuk është vendosur aspak drejtësi në zbulimin e së vërtetës në këtë proces maratonik që u përmyll dhimbshëm dhe krejtësisht pa argumente. Aq sa ishte monstruoz dhe i shëmtuar, krimi ndaj familjes Hajra, po aq ishte monstruoz dhe krejt i padrejtë procesi gjyqësor i zbardhjes së tij.

“Rasti Hajra” dhe “Rasti Kiçina” janë dy tmerre që për gati 10 vjet shëtitën nëpër terr dhe pa dritë argumentesh nëpër gjykatat tona. Askush s’e zbardhi kurrë krimin mbi një familje dhe kurrë, po ashtu, s’u dëshmua se të dënuarit e këtij rasti janë autorë të vërtetë të tij. Padrejtësia e madhe qëndron në mes këtyre dy çështjeve e mbushur me plot shpifje, me të cilat drejtësia ndërkombëtare dhe vendore u mundua ta mbulojë pazotësinë e saj. Ditë më parë, në mënyrë të ngutshme Gjykata Kushtetuese e Kosovës e shpalli si meritore vendimin e Gjykatës Supreme për “Rastin Kiçina” dhe e hodhi poshtë ankesën e të dëmtuarve të këtij rasti.

Në “Rastin Kiçina” është bërë shkelje e të drejtave të njeriut mbi bazën e një konstatimi jo të drejtë të gjendjes faktike, përkundër faktit se çështja e tyre ka kaluar nëpër të gjitha instancat gjyqësore, jo mbi bazën e rrethanave faktike, por mbi bazën e rrethanave fiktive.

Kodi i Procedurës Penale i parasheh të drejtat e të akuzuarve ose të personave që akuzohen penalisht. Shumë prej këtyre të drejtave për personat që akuzohen janë në lidhje të drejtpërdrejtë me të drejtat bazike për të drejtat e njeriut, të parapara me dokumentin e OKB-së, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe me të drejtën pozitive në Kosovë, Kodin e Procedurës Penale.

Grupi i “Rastit Kiçina” në mënyrë të përsëritur, me shkrim dhe me gojë, dhe nëpërmjet medias shumë herë dhe në mënyrë të argumentuar, ka ngritur para të gjitha instancave në Kosovë, kërkesën për shqyrtimin e drejtë, të paanshëm dhe transparent të çështjes së tyre. Të gjithë e dimë, se këto kërkesa për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm kanë qenë të paraqitura edhe në Gjykatën Kushtetuese, si institucioni më i lartë i së drejtës në nivel të vendit, për shqyrtimin dhe konstatimin e shkeljes së të drejtave njerëzore, procedurën penale kundër të akuzuarve. Fatkeqësisht, në mënyrë të pakuptueshme dhe jo bindëse, Gjykata Kushtetuese i dha rrugë vendimit të padrejtë të Gjykatës Supreme.

Shkelja e të drejtave ndaj Burim dhe Arsim Ramadanit, Arben e Blerim Kiçinës ka të bëjë me faktin se është e vërtetuar gjendja faktike, përkundër faktit se çështja e tyre ka kaluar instancat gjyqësore në mënyrë shumë të lehtë dhe pa shqyrtime serioze, sa i përket trajtimit të drejtës të paanshme të procedurës penale. Trajtimi i kësaj çështje në Kuvendin e Kosovës, në asnjë rast nuk ka për tendencë ndërhyrjen në gjyqësi, por si qëllim do të duhej të ishte ri trajtimi apo gjetja e mënyrave për ndriçimin e fakteve të reja dhe në funksion të vënies në vend të drejtësisë në “Rastin Kiçina”. Nga praktikat gjyqësore të shteteve me sundim të ligjit, kemi marrë mësim se në asnjë proces gjyqësor nuk mund të quhet i përfunduar për disa rrethana të reja, të cilat e vënë në pikëpyetje një vendim gjyqësor të padrejtë.

Krimi ndaj familjes Hajra ka qenë dhe mbetet monstruoz dhe i dënueshëm për ne dhe për çdo qytetar të Kosovës. Krimet të kësaj natyre i japin një imazh tejet të vrazhdë sigurisë së individit, familjes dhe parimeve kryesore të drejtave fundamentale njerëzore.

Gjithsesi, se ky rast është dashur të jetë në top prioritetet e organeve të hetuesisë dhe atyre gjyqësore për gjetjen e autorëve të këtij krimi dhe dënimin e merituar të tyre. Mirëpo, drejtësia në rastin e krimit ndaj familjes Hajra nuk është vënë në vend, përderisa nuk janë gjykuar autorët e vërtetë të këtij krimi. Trajtimi i kësaj çështjeje në Kuvendin e Kosovës në asnjë mënyrë nuk ka dhe nuk do të kishte për qëllim e as që duhet të kuptohet si ndërhyrje në gjyqësi. Kjo është një përpjekje e jona që në një nga seancat e ardhshme të Kuvendit të Kosovës të trajtohet si pikë e veçantë në një debat parlamentar, ku do të ngriheshin çështje lidhur me shkeljet e...

(Ndërprerje nga regjia)

(Pjesë e diskutimit me shkrim)

...konstatuara për “Rastin Kiçina” dhe të nxirren rekomandime përkatëse.

Përndryshe, më lejoni t’ua kujtoj se në historinë e drejtësisë së shteteve ku ka sistem të drejtësisë së zhvilluar, është i njohur sistemi që edhe pas të gjitha procedurave të të gjitha instancave gjyqësore, pas shumë viteve mbajtjeje dhe vuajtje të dënimeve, personat janë deklaruar të pafajshëm duke konstatuar se nuk i kanë kryer veprat me të cilat me aktgjykime të plotfuqishme kanë qenë të dënuar dhe kanë qenë duke vuajtur dënimin për vepra të rënda.

I thërras të gjithë mekanizmat vendorë dhe ndërkombëtarë, që merrem me liritë dhe të drejtat e njeriut, të kyçen dhe të japin opinionet e tyre që ta ndihmojnë debatin dhe të sqarohet çështja sa më drejt që është e mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Falemnderit, zoti kryesues!

Unë e tërheq fjalën time për sot për shkak të gjendjes që u njoftua këtu lidhur me incidentet në kufirin verior të Kosovës. Mendoj që tema që kam dashur për të biseduar nuk i përket ditës sotshme. Faleminderit, shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryesues!

Unë desha të ngre një çështje, çështjen e shtrenjtimit të rrymës, çështje e cila ka të bëjë edhe i prek të gjithë qytetarët e Kosovës dhe ne si parti e kemi pritur me shqetësim këtë vendim të shtrenjtimit të rrymës dhe shpenzimi i energjisë elektrike nga ana e amvisërisë në Kosovë, përbën mbi 54% të tërë shpenzimit.

Prandaj, shtrenjtimi i energjisë, në radhë të parë do t’i godet familjet, një pjesë e konsiderueshme të cilave edhe ashtu jeton në varfëri. në Kosovë. Përveç, përmes faturave më të shtrenjta të rrymës familjet kosovare do të pësojnë edhe nga shtrenjtimi i të gjithë artikujve të tjerë jetësor, të cilët do të përcjellin këtë rritje të çmimit të rrymës. Në njoftim për shtrenjtim thuhet se KEK-u ka kërkuar shtrenjtim prej 23%, ndërsa ZRE-ja ka miratuar 8,9%, por me këtë rast duhet të përkujtojmë KEK-un se nga raportet zyrtare shihet se humbjet në sistemin energjetik për të cilin

është përgjegjës pikërisht KEK-u, shkojnë në 38%, ndërsa humbjet vetëm në Distribucion përbëjnë 17%.

Dhe sa për informim humbjet në shtetet ku sistemi energjetik menaxhohet si duhet dhe funksionon si duhet, humbjet janë vetëm 3 deri 4%. Rritja e çmimit të rrymës nuk reflekton asgjë tjetër, përveç një paaftësi e Qeverisë Thaçi për të reviltazuar këtë sektor strategjik në Kosovë. Në letërën dërguar Fondit Monetar Ndërkombëtar, Qeveria e Kosovës e bën të qartë se do të kërkojë rritjen e çmimit të energjisë për t'i mbuluar problemet me deficitin buxhetor, gjë e cila nuk e ka amnistion Qeverinë nga rritja e rrymës. Nuk është vetëm problemi i KEK-ut apo i ZRE-së, kështu që kjo konsiderohet se është rritje politike e çmimit të energjisë dhe kërkojmë që ZRE para se të aprovojë çfarëdo rritje të udhëzojë KEK-un t'i shfrytëzojë të gjitha masat për përmirësimin e funksionimit të sistemit energjetik. Po ashtu edhe Qeveria që të ketë kujdes edhe ta marrë si prioritet këtë sektor shumë të rëndësishëm për Kosovën dhe për qytetarët e saj.

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Si kryetar i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, gjatë muajve të fundit ia kam dërguar tri letra ministrit të Punëve të Jashtme, zotit Enver Hoxhaj e për të cilat nuk kam marrë përgjigje.

Komisioni për Punë të Jashtme në mandatin e vet e ka mbikëqyrjen e të gjitha proceseve që udhëheq Ministria e Punëve të Jashtme. Më 20 shkurt të këtij viti, ministrit ia kam dërguar një kërkesë për të dorëzuar nga një kopje të të gjitha notave verbale që Ministria e Punëve të Jashtme i ka pranuar deri në atë kohë. Të gjitha ato ishin 88 njohje, pra nga shtetet, të cilat deri më 20 shkurt na kishin pranuar.

Në bazë të nenit 7.9 të Ligjit për qasje në dokumente publike, Ministria ka pasur 7 ditë afat që të më përgjigjet në këtë kërkesë. Kanë kaluar më shumë se katër muaj prejse kjo kërkesë është dorëzuar dhe Komisioni për Punë të Jashtme, përveçse nuk ka pranuar asnjë kopje të notave verbale, nuk ka marrë ndonjë përgjigje lidhur me këtë kërkesë.

Më 27 prill 2012, në mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme ka qenë i pranishëm edhe ministri Hoxhaj. Gjatë kësaj mbledhjeje jemi dakorduar lidhur me disa çështje, të cilat ministri ka premtuar që do t'i dorëzojë në Komision deri në fund të muajit maj. Në vijim i keni kërkesat për të cilat jemi dakorduar.

- 1) Kopjet e notave verbale;
- 2) Strategjia e plotë për njohjet;
- 3) Raporti financiar për fushatën e lobimit jashtë dhe brenda vendit për njohjen e pavarësisë së Kosovës;
- 4) Letrat që ministri ua ka dërguar homologëve të tij në bashkësinë ndërkombëtare për arrestimin e Hasan Abazit, Arben Murselit, dy policëve kosovarë në Dumnicë, Burim Telakut, ekstradimin e Shemsi Nuhiut dhe vrasjen e Selver Haradinajt;
- 5) Plani strategjik për Akademinë Diplomatike.

Edhe për këtë letër, Komisioni për Punë të Jashtme nuk i ka marrë as dokumentet e kërkuara dhe as përgjigje lidhur me pesë çështjet e cekura.

Një arrogancë të tillë që të mos përgjigjet në letrat që ua kam dërguar e ka edhe zëvendëskryeministrja, Edita Tahiri.

Herën e parë dhe të fundit kur ajo erdhi në Komisionin tonë ishte më 8 prill të vitit të kaluar. Po pra, me 8 prill të vitit të kaluar, e jo me 8 prill të këtij viti, pasi edhe kjo do të ishte bukur moti. Më 8 prill 2011, ajo kishte deklaruar që do paraqitet para Komisionit edhe në baza vullnetare sa herë që do të konsiderohet se ka lëvizje rrënjësore për t'u raportuar. Zëvendëskryeministrja ishte ftuar edhe më 24 qershor 2011 të raportonte para Komisionit. Ajo kishte konfirmuar pjesëmarrjen e saj në këtë mbledhje, mirëpo më pak se 24 orë para fillimit ajo e kishte njoftuar administratën se ka pasur një udhëtim urgjent jashtë vendit.

Letra tjetër për të cilën KPJ nuk ka marrë asnjëherë përgjigje nga zonja Tahiri ka qenë lidhur me kërkesën për një kopje të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufijve dhe të marrëveshjes për bashkëpunimin e përfaqësimit rajonal, të dyja këto të arritura me Serbinë në Bruksel. Herën e fundit kur i dërgova ftesë zëvendëskryeministres, Edita Tahiri për dëgjim publik në KPJ ishte më 20 shkurt 2012. Sërish, as nuk erdhi dhe as nuk u përgjigj pse s'po vjen.

Ndërkohë, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri dhe ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj, japin jo vetëm prononcime të shumta, por edhe intervista të gjata për media të shkruara dhe elektronike. Njëkohësisht, ata nuk mungojnë në drekat e darkat e koktejet me ambasadorët e huaj në Prishtinë. Por, nuk është se këta nuk i kanë qejf intervistat dhe diskutimet publike, por nuk i duan ato institucionale, ashtu siç e parasheh edhe Rregullorja e këtij Kuvendi. Dhe, nuk është se këta kanë kohë pak e janë shumë të zënë, por thjesht, nuk duan të bashkëpunojnë dhe as të mbahen përgjegjës te organi më i lartë legjislativ, përfaqësues dhe politik.

Mos përgjigjja e ministrit Hoxhaj dhe zëvendëskryeministres Tahiri, në letrat që ua kam dërguar si kryetar i KPJ, është anashkalim i tyre ndaj Kuvendit dhe komisionit përkatës të tij. Në demokraci, pushteti është me kusht, pra me kusht që do të jetë llogaridhënës. Në njërën anë e kemi pavarësinë tonë të kushtëzuar, në anën tjetër e kemi pushtetin e këtyre të pakushtëzuar, prandaj ky Kuvend s'po mund të jetë vendi i Republikës. Faleminderit!

KRYESUESI. Faleminderit! Zonja Donika Kadaj - Bujupi e ka fjalën, në emër të GP të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

DONIKA KADAJ - BUJUPI: Falemnderit!

I nderuar kryesues!

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të Qeverisë,

I kam marrë dy shishe me vete, njëra është çimento dhe tjetra është klinker.

Dhe këto dy shishe i kam marrë për ta dëshmuar bashkëpunimin ndërmjet një kompanie mashtruese që është Sharrceci dhe një ministreje mashtruese që sot nuk është këtu, e cila javë më parë mori vendimin për favorizimin dhe mbrojtjen e kësaj kompanie, nën pretendimin se bëhet fjalë për prodhues vendorë.

Ky nuk është prodhim vendor, është një material që është marrë në Doganë, që është prodhuar nga “Titani” grek dhe është futur në Kosovë nën masa mbrojtëse me taksën 35% të futur nga kjo Qeveri dhe ministria Kusari. Gjatë gjithë kohës ne kemi dëgjuar fjalën: “mbrojtje e prodhuesit vendor” e në fakt ka qenë e kundërta, favorizim dhe mbushje e buxhetit të një kompanie greke me emrin “Titan” në dëm të buxhetit të Kosovës, i cili për një muaj për shkak të kësaj takse dhe për shkak të këtij vendimi, vetëm nga TVSH-ja do të humbë 1 milion euro dhe ministri i Financave është këtu, le të thotë nëse është e kundërta.

Domethënë, vendim i cili vazhdon të jetë në fuqi edhe sot, edhe pas publikimit të të dhënave nga Dogana, edhe pas gjitha informatave që bëhet fjalë për mashtrim. Ky vendim vazhdon të jetë në fuqi, sepse çdo ditë vonesë ia shton profitin kompanisë mashtruese në 200 mijë euro në ditë dhe rrjedhimisht shton edhe profitin e atij që e ka marrë këtë vendim. Vendimi që është në dëm të konsumatorëve të Kosovës, sepse kompania të cilës Qeveria e Kosovës ia ka dhënë taksën 35%, taksën mbrojtëse, në fakt, në Malin e Zi, e shet një ton çimento për 74 euro, ndërsa në Kosovë, të njëjtin ton çimento e shet për 110 euro dhe kjo është në dëm të konsumatorëve të Kosovës, në rend të parë, kundruall çimentos shqiptar që është për 10% më i lirë. Prandaj në interes të kujt është ky vendim? Definitivisht nuk është as në interes të shtetit, po as në interes të kombit, se të dy shefat e zonjës në fjalë, sa herë kur kanë nevojë të rehabilitohen po shkojnë në Tiranë edhe po flasin për një treg, treg shqiptar. Po tregojnë patriotizëm, e në anën tjetër po i aprovojnë këto vendime. Që bëhet fjalë për mashtrim flet edhe analiza me të dhënat e manipuluar e prezantuar nga MTI, aty te vendi e kam analizën e tyre edhe thotë: “kompania vendore” thotë, kjo s’është kompania vendore, ky rast absolutisht s’ka të bëjë me prodhim vendor- “ka pësuar humbje gjatë vitit të kaluar” - në fakt është e kundërta, nëse i shihni të dhënat e ATK-së neto fitimi i Sharrcemit në vitin e kaluar ka qenë përafërsisht 19 milionë euro dhe kjo nuk është pak.

Po dikush po duket që s’di kur është boll. E në këtë rast as ministria Kusari nuk po din kur është boll. Krejt kjo na çon drejt dyshimit që kemi të bëjmë me një vendim të koordinuar, sepse Sharrcemi këtë vit tri herë e ka rritur çmimin, sepse Sharrcemi e ka rritur çmimin edhe nën masat mbrojtëse dhe ky domethënë që është një veprim i koordinuar ndërmjet ministres dhe Sharrcemit për interesa të ministres.

Unë nuk e di prokurori edhe pse më thanë, po them tash jam deputete kam të drejtë të them, që është shumë i afërt me njërin nga këshilltarët e ministres dhe ne jemi në Kosovë, kjo mund të verifikohet, pse deri më sot nuk e ka nisur hetimin dhe nuk e ka marrë asnjë veprim në këtë drejtim? Çka duhet të ndodhë më shumë që prokurori të zgjohet prej gjumit edhe t’i fillojë hetimet edhe dikush të dalë me duar të lidhura se ky është një krim, krim i organizuar, brirë s’ka, kështu është krimi i organizuar, kur krejt heshtin, krejt e dinë, mediet dalin e thonë, e vendimi vazhdon të jetë në fuqi.

Vetëm pak ditë pas masave mbrojtëse mbi 12 kamionë me çimento me ekstra çmim për Kosovë dhe ndër masa mbrojtëse të ministres Kusari, zihen duke kontrabanduar këtë material. Ky është material që është zënë në doganë. Kjo është çimento, nuk është klinker, nuk është material, nuk është lëndë e parë, por është çimento i gatshëm të cilit i shtohet edhe 20% të hirit të KEK-ut dhe fitohet çimento, që shitet dhjetë herë më shtrenjtë.

Dogana i ka zbuluar 12 kamionë, po Zoti e din sa nuk i ka zbuluar dhe sa kanë hyrë në Kosovë dhe kur ka filluar kjo. Kjo masa tjetër është klinker, që është lëndë e parë dhe edhe pas këtij zbulimi ministria Kusari vazhdon t' i mbajë masat...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete u ka mbaruar koha. Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: I nderuar, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Zëvendëskryeministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më lejoni që sot të përshëndes një vendim që e ka marrë dje Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e rregullt të saj, për ndarjen e 1.600.000 euro për kategoritë e dala nga lufta, ku 1.150.000 euro nga kjo shumë e ndarë, do të shkojnë për t' i siguruar protezat për invalidët dhe veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që janë protezat e teknologjisë së fundit dhe mund të themi lirisht që nuk i ka askush, as në Evropë dhe as në rajon, por janë proteza që mund të gjenden vetëm në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Dhe, gjithashtu 450.000 euro ka ndarë për tretman kurativ për këto kategori. Prandaj, inkurajoj Qeverinë e Republikës së Kosovës konkretisht ministrin Hamza që edhe më tutje të vazhdojë me ndarjen e mjeteve për këtë kategori, sepse vetëm duke vlerësuar kontributin e kësaj kategorie ne do të vlerësojmë lirinë tonë, do të vlerësojmë shtetin tonë dhe do të kemi një të ardhme më të sigurt. Edhe njëherë përgëzoj Qeverinë e Republikës së Kosovës për ndarjen e këtyre mjeteve për kategoritë e dala nga lufta. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Falemnderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ditë më parë u publikua lajmi sipas të cilit një gjyqtar i Gjykatës Komunale të Klinës, do të mund të hynte në librin e rekordeve botërore të Ginisit, sepse dyshohet se për një periudhë dhjetëvjeçare, në bashkëveprim me disa avokatë, ka kryer hiq më pak se 260 vepra penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare dhe si bos i krimit të organizuar, supozohet se ka përfituar mbi 2 milionë euro nga vendimet gjyqësore të paligjshme. Kur njeriu dëgjon se gjyqtari i njërit prej vendeve më të korruptuara në Evropë, ndiqet për një numër kaq të madh të veprave penale, gjithsesi do t' i shtrojë vetes ndër tjera edhe pyetje të këtilla. A thua edhe sa gjyqtar të tjerë të korruptuar ka sistemi ynë gjyqësor? Kush mund t' i zbulojë dhe hetojë gjyqtarët e korruptuar? A mund të luftohet krimi i organizuar dhe korrupsioni me gjyqtarë dhe prokurorë të korruptuar që janë nën hetime? A thua kriminelët e organizuar dhe zyrtarët e korruptuar frikësohen prej gjyqësorit të korruptuar? Pyetja e fundit- a ka shpresë për qytetarin e rëndomtë të Kosovës se do ta përjetojë një Kosovë pa krim të organizuar dhe pa korrupsion?

Por, në tërë këtë masë të lajmeve dhe pyetjeve zhgënjyese për krimin e gjykatësve dhe zyrtarëve të lartë publik, u paraqit edhe një lajm shpresëdhënës, sipas të cilit një pjesë e pasurisë së konfiskuar të gjykatësit të korruptuar, tashmë po futet nën administrimin e shtetit dhe atë: një banesë në Prishtinë në vlerë 125.000 euro, pastaj dy banesa dhe dy lokale në Klinë, kurse bashkëpunëtorit të tij iu kanë konfiskuar 235.000 euro dhe një truall në lagjen Kalabria.

Një fjalë e urtë popullore thotë: “Ishalla e ka ngrehur këmbën e mbarë”, kurse unë po shpresoj që fati i njëjtë do t’i përcjellë edhe shumë zyrtarë të lartë publik, të cilët në formularët e tyre për deklarimin e pasurisë, kanë paraqitur pasuri milionëshe, në formë të shtëpive, banesave, lokaleve, trojeve të shumta për pjesën dërmuese të të cilave dyshohet se e kanë krijuar përmes korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitave të tyre zyrtare. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Falemnderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të mundohem që brenda kohës sime t’i ngre tri çështje. Një është testi kombëtar i maturës, meqë si anëtare e Komisionit për Arsim e pata rastin t’i monitoroj dy komuna: Komunën e Gjakovës dhe Komunën e Deçanit. Më duhet të përmend disa çështje që janë me interes të ecjes para në këtë drejtim. Është një gjë e mirë që ka ndodhur që testi i maturës për dallim nga viti i kaluar është organizuar në dy ditë, por ka shumëçka për t’u diskutuar dhe për të punuar në këtë drejtim në mënyrë që arsimi të ec më tutje.

Në radhë të parë janë hapësirat që edhe vitin e kaluar i kam cekur që aspak nuk përkojnë me ambientin, do të thotë nuk duhet, nuk është një mes ku nxënësit mund të japin kontributin e tyre që kanë mësuar për vite me radhë. Pra, edhe njëherë organizimi i testit të maturës në korridore, në salla të sportit jo vetëm se për një kohë shumë të shkurtër sa unë isha aty krijonte aq shumë zhurmë, sa më besoni unë e kisha të vështirë për të ndejtur aty, e këtë e kam marr edhe prej administratorëve, por duhet të ndikojmë, duhet të mendojmë pak më shumë tek nxënësit sa ndikon ajo, sepse kërkohet një koncentrim. Së pari duhet një koncentrim për të dhënë përgjigje. Pra, një çështje është që nuk duhet të ndodhë herëve të tjera, sepse ambienti është klasa. Dhe, meqë administratorë ka pasur shumë më shumë se vitin e kaluar, ka qenë dashur që testi të mbahet nëpër klasa, një.

Diç tjetër duhet të them se ky test i maturës sugjeroj që të jetë si kriter, do të thotë pikët që arrihen në testin e maturës të jenë si kriter i profilizimit të vetë maturantëve nëpër degët përkatëse, varësisht se ku arrin pikë më shumë në cilat lëndë. Pra, por duhet gjithsesi, prapë them është një sugjerim i imi që të gjithë maturantët të pajisen me diploma, sepse me të vërtetë nuk është në rregull që të mbesin, kemi shumë nxënës, me sa kam informata shumë të sakta, nxënës të shkëlqyeshëm për tri vjet ose katër vjet që kanë pasur fatin dhe nuk kanë arritur ta japin testin e maturës vitin e kaluar. Do të thotë mirë është që të pajisen me diploma dhe pikët të jenë kriter për t’u profilizuar në drejtimet përkatëse e jo të bëjmë pilot- projekte sikur ka ndodhur vitin e kaluar në shkencat natyrore dhe e kam thënë që dyshoj që do të ketë cilësi dhe edhe sot dyshoj mos të rritet prapë ky pilot- projekt, por kur të fillojmë të fillojmë me projekte në tërësi, pa bërë diskriminime.

Kanë qenë edhe disa çështje që e konsideroj se nuk janë të vogla, por duhet të besoj që Ministria i ka parasysh. Kanë qenë disa pyetje me dy alternativa të sakta që besoj që e kanë parasysh këtë gjë, njëkohësisht ka pasur, s'po i përmend lëndët se i kam të gjitha me të dhëna, ka pasur edhe sqarime konkretisht figura në lëndën e matematikës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaku e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: I nderuari nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Ministra, kolegë deputetë,

Siç e dimë të gjithë, ende nuk kemi një ligj që trajton çështjen e veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Këtë çështje e kam ngritur në Kuvend rreth katër muaj më parë për formimin sa më të shpejtë të Komisionit qeveritar për verifikimin e statusit të veteranëve të UÇK-së. Çështje që ishte e përcaktuar me ligjin e miratuar në dhjetor të vitit të kaluar ku ishin trajtuar familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës. Tanimë Komisioni qeveritar ka kohë që është formuar nga njerëz të respektuar dhe kompetent, mendoj. Shqetësimi im është se në fillim të punës së komisionit po dalin vështirësi, të cilat mund ta pengojnë këtë proces që duket paksa edhe i ndërlikuar.

Nuk i shërben procesit as vetë interesave të veteranëve të UÇK-së nëse në këtë kohë kemi polemika rreth kësaj çështje. As nuk është momenti për të adresuar problemin se kush është më shumë apo më pak fajtor për gjendjen e krijuar pas luftës për statusin e veteranit nëse e ka fituar dikush me apo pa meritë atë. Veteranët e vërtetë të UÇK-së, nëse mund të shprehem kështu, kanë nevojë për ligjin dhe kjo është esenciale. Komisioni për verifikim të përshpejtojë punën, të tregojë vullnet dhe gatishmëri që me përgjegjshmëri të bëjë verifikimin e numrit të veteranëve të UÇK-së. Këtu do të veçoja rolin esencial të anëtarëve të Komisionit, me theks të veçantë ata që përfaqësojnë ish zonat operative të UÇK-së.

Komisioni është përcaktues për mbarëvajtjen e këtij procesi më tutje. Njohja dhe verifikimi i statusit të veteranit është në radhë të parë në të mirë të vetë veteranëve dhe të gjithë ata në një formë apo tjetër mund të japin kontribut të madh sa i përket çështjes së verifikimit. Është fyerje për vlerat që i përfaqësojnë veteranët dhe për të gjithë shoqërinë tonë nëse tentohet që në forma të paligjshme nga dikush të shfrytëzohet një status i tillë. Të mundësohet fillimi i përgatitjes së projektligjit në sjelljen e tij sa më të shpejtë në lexim të parë në Parlament. Pastaj, deputetët do të japin gjithë kontributin e tyre në plotësimin dhe amendamentimin e tij, kështu që sa më shpejt të bëhet një ligj i mirë dhe i favorshëm që garanton dinjitetin e veteranit të UÇK-së në vendin tonë. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar për sqarim, ministri i Punëve të Jashtme, zoti Enver Hoxhaj.

MINISTRI ENVER HOXHAI: Falemnderit, zoti kryesues!

I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë, zëvendëskryeministra, ministra,
Shumë të nderuar deputetë,
I nderuari zoti kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme, zoti Kurti,

Më lejoni që të jap një sqarim shumë preciz edhe shumë linear. Pesë kërkesa, të cilat i ka pasur Komisioni për Politikë të Jashtme janë të gatshme dhe arsyeja pse ne deri më tash nuk i kemi dërguar në Komision për Politikë të Jashtme, është më shumë e natyrës teknike. Ju dje e keni pasur një vizitë në Ministri të Punëve të Jashtme, së bashku me nënkryetarin Hydajet Hyseni dhe ne kemi menduar që ju do të keni edhe kërkesa tjera shtesë dhe do të duhej t'i dërgojmë komplet ato materiale në momentin që janë të gatshme.

Do të thotë, arsyeja ka qenë e natyrës teknike, meqë ju së bashku me zotin Hyseni dje keni qenë në Ministri dhe keni biseduar dhe me sekretarin dhe me zëvendësdrejtorin e përgjithshëm.

Së dyti, dua të them që notat verbale për të gjitha shtetet që e kanë njohur Republikën e Kosovë, Ministria e Punëve të Jashtme i ka, ekzistojnë. Askush nuk duhet të dyshojë në to. Nuk kanë qenë të grumbulluara në Ministri të Punëve të Jashtme, është dashur goxha punë që të grumbullohen nga institucionet tjera dhe këto nota po ashtu, do t'i dorëzojmë në Komision për Politikë të Jashtme.

Së treti, strategjia e politikës të jashtme është e plotë, është shumë e detalshme, mirëpo edhe sa i përket notave verbale edhe sa i përket strategjisë për politikë të jashtme e kisha lutur mirëkuptimin e juaj personal edhe institucional dhe gjithë anëtarëve tjerë të Komisionit, të jenë çështje të konfidencës që këto gjëra mos të rrjedhin në gazeta. Nëse del në një medium vendor se si Republika e Kosovës e sheh relacionin me një shtet që nuk e ka njohur Republikën e Kosovës - cilat janë motivet e këtij shteti, pse s'e kanë njohur Republikën e Kosovës? Cilat janë rrethanat e tij të brendshme? Çfarë mendojnë aktorët institucional, elita politike, mendoj që interesi nacional i shtetit të Kosovës dëmtohet. Unë do t'i dorëzoj po kërkoj nga ju publikisht të gjithë, s'po paragjykoj, që këto dokumente të mbestin në konfidencë, në mirëbesim të Komisionit për Politikë të Jashtme. Edhe sa i përket buxhetit të udhëtimeve nuk është ndonjë shqetësim dhe besoj që javën e ardhshme do t'i keni të tëra të plota.

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Kurti, replikë.

ALBIN KURTI: Falemnderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Është e vërtetë që ne dje ishim në Ministri të Punëve të Jashtme si grup punues, sepse ishim për monitorimin e Ligjit për shërbimin e jashtëm dhe unë nuk thashë që kam probleme as me sekretarin e Ministrisë suaj dhe nuk kam probleme as me zëvendësdrejtorin e përgjithshëm. Ata më kanë pritur shumë mirë, por kam probleme në komunikim dhe bashkëpunim me juve, sepse në vend se t'i thoni këto këtu, keni mundur të më përgjigjeni në e-mail.

Pra, unë nuk i kam kërkuar të gjitha notat verbale. Unë kam thënë që ato që i keni të na i sillni, aq sa i keni dhe kur t'i keni. Nëse vinë të tjerat m'i sillni dhe të tjerat. Mandej, informatat, ju e dini shumë mirë se ju kanë rrjedhur prej Ministrisë. Shumë informacione lidhur me politikën e jashtme unë i marr vesh prej medieve ku kanë rrjedhur informacione prej Ministrisë suaj, dhe jo

prej Komisionit tonë. Dhe, së fundi, besoj që nuk ka nevojë për premtime të reja, sepse unë nuk mund t'ju vlerësoj juve më në bazë të premtimeve më të reja kundrejt përvojës të gjatë dhe të hidhur që e kam me juve. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Edhe zëvendëskryeministrja Tahiri dëshiron të japë sqarim shtesë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

I nderuar kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme të Parlamentit, zoti Kurti,

Lidhur me çështjet që i shtruat, më lejoni t'ju jap disa informacione në mënyrë që të plotësohet e vërteta për çështjet e raportimeve pranë Komisionit tuaj. E para dua të them që është e vërtetë që ju më keni ftuar në një takim dhe pastaj ju kam lajmëruar që nuk mund të vijë për shkak të një udhëtimi urgjent dhe kështu ka qenë dhe udhëtimi ka qenë me një çështje prioritare, të cilën në Qeveri e kemi vlerësuar se duhet të realizohet.

E dyta, marrëveshjet e arritura në Bruksel, të gjitha iu kanë dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës. Dhe, më lejoni t'ju tregoj datat për dy marrëveshjet që i shtruat ju. Marrëveshja e IBM-it apo e menaxhimit të integruar të kufirit është dorëzuar më 7 dhjetor 2011, ndërsa marrëveshja për bashkëpunimet rajonale, më 20 mars 2012.

Është e vërtetë që kam pasur një përvojë me ju që keni komunikuar direkt me disa kërkesa tek unë në adresën e e-mail-it, por siç e dini unë ju kam këshilluar se rruga institucionale e komunikimit është që ju duhet t'ju drejtoheni zyrtarisht përmes Kuvendit, Qeverisë së Kosovës dhe më pas ne u përgjigjemi. Ndërsa e-mail-at që vijnë drejtpërdrejt nuk mund të konsiderohen se e respektojnë komunikimin zyrtar.

E fundit, unë kam pasur një paraqitje në komision që ka qenë mjaft e mirë për mendimin tim, i hapur, i gjatë, me shumë pyetje edhe është e vërtetë që në fillim pata thënë që kam vullnet vetë të vijë, por kur i mora 60 pyetje prej juve dhe sidomos ato 20 ku thoshit që duhet të përgjigjem "po" ose "jo", të them të drejtën vullneti im u sfidua. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Për replikë është paraqitur zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryesues!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Bëhet fjalë për 8 prill të vitit të kaluar. Keni pasur së paku 8 raunde, keni pasur gjithë ato marrëveshje edhe nuk e shihni të arsyeshme që të vini sërish në Komisionin për Punë të Jashtme.

Mendoj që kjo është shumë e papërgjegjshme. Na tregoni sot kur do të vini, pra? Dhe, ju nëse keni pritur që unë do t'ju bëj pyetje, të cilat ju do t'ju përpiloni paraprakisht, atëherë ky është fundi i dëgjimit publik. Natyrisht që pyetjet bëhen ashtu qysh nuk i do ai që pyetet, por ai që pyet. Nuk i kam pasur 60 pyetje, ndoshta kanë qenë midis 30-40, por çka edhe nëse janë 60? Ky është interesi i publikut, është interesi i qytetarëve. Ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve të Kosovës në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Letrën që ua kam dërguar ka qenë njëherë me e-

mail e mandej edhe në formë të shtypur. I kam ndjekur edhe rrugët institucionale elektronike edhe ato fizike, mirëpo ju përgjigjeni, për shkeljet me demokraci të procedurave e më pastaj evitoni çfarëdo përgjigje përmbajtësore.

Mendoj që na keni borxh një vizitë në Komisionin për Punë të Jashtme, ku duhet të jepni llogari për marrëveshjet e deritanishme që i keni bërë në emër të shtetit tonë me Serbinë.

KRYESUESI: Falemnderit! Kalojmë në pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Për pikën e dytë janë vetëm tri pyetje, para se ta japë informatën ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, që është pyetje e përgjigje. Për të parën as Dauti, as Agimi nuk janë këtu. Pyetja e dytë është nga deputeti Konjufca për ministrin Hoxhaj. Zoti Konjufca e ka ke fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Falemnderit, kryesues!

Ministër Hoxhaj, gjendja e rëndë sociale dhe ekonomike për të cilën përgjegjëse është natyrisht edhe Qeveria juaj po i shtrëngon shumë njerëz që ta lëshojnë Kosovën dhe të shkojnë në vendet perëndimore, me shpresë që të gjejnë punë dhe t'i mbajnë familjet e tyre, meqenëse në Kosovë është vështirë të gjejmë punë tash.

Por, shumë prej tyre duke kaluar nëpër kufijsh shtetesh të ndryshme ndodh që të kapen nga autoritetet e shteteve përkatëse dhe pyetja ime është: A jeni ju në dijeni se në qytetin Kiskunhalas në afërsi të kufirit me Serbinë, në Hungari i kemi sipas vlerësimeve tona edhe sipas informatave që i kemi rreth 104 shqiptarë të arrestuar, të burgosur, paraburgimi i të cilëve është zgjatur deri në tetë muaj? A keni kontaktuar ju me autoritetet e shtetit të Hungarisë dhe si qëndron puna?

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ENVER HOXHAI: I nderuar, zoti kryesues!

Zëvendëskryeministra, ministra,

Shumë të respektuar deputetë,

Shumë i respektuar deputeti Konjufca,

Më lejoni t'ju informoj që ne jemi marrë si Ministri i Punëve të Jashtme intensivisht me këtë çështje.

Dua t'ju them që numrin që ju e përmendët, se mund të jetë edhe më i madh nuk është ai numër që u përmend, meqë ndryshon vazhdimisht, do të thotë numri si kategori është goxha i ndryshueshëm. Mirëpo, Ambasada e Republikës së Kosovës, në Hungari, në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e IOM-it kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore, praktike që këta njerëz të kthehen sa më shpejt në Republikën e Kosovës. Dua të them që sjellja e autoriteteve hungareze ka qenë shumë korrekte edhe sa i përket kushteve të banimit edhe të strehimit. Dhe, mbi të gjitha ne jemi marrë sidomos që t'i kthejmë në mënyrë sa më të shpejtë, urgjente rastet e personave të mitur dhe rastet e personave të sëmurë.

Dua t'ju informoj zoti deputet Konjufca që janë tri arsye kryesore pse e shtyjnë kthimin e shpejtë të tyre në Republikën e Kosovës. Arsyeja e parë është e natyrës teknike, kompania “Malev” e dimë të gjithë që ka bankrotuar para një kohe, prandaj edhe kthimi direkt nga Budapesti në Prishtinë është bërë shumë më problem se sa ka qenë në të kaluarën, prandaj një pjesë e madhe e tyre janë kthyer përmes Turqisë, përderisa autoritetet turke neve na kanë limituar që të kthehen vetëm 3 persona në ditë, jo më shumë, por vetëm 3 persona në ditë.

Arsyeja e dytë është që kalimi ilegal i kufirit paraqet një shkelje ligjore. Nuk është vepër penale, nuk është ndonjë dënim, mirëpo kjo pastaj i komplikon procedurat e kthimit të tyre dhe arsyeja e tretë është që disa prej tyre mjerisht kanë kërkuar azil dhe kthimi i tyre, do të thotë është shumë problematik.

Ajo se çfarë mund t'ju them është që edhe vitin e kaluar edhe sivjet, ne kemi lëshuar, Ambasada e Republikës së Kosovës në Budapest, ka lëshuar 253 fletudhëtime që të kthehen këta njerëz në Republikën e Kosovës dhe unë kam informata që gjatë këtij viti janë kthyer rreth 117 persona në Republikën e Kosovës. Pas kësaj pyetje parlamentare unë kam kërkuar që të kem telefonatë direkt me ministrin e Punëve të Jashtme të Hungarisë edhe të Turqisë dhe të kërkoj nga të dytë së bashku nga IOM-i që realisht të kthehen gjithë sa më shpejt në Republikën e Kosovës.

KRYESUESI: Falemnderit! Pyetje shtesë, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Sepse, ministër, familjet e tyre janë shumë të shqetësuara natyrisht dhe çka është me rëndësi kjo çështje nuk është se është bërë shumë publike lidhur me angazhimet tuaja në këtë drejtim. Është mirë që t'i bëni sa më publike të mundshme, për arsye se në mënyrë që edhe qytetarët ta dinë se në ç' drejtim po angazhoheni për sa kohë që unë mendoj që nuk është turp për shtetin e Kosovës, si dhe për Qeverinë e Republikës së Kosovës nëse populli e merr vesh që kemi me qindra të burgosur në një shtet në përpjeke për të shkuar në vendet e perëndimit.

Unë mendoj që më turp është për Qeverinë e Kosovës nëse nuk e merr vesh populli që angazhohet në këtë drejtim. Kjo është çështja.

KRYESUESI: Zoti Hoxhaj!

ENVER HOXHAI: Zoti deputet Konjufca, unë nuk kisha hyrë në kategorinë morale. Një gjë mund t'ju them, do të thotë në vlerësim moral, një gjë mund t'ju them që ambasadorja jonë zonja Geci në Budapest dhe një zyrtar i cili e njeh gjuhën hungareze, i cili ka studiuar në Hungari, i cili ka gradën e magjistratit, i cili është pjesë e asaj shoqërie në mënyrë intensive merren me baza ditore me një çështje të tillë.

Përveç kësaj, Ministria e Punëve të Jashtme në baza ditore merret me përfaqësimin e interesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne jemi marrë edhe me evakuimin e njerëzve mbas Pranverës Arabe, me një diasporë të vjetër. Ne merremi me evakuimin e njerëzve edhe nga Siria, tash merremi me shqiptarë që jetojnë në Siri që 70 vjet, 80 vjet jo më me qytetarë të Kosovës që janë në rastet e tilla. Prandaj, ju siguroj që edhe do t'ju dërgoj një raport të detalshëm që ne si Ministri e Punëve të Jashtme do ta ngremë në të gjitha nivelet edhe ministrat e Punëve të Jashtme në vendet tjera e kanë Parlamente edhe pyetje parlamentare. Unë do ta shfrytëzoj këtë pyetje

parlamentare që ta tematizoj edhe më shumë, por dua t'ju them ne kemi ndërmarrë të gjitha masat në baza ditore dhe e monitorojmë këtë çështje në mënyrë të rregullt.

Numri shtohet, ndryshon, por unë ju siguroj që do të kthehen krejt. Mirëpo, një gjë ju premtoj, që do të thotë ambasada dhe ministria ta kryejnë punën e saj.

(Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Ferid Agani.

KYMETE BYTYÇI: Falemnderit, kryetar!

Duke pasur parasysh faktin se pickimi nga rriqrat çdo ditë e më tepër po shkakton lëndime, si dhe po shënon raste të vdekjeve dhe po krijohen trauma në mesin e qytetarëve në zona, në të cilat rriqrat janë më shumë të pranishme dhe infektuese, si në Malishevë, Suharekë, Rahovec e vende të tjera. Atëherë, kërkoj nga Ju, zoti ministër, të më njoftoni se cilat janë masat që ka ndërmarrë Ministria e Shëndetësisë për mundësinë e zhdukjes së rriqrave nga këto zona.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuara zonja deputete,

Së pari, më lejoni të ju informoj për situatën epidemiologjike me ethe hemorragjike sipas raportit të fundit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, të datës 27 qershor, pra dje.

Rasti i parë në këtë vit është konfirmuar nga Laboratori i Institutit Kombëtar, është regjistruar më 17 maj të vitit 2012, kur kanë filluar edhe pickimet nga rriqrat në vatrat endemike të komunave Malishevë dhe Rahovec.

Deri sot janë raportuar 1.754 pickime, prej të cilave 86 raste suspekte me ethe hemorragjike krime-kongo dhe fatkeqësisht dy raste kanë përfunduar me fatalitet.

Sipas Institut Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, si institucion referent i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili jep rekomandime profesionale e shkencore për mbikëqyrjen e epidemive masive, të cilat mund të shkaktojnë pasoja të rënda, situata epidemiologjike është nën kontroll të plotë në vatrat e infeksionit, ndërkaq ekipet e epidemiologëve janë në vazhdimësi në terren bashkë me mjekët dhe punëtorët shëndetësorë të qendrave kryesore të mjekësisë familjare në Malishevë dhe në Rahovec dhe po vazhdojnë mbikëqyrjen dhe hulumtimin epidemiologjik të të gjitha vatrave, përfshirë këtu edhe vatrat endemike të komunave Klinë, Skenderaj, Suharekë dhe Prizren.

Sivjet, që nga janari, drejtoritë komunale të shëndetësisë në Malishevë dhe Rahovec janë në kontakt të vazhdueshëm me Institutin Kombëtar dhe Ministrinë e Shëndetësisë, duke ndërmarrë masa me dezinfektimin selektiv të fshatrave të këtyre dy komunave dhe duke i kryer këto aktivitete që nga fillimi i marsit të vitit 2012.

Deri më sot, ekipet e Institut Kombëtar i kanë mbikëqyrur dhe hulumtuar të gjitha vatrat aktive ku ka pasur pickime të rriqrave dhe kanë mbajtur ligjërata në 44 shkolla të komunës së Malishevës dhe 25 shkolla të komunës së Rahovecit, duke bërë edhe dezinfektimin në të gjitha hapësirat, ku janë regjistruar pickimet nga rriqrat.

Sipas raporteve të Institutit, nga terreni i Malishevës janë spërkatur kryesisht hapësirat publike dhe është shprehur vullneti nga pronarët dhe oborret e tyre. Me spërkatje janë mbuluar 39 zona të planifikuara, e spërkatja është bërë edhe në komunën e Rahovecit.

Në bazë të situatës aktuale epidemiologjike dhe epizotologjike kemi marrë vendim që Ministria e Shëndetësisë të ndajë nga 10 mijë euro për komunat respektive Malishevë dhe Rahovec si ndihmë shtesë në dezinfektimin e vatrave më të prekura nga pickimi i rriqrave.

Në aspektin e kompetencave të aktiviteteve të mbyjtjes së rriqrave, kjo veprimtari koordinohet dhe i takon edhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë së Veterinës, të cilat këtë javë janë duke bërë dezinfektimin dhe dezinfektimin e stallave në të gjitha vatrat e prekura të komunës së Malishevës.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Falemnderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

KYMETE BYTYÇI: Zoti ministër, kjo çështje nuk është që një vit apo dy vjet, por është qysh prej pasluftës, pra do të thotë 12-13 vjet dhe nuk ka pasur trajtim serioz për zhdukjen e rriqrave.

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara zonja deputete, Masat kundërepidemike dhe parandaluese që po bëjmë ne si Ministri e Shëndetësisë në luftimin e rriqrave për ta mbrojtur popullatën e Kosovës nga sëmundja e etheve hemorragjike krime-kongo janë masa, të cilat janë në nivelin e të gjitha shteteve të zhvilluara dhe nuk kanë asgjë të mangët që ne nuk ofrojmë në aspektin profesional dhe shkencor sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Unë fillova të numëroj një seri të masave, mund të jua ofroj edhe informatën me shkrim dhe t'i shihni detajet, por vetëm të përmend se grumbullimi i të gjitha mostrave për diagnostikim laboratorik nëpër laboratorë me standard të pranuar në rang botëror në Institutin Kombëtar, teknologjia e fundit e diagnostifikimit modern dhe konstatimi i diagnozës laboratorike vetëm brenda 4 orëve, duke përcjellë rezultatet laboratorike në Klinikën Infektive në kohën optimale për t'i futur pacientët në terapinë adekuate me

“Ribavirin” tregon për atë që jemi në nivel të standardeve ndërkombëtare në këtë aspekt. Dozat janë të mjaftueshme për të gjithë pacientët e hospitalizuar, edhe pse terapia është ndër më të shtrenjtat. Por, Ministria e Shëndetësisë i ka siguruar të gjitha dozat e nevojshme.

Sa i përket çështjes së dezinfektimit, mos harroni se dezinfektimi nuk është masë e zgjedhjes në ballafaqim me këtë të keqe, sepse rriqrat shumohen në tokë. Ne mund ta shkatërrojmë gjithë botën e insekteve në një zonë, ta shkatërrojmë ekosistemin në atë territor, por nuk do ta parandalojmë këtë sëmundje në atë mënyrë, në qoftë se mbështetemi vetëm në këtë aspekt.

KRYETARI: Falemnderit, ministër! Deputetja Salihe Mustafa, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, e ke fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Zoti ministër, Qendra Emergjente në QKUK e pranon një numër të madh të pacientëve për arsye se në të gravitojnë pacientë nga spitalet rajonale nga i gjithë vendi, po ashtu edhe nga qendrat e mjekësisë familjare në Prishtinë, por shpesh ndodh që pacientët të shkojnë në këtë qendër edhe pa referim.

Duke marrë parasysh numrin e madh të pacientëve, në njërën anë, dhe, në anën tjetër, kapacitetet e pamjaftueshme në hapësirën e kësaj qendre, do të thotë se nuk mund të ofrohen shërbime cilësore pacientëve që vërtet janë raste urgjente.

Pyetja ime, zoti ministër është: A keni ndonjë plan konkret për zgjerimin e kësaj qendre?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Falemnderit, zoti kryetar!

E nderuara zonja deputete,

Keni plotësisht të drejtë. Bëhet fjalë për një pikë neuralgjike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, e cila është identifikuar që herët. Ne aktualisht jemi duke e realizuar projektin e renovimit gjeneral të aneksit ekzistues të Emergjencës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Ky projekt është në implementim e sipër dhe ka për synim zgjerimin e kapaciteteve nëpërmjet ndërtimit të platos dhe mbulesës së saj për qasje në Emergjencë, me sipërfaqe 580 metra², platoja 280 metra², rampat për qasje 350 metra². Zgjerimi i kapaciteteve në bodrumin e kësaj ndërtese në një hapësirë prej 250 metra², ndërtimi i ashensorit për lidhjen e Emergjencës me mjekimin intensiv, aktualisht ku gjendet tash Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, ashensori bën lidhjen direkt të Emergjencës nga niveli i bodrumit dhe përdhese deri te niveli i tretë, mjekimi intensiv, në të ardhmen si dhe renovimi i Emergjencës ekzistuese përdhese në sipërfaqe prej 1400 metra². Të dhënat e cekura në katër pikat janë në shërbim të zgjerimit të kapaciteteve të Emergjencës, rregullimit të komunikacionit për qasje të papenguar në Emergjencë dhe lidhja adekuate ndërmjet Emergjencës dhe mjekimit intensiv.

Shuma investive e këtij projekti është 784 mijë e 679 euro. Pra, kjo është një përpjekje konkrete që jemi munduar ta bëjmë brenda mundësive të buxhetit ekzistues. Ndërsa, Ministria e ka dizajnuar dhe e ka në dispozicion edhe projektin e detajuar për qendrën e re emergjente klinike universitare, për të cilën kërkohet një investim më i madh dhe për këtë jemi në kërkim të donatorëve dhe jemi shumë afër për të siguruar fillimin e realizimit të këtij projekti vitin që vjen. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Deputete, ke pyetje shtesë?

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit për përgjigje dhe është shumë mirë që morëm informatë se po zgjerohet Qendra Emergjente, por zoti ministër, ne si komision, gjatë vizitës në këtë qendër na është thënë se projekti është i gatshëm dhe donatorët janë ofruar. Më intereson saktësisht për projektin e ri dhe për donatorët që na kanë thënë se janë të gatshëm për investim?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Unë ju dhashë informata lidhur me atë se çfarë jemi duke bërë tash konkretisht dhe presim që brenda 2-3 muajve t'i zgjerojmë kapacitetet, së paku në një masë, e cila do ta lehtësojë punën. Sa i përket projektit të ri, unë e thashë se projekti është i detajuar. Ai ekziston dhe prej donatorëve më të mundshëm dhe është identifikuar, e për momentin kemi edhe lajme të mira, pas vizitës së kryeministrit në Mbretërinë e Arabisë Saudite dhe të Bankës Islamike për Zhvillim, se një pjesë e këtij investimi do të sigurohet nga kredia të cilën do t'ia japë Kosovës shumë shpejt dhe do të kemi, sipas bisedës me ministrin e Financave, një bashkëfinancim me një kontribut edhe të Qeverisë së Kosovës, dhe vitin e ardhshëm do të fillojmë ndërtimin e kësaj qendre, e cila është e domosdoshme për Qendrën Klinike Universitare.

KRYETARI: Falemnderit ministër! Nuk kemi pyetje të tjera. Pyetjet e deputetëve që nuk morën përgjigje në dy seanca do të botohen në Buletinin e Kuvendit.

Të nderuar deputetë,

Në ndërkohë janë parashtruar edhe dy kërkesa me shkrim për plotësimin e rendit të ditës për mbledhjen e sotme.

Po para se të vazhdojmë tutje, fjalën e ka ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Falemnderit, i nderuari kryetar i Parlamentit, Kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar deputetë,

Natyrisht që edhe sa po zgjat kjo seancë parlamentare ka shqetësime për ngjarjet që po ndodhin, por për këtë arsye do t'i jap informatat e fundit që i kemi në lidhje me manifestimin e festës së Vidovdanit, që bëhet çdo vit dhe natyrisht që Policia e ka pasur planin detal operativ të përgatitur, i ka ndërmarrë të gjitha masat dhe i vetmi incident deri

tash i lajmëruar është në kufirin në Merdar dhe kronologjikisht dua të ju informoj se një grup huliganësh, diku prej nja 70 vetash, në orët e hershme të mëngjesit, kah ora 5:00, te barrikada e Urës së Ibrit, ka qenë agresiv, kanë gjuajtur me gurë dhe 3 prej tyre kanë depërtuar në Urën e Ibrit dhe Policia natyrisht ka vepruar me sprej, duke i ka kthyer mbrapa. Këta, që kryesisht janë tifoze famëkeq “Delije” të Klubit “Cërvena Zvezda”, që janë të njohur për këso incidente, bashkë me disa të tjerë, me 2 autobusë janë nisur në drejtim të Gazimestanit dhe diku kah ora 6:35 janë ndaluar edhe nga Policia në Vushtrri, të cilët e kanë bërë legjitimimin për arsye se kanë provokuar, kanë fyer gjatë kësaj kohe, kanë bërë legjitimimin e tyre dhe e kanë vërejtur se shumica prej tyre janë në gjendje të dehur, kanë provokuar, e kanë sharë Policinë dhe qytetarët tjerë dhe meqenëse kanë bërë prishjen e rendit publik është marrë vendimi që këta të deportohen në Serbi nëpërmjet kufirit në Merdar. Kjo edhe është bërë rreth orës 7:00 e diçka të mëngjesit, dhe pas deportimit në pjesën, si e kanë kaluar kufirin, të revoltuar e kanë bërë një inskenim, ua kanë marrë çelësat vozitësve të tyre, kanë dalë dhe me gurë e me mjete të tjera të forta kanë gjuajtur në drejtim të Policisë Kufitare, ku ka qenë një numër i policëve të lënduar, të cilët e kanë kryer detyrën e vet. Natyrisht që kanë qenë të vetëpërmbajtur që të mos përdorin armë zjarri, në ndërkohë i kanë edhe togjet tjera mbështetëse edhe të Policisë Kufitare, dhe në rast nevojë edhe të Njësisë Speciale. Mirëpo, këta e kanë mbajtur situatën nën kontroll dhe këta të lënduar, them të lënduar për arsye se përmendet edhe nëpër mjete informimi të plagosur, qoftë me armë zjarri, asnjë nuk është i plagosur me armë zjarri, po me gurrë edhe gjësende të forta dhe në terminologji plagosja është sinonim i plagosjes me armë zjarri, me thitë e me mjete tjera, ndërsa lëndimet janë të natyrës tjetër.

Disa prej tyre, të lënduar krejt lehtë, janë trajtuar në Podujevë, ndërsa të tjerët janë dërguar në Qendrën Klinike Universitare për trajtim, por të gjitha këto janë lëndime të natyrës së lehtë.

Situata është vënë nën kontroll dhe kufiri është mbyllur përkohësisht për qarkullim për shkak të incidenteve që i kanë shkaktuar dhe natyrisht që hetimi i incidentit ka filluar nga ne. Kemi informata se edhe nga Serbia kanë filluar ta hetojnë incidentin për arsye se ata kanë shkaktuar edhe probleme tjera. E kanë kallur barin e thatë në pjesën e Serbisë dhe po ashtu ka pasur gjuajtje me armë zjarri, gjë që tregon se ata kanë ardhur të shkaktojnë probleme, prandaj janë deportuar, e nuk ka hyrje të asnjë grupi të tillë. Ne kemi paralajmëruar edhe më herët që edhe organizata tjera famëkeqe “Fytyra” (“Obraz”), që e quajnë 1389-she dhe tjera që janë identifikuar edhe në të kaluarën, që janë ilegale edhe për vetë Serbinë, nuk do të lejohen. Do lejohen vetëm ata që e kanë synimin ta bëjnë pelegrinazhin në mënyrë të kulturuar.

Në pjesë tjera nuk ka incidente. Edhe te Gazimestani ka numër të mjaftueshëm të policëve, ka edhe të EULEX-sit, dhe njësitë speciale janë në distancë të gatshme të reagojnë nëse ka nevojë, por për momentin nuk ka nevojë. Dhe, ky është ai incident, për të cilin është informuar edhe nëpërmjet medieve, por mediet nganjëherë natyrën e lëndimeve pak e kanë fryrë dhe e kanë tregua sikur ato janë me armë zjarri, por s’ka të tilla, ato janë lëndime të lehta. Pra, për momentin, kufiri është i mbyllur për shkaqe sigurie dhe si të krijohen kushtet, prapë do të lëshohet për qarkullim. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kërkuar deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!

Në fakt, kjo ishte kërkesa ime në fillim për deklarim jashtë rendit të ditës, por meqë veç iu shtrua pyetja zotit ministër për t'u përgjigjur në këtë, unë e tërhoqa fjalën time nga deklarimi jashtë rendit të ditës.

Por, tash, meqë ministri na dha një informacion sa i përket rrjedhës, ngjarjes si ka shkuar sot dhe gjithsesi një informacion për atë çfarë qytetarët, e në mesin e tyre edhe ne jemi shumë të shqetësuar, për atë që po ndodh, do të doja të dija më shumë, edhe për ne si deputetë, por edhe për qytetarët, diçka më shumë lidhur me disa specifika tjera.

Meqë u tha që këto probleme po vazhdojnë dhe kanë vazhduar edhe në këtë vit, meqë dihet që ky problem po vazhdon vit pas viti, çfarë masash po ndërmerret Ministria e Punëve të Brendshme që edhe në vitin e ardhshëm të mos ndodhin më gjëra të tilla për shkak se ky fenomen ka vazhduar të jetë vetëm sa më i ashpër dhe vetëm sa më i rëndë se sa ai paraprak. Po ndërkohë tha që dyshohet që pas deportimit nga kufiri, ata kanë gjuajtur edhe me armë zjarri. A janë bastisur këto grupe huligane serbe në kohën kur kanë qenë brenda dhe nëse kanë pasur armë zjarri brenda, pse nuk u janë konfiskuar ato?

Dhe, pyetja e tretë është: Kur grupet e tilla kriminale terroriste, të cilat janë të njohura edhe si grupe terroriste, kur futen me dhunë në territorin e Republikës së Kosovës, a e vlerësoni si shkelje të sovranitetit edhe ndaj Republikës së Kosovës, përderisa grupet e tilla, organizatat e tilla kriminale vazhdojnë ta sulmojnë Republikën e Kosovës, e po ashtu ta sulmojnë qytetarin e Kosovës dhe, në anën tjetër, ta sfidojnë deri në plagosje Policinë e Kosovës?

Po pate mundësi edhe një herë numrin e saktë të të plagosurve dhe gjendjen e atyre që janë në QKUK. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, ministër e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Natyrisht që ne e kemi krijuar një përvojë nga sjelljet që i kanë pasur për Vidovdan. Një pjesë e tyre vijnë për pelegrinazh, por një pjesë e madhe vazhdimisht kanë ardhur të shkaktojnë incidente, probleme të ndryshme. Ju e dini edhe vendimin e Qeverisë, me të cilin nuk i është lejuar hyrja ish-ministrit për "Kosovë e Metohi", Bogdanoviq, për arsye se ai e ka keqpërdorur dhe ka pasur fjalime nxitëse politike, e po ashtu është dhënë urdhri dhe publikisht dihet që këto grupe që janë identifikuar më herët, që kanë shkaktuar probleme, do të ndalohen në kufi, nuk do të lejohen të hyjnë. Ne e dimë të gjithë se këta depërtojnë edhe nëpër rrugë ilegale, në pjesën veriore. Kemi kërkuar që edhe EULEX-i të jetë aktiv dhe të mos lejojë, mirëpo ne nuk jem drejtpërdrejt urdhërdhënës të tyre, prandaj kanë depërtuar nëpër rrugë ilegale. Mirëpo, në momentin që janë identifikua si të tillë, janë deportuar.

Sa u përket të shtënave me armë, të dhënat janë se janë dëgjuar nga Serbia të shtëna me armë. Nuk kam thënë se janë këta individë që kanë gjuajtur, dyshohet se mund të jenë edhe

këta, por vetëm janë dëgjuar të shtëna me armë dhe e kanë kallur barin. Këta i kanë kontrollua në Vushtrri dhe sikur të kishin pasur armë sigurisht ishin çarmatosur menjëherë.

Prandaj, ne veprojmë si një shtet ligjor konform normave dhe sigurisht që edhe në të ardhmen planet do të jenë operative dhe çdo individ që një herë e keqpërdor këtë qasje në Gazimestan, do t'i ndalohej hyrja.

Ndërsa sa i përket numrit të saktë, janë gjithsej 32 të lënduar, të gjitha lëndime të natyrës së lehtë. 32 gjithsej, ndoshta edhe gërvishtje dikush.

KRYETARI: Rexhep Selimi e ka fjalën, replikë.

REXHEP SELIMI: Zoti ministër, një pyetje të shkurtër. Meqë dyshohen që kanë pasur armë, dhe siç thatë ju janë futur nëpër rrugë ilegale në Kosovë, atëherë pse nuk u arrestuan këta njerëz?

KRYETARI: Ministër!

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Policia veprimi sipas rregullativës. Në këtë rast nuk ka pasur arsye t'i arrestojë për t'i deportuar, dhe këtë e kanë bërë. Sikur të kishin pasur armë, do të ishin arrestuar, po armë nuk janë gjetur, prandaj edhe nuk janë arrestuar.

KRYETARI: Falemnderit! Sabri Hamiti, e ka fjalën. Ju lutem, me rend!

SABRI HAMITI: Me interes të veçantë, si çdo qytetar, por edhe si përfaqësues i qytetarëve, e dëgjova informatën e zotit ministrit të Brendshëm. Për mua, shifra e fundit është tepër sinjifikative, zoti ministër, meqë nëse janë të lënduar, s'po i quajmë të plagosur, megjithëse plaga është plagë, edhe nëse merret kështu, edhe ashtu, nëse zotëri ministër, janë lënduar 32 njerëz policë, ju lutem shumë, bëhuni konkret! Këtu unë e shoh një betejë. Sa kanë qenë në anën tjetër, sepse aty ku lëndohen në detyrë 32 veta, aty ka ndodhur një ngjarje, po e quaj unë e fortë, e madhe në kuptimin e përbërjes. Sa është pjesëmarrja aty? Kjo është me rëndësi për publikun. Falemnderit!

KRYETARI: Ministër, urdhëro edhe një sqarim, meqenëse realisht duhet ta përshëndetim gatishmërinë tuaj për të dhënë informacion kaq shpejt, por kjo çështje sigurisht e do një trajtim më ndryshe.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Mirë, në rregull. Unë nuk hyj në aspektin e gjuhës letrare, në dallimin "plagosje" nga "lëndimi". Unë flas në gjuhën shkencore kirurgjike, si trajtohet kjo. Prandaj, në atë mënyrë edhe e thashë, që dallohen.

Ndërsa, realisht, pasi i kanë deportuar ata kanë gjuajtur me gurë dhe me mjete të forta. Policia jonë kufitare nuk hyn pastaj në zonën neutrale që t'i ndjekë ata. Pra, ata e kanë gjuajtur Policinë tonë. Sigurisht që ka pasur përleshje edhe gjatë kontrollimit, ka mundur të ketë edhe ndonjë gërvishtje, edhe ndonjë lëndim të lehtë, prandaj këto janë në detaje. Nëse e doni për çdo detaj diagnozën e saktë të lëndimeve duhet kohë, të merren të dhënat e

mjekut dhe t'u jepen. Për këtë moment, të gjitha janë të natyrës së lehtë dhe në këtë mënyrë kanë ndodhur.

KRYETARI: Fjalën e ka ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani.

MINISTRI FERID AGANI: Për hir të qartësimit të shifrave dhe për t'i kuptuar përmasat e problemit, duke mos dashur as t'i zvogëloj, as t'i rris ato, në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës janë trajtuar 9 policë me lëndime të lehta trupore nga mjetet e topitura. Pra, ata që kanë pasur nevojë për ndihmë mjekësore më intensive në Qendrën Klinike Universitare kanë qenë 9 veta. Po flas me të dhënat e para një ore.

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar! Shumë shkurt, vetëm dy pyetje i kam shtesë për ministrin, në bazë të asaj që e tha. Ju na thatë që ata kanë hyrë nëpërmjet rrugëve ilegale në Kosovë dhe pastaj thatë se kjo nuk është bazë e mjaftueshme për t'i arrestuar. Sapo e patëm përgjigjen nga ministri i Punëve të Jashtme, i cili tha se në Hungari janë arrestuar shqiptarët për shkak se kanë hyrë ilegalisht në territorin e vendit dhe rrjedhimisht janë arrestuar. Nuk është vepër penale, por konsiderohet si kundërvajtje, dhe ata mbahen në burg. Pra, a e kemi edhe ne këtë bazë ligjore?

Edhe e dyta është që në bazë të kronologjisë që na shpjeguat si ka ndodhur, e kuptova pak a shumë që lëndimi i policëve, qoftë i rëndë apo i lehtë, ka ndodhur pasi ata janë deportuar. Po të ishin arrestuar këta persona, a ua merr mendja që kishin shpëtuar policët, nuk do të ishin lënduar. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka, nëse ka ndonjë pyetje ose koment, deputeti Burim Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit kryetar!

Normalisht ne si Aleancë e mbështetim secilin veprim që Policia e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës e bëjnë në raport me këso lloj provokimesh. Ajo që po na intereson prej ministrit, nëse mund të na thotë, a ka detaje ose informata nëse ka edhe grupe tjera që tentojnë të vijnë dhe cilat janë rrugët, pos kësaj pjesës kah Merdari, edhe prej pjesës së veriut të Kosovës. Cila është situata? Besojmë që provokimet e tilla mund të vazhdojnë. Prandaj, po na intereson edhe përgatitja e Policisë dhe normalisht koordinimi me KFOR-in dhe EULEX-in. Nëse keni mundësi ministër, do të ishte me rëndësi që qytetarët e Kosovës ta dinë se mund të jenë të mbrojtur për shkak të këtyre përgatitjeve që do të duhej t'i kenë mekanizmat vendorë, por edhe ndërkombëtarë, dhe sigurisht ju e keni rolin e koordinuesit në këtë punë. Prandaj, nëse keni mundësi të na jepni më shumë sqarime. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Brendshëm, Bajram Rexhepi, e ka fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë e përmenda edhe më herët që janë edhe disa grupe të njohura që shkaktojnë incidente, si "Fytyra" ("Obraz" e quajnë në origjinal) dhe janë në grupet çetnike 1389-shi, që bëjnë probleme. Ka qenë paralajmërim i këtyre tifozëve famëkeq, huliganëve të "Zvezdës", "Delije" dhe nga grupe tjera. Disa prej tyre kanë hyrë

nëpër rrugë ilegale, që janë diku rreth 14, që i shfrytëzojnë, dhe kanë qenë në pjesën veriore. Ne kemi kërkuar që EULEX-i të jetë në ndihmë në këto raste, por nuk kemi pasur fort ndihmë në këtë moment dhe për shkuarjen në Gazimestan janë ndërmarrë të gjitha masat dhe nuk janë lejuar. Një pjesë e tyre sigurisht as që kanë tentuar të shkojnë në Gazimestan, por kanë mbetur në pjesën veriore. Ka qenë i paralajmëruar edhe grupi i motoristëve, imitimi i “Blu Engjëlls”, që ka qenë më herët në Amerikë, por edhe ata kemi thënë se do të ndalohen. Edhe një herë e theksoj se nuk kemi pasur arsye të madhe që këta të arrestohen. Nuk dua të bëj analogji me atë që ndodhi në Hungari. Janë legjitimuar, është parë se qëllimi i tyre formal ka qenë ta vizitojnë Gazimestanin, prandaj nuk janë lejuar dhe janë deportuar.

KRYETARI: Falemnderit ministër! Deputeti Behar Selimi e ka fjalën. Le të përgatitet Arben Gashi.

BEHAR SELIMI: Falemnderit, zoti kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Së pari, lajm i mirë është që nuk kemi të plagosur. Së dyti, edhe më i mirë është lajmi që policët janë duke e bërë punën e vet. Së treti, lëndimet kur të deportosh njerëz të dehur mund të jenë të llojllojshme, gërvishten, sepse përtojnë ta lëshojnë territorin. Prandaj, lajmi edhe më i mirë është që ata e kanë lëshuar territorin tonë, janë deportuar dhe çfarëdo diskutimi politik për operacionin, i cili është në vazhdim, e do të jetë gjatë gjithë ditës, mendoj se e dëmton aspektin operativ dhe profesional atje. Diskutimet e aspektit strategjik mund t'i lëmë për ndonjë ditë tjetër, sepse nuk i bëjnë mirë Policisë, e cila është duke kryer edhe aktualisht punën e vet. Prandaj, ju sugjeroj që me informacionin që na dha ministri të ndahemi relativisht të kënaqur për arsye se, po përsëris, nuk ka të plagosur, e të tjerat pastaj i diskutojmë në ndonjë seancë tjetër, se nuk mendoj se duhet që sot, gjatë kohës kur po punohet në mbajtjen e rendit dhe qetësisë, të merremi me këtë temë.

KRYETARI: Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Besoj se ekziston vullneti i gjithë deputetëve që ta lirojmë sa më shpejt ministrin dhe të shkojë në krye të detyrës. Mirëpo, shifrat që po i jep këtu realisht nuk po përputhen me njëra-tjetrën.

Ministri tha se kanë qenë 70 persona, të cilët kanë qenë pjesë e asaj tollovie që ka ndodhur. Prej këtyre 70 personave, 32 policë janë lënduar, e kjo është një mospërputhje shumë e madhe. Pse? Sa policë kanë qenë në aksion, derisa 70 persona të tjerë kanë arritur t'i lëndojnë 32 policë. 32 policë, në qoftë se e bëjmë një analizë, janë të pajisur me mjete, kanë pajisje tjera shtesë, si gaz lotsjellës, shufra hekuri, kanë mbrojtje fizike, kanë trajnim, kanë komandë, kanë armë, kanë mjete transporti, ndërsa këta 70 persona nuk kanë kurrëgjë, sepse qenkan bastisur, nuk kanë armë, nuk kanë mjete tjera të forta që mund ta rrezikojnë sigurinë publike ose sigurinë e personit zyrtar në kryerjen e detyrës, e në fund na rezulton se këta 70 persona prapëseprapë i kanë lënduar 32 policë. Është një diskrepancë, meqë me

siguri ministri, si rezultat i mungesës së informacionit, sepse procesi është në zhvillim. Mendoj se nuk ka nevojë të na japë sqarime më shumë, mirëpo mendoj se ndoshta ka qenë një raportim i ngutshëm edhe i panevojshëm. Mendoj se ministri duhet të shkojë ta kryejë punën e vet në detyrën që e ka, e jo të japë informacione, sepse këto lloj informacionesh të jashtëzakonshme janë të panevojshme dhe mund ta dëmtojnë procesin. Jam dakord edhe me Beharin se mund ta dëmtojnë procesin, kështu që për mendimin tim ministri duhet të shkojë në krye të detyrës. Faleminderit!

KRYETARI: E falënderojmë ministrin për kontributin që e ka dhënë. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Unë jam në krye të detyrës dhe vazhdimisht jam në komunikim. Kjo është pjesë operative. Zinxhiri komandues i tëri është funksionon. Edhe, ose nuk ke qenë i vëmendshëm gjatë shpjegimeve, ose po dëshiron thjesht të nxjerrësh spekulime, e unë e thashë shumë mirë që janë gjuajtur me gurë dhe me mjete të forta në atë pjesën pasi i kanë deportuar. Dhe, jo 70 veta, por edhe 3 veta nëse kanë gurë mund t'i lëndojnë edhe 20-30 veta. Këto gjëra të gjitha i di, por po do t'i japësh zjarr pak më tepër, dhe nuk kemi nevojë më tepër ta zgjasim.

Sa i përket lirimit, unë e kam tash edhe Projektligjin për letërnjoftim, pasi ta kryej do të shkoj menjëherë.

KRYETARI: Falemnderit! Urdhëro kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ne kemi qenë në përcjellje të zhvillimeve që nga momenti kur ka filluar incidenti me ministrin e Brendshëm dhe autoritetet tjera të Policisë së Kosovës. Prandaj, që t'u iket spekulimeve për të krijuar konfuzion në opinionin publik, do të kërkoj që në një kohë shumë të shkurtër, shumë të afërt, të dilet nga Policia e Kosovës, nga Ministria e Brendshme me informatën e plotë zyrtare. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit kryeministër! Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit kryetar!

Mendoj që është momenti që Policia ta kryejë detyrën e vet në bazë të ligjit dhe po ashtu nuk ka nevojë për klasifikimet, siç u bënë këtu, a kanë qenë të dehur, a nuk kanë qenë të dehur, sepse politika serbe është e dehur, edhe pa këtë pjesë. Prandaj, veprimet që duhet t'i bëjë Policia duhet të jetë konform ligjit, informatat nga Ministria e Punëve të Brendshme duhet të jenë të plota dhe të sakta dhe nuk është mirë që debati të zhvillohet, derisa ngjarja edhe më tutje zhvillohet. Është mirë që çdokush që e prish rendin dhe qetësinë publike në territorin e Kosovës të arrestohet. Ky është obligim i Policisë, është obligim i instrumenteve të sigurisë në Kosovë. Prandaj, nuk na duhet shumë propagandë, por na duhet veprim konkret shtetëror. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Edhe unë jam dakord, por mendoj që Policia është duke i kryer detyrat e veta dhe për informacione tjera mund të presim dhe të marrim qëndrime, dhe sigurisht edhe Qeveria do ta analizojë mundësinë që derisa janë këto raporte ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, vërtet kjo festë serbe mund të jetë e lejueshme për qytetarët serbë të Kosovës, por jo edhe për ata që vijnë prej jashtë saj. Por, ky vendim duhet të jetë ndoshta më i koordinuar.

Vazhdojmë. Në ndërkohë janë parashtruar edhe dy kërkesa me shkrim për plotësimin e rendit të ditës për mbledhjen e sotme.

1. Në pajtim me nenin 44.2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka propozuar Kuvendit plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012. Raporti me rekomandime u është shpërndarë deputetëve.

Në mbledhje janë të pranishëm 86 deputetë.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për këtë propozim. Kush është për këtë propozim? Materiali është shpërndarë.

(Reagim nga salla)

Jo, ne nuk po ngutemi. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Në pajtim me nenin 44, pika 2, ia kam drejtuar një shkresë kryetarit të Kuvendit që të bëjë plotësimin e rendit të ditës në seancën e sotme plenare me një pikë të rendit të ditës - Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Projektligjin për plotësim-ndryshimet e buxhetit për vitin 2012 Qeveria e ka sjellë më 13 qershor në Kuvend, kurse Komisioni për Buxhet dhe Financa më 26 qershor e ka shqyrtuar Projektligjin dhe ia ka rekomanduar Kuvendit për shqyrtim.

Arsyeja pse kam kërkuar që të futet kjo pikë e rendit të ditës është që komisionet funksionale të kenë mundësi apo të kenë kohë më shumë për ta bërë shqyrtimin e plotësim-ndryshimeve që kanë ardhur nga Qeveria dhe po ashtu Komisioni për Buxhet ta ketë mundësinë dhe kohën e duhur për ta bërë plotësimin dhe amendamentimin e këtij projektligji.

Megenëse Kuvendi planifikon të shkojë në pushim, atëherë ne kemi rekomanduar që Projektligji të futet pikë e rendit të ditës, në mënyrë që ta kemi kohën e duhur për të bërë plotësim-ndryshimet e nevojshme nga Komisioni Funksional dhe komisionet tjera. Faleminderit!

KRYETARI: Shefat e grupeve, e doni fjalën për deklarime? Në emër të Partisë Demokratike, kryetari i grupit, Adem Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Falemnderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pas arsyetimeve të dhëna, e përkrah dhe kërkon nga gjithë deputetët që të votojnë pro futjes si pikë e rendit të ditës. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Kryetari i Grupit të LDK-së, deputeti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Nga ajo që u tha nuk ka asnjë arsyetim, as arsyeshmëri që kjo të futet sot me urgjencë dhe ne konsiderojmë që kjo mund të bëhet javën e ardhshme dhe koha që kemi për të shkuar në pushim, ky është arsyetimi më i paqëndrueshëm, ngase ne mund të mos shkojmë në pushim. E kryejmë punën tonë, e miratojmë, e votojmë, ose nuk e votojmë, kjo varet prej qëndrimeve tona, sigurisht prej grupeve parlamentare, por nuk shohim asnjë arsye që kjo të ndodhë sot. Kjo mund të bëhet javën e ardhshme.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së nuk është që të futet në rend të ditës kjo pikë sot.

KRYETARI: Unë jam i obliguar të ju njoftoj se Ligji, sipas Rregullores së Punës, i plotëson kushtet. Fjalën e ka, në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari i grupit, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Edhe ne mendojmë se nuk ka kurrfarë arsye për këtë nguti. Nuk u arsyetua të paktën ngutia as nga ministri se pse është e rëndësishme, por as nga kryetarja e Komisionit. Unë dje e kam dëgjuar ministrin nëpërmjet televizionit, duke thënë se është e rëndësishme që Kuvendi ta miratojë ligjin në lexim të parë para pushimit. Kemi sa të duash kohë ta bëjmë këtë miratim në lexim të parë, po qe se ka nevojë i mbajmë edhe 3-4 seanca të tjera javën e ardhshme, po qe se ka nevojë, siç u tha edhe nga Grupi Parlamentar, e shtyjmë edhe pushimin, por nuk kemi nevojë ta ngutim këtë ligj në këtë mënyrë kështu, për shkak se sa herë po ngutemi po bëjmë shumë lëshime dhe shumë gabime.

KRYETARI: Ngutje nuk është. Edhe një herë po them, Ligji, sipas Rregullores, i plotëson kushtet për të hyrë në lexim të parë,

(Reagim nga salla)

Ju lutem, tjetër është që nuk ka qenë materiali për Kryesi, por Ligji i plotëson kushtet për të hyrë në seancën e sotme. Fjalën e ka deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Meqenëse në Komision ka përfunduar puna, ne mendojmë se është më e rëndësishme që të ketë kohë ndërmjet leximit të parë dhe leximit të dytë. Kjo është arsyeja pse e mbështetim kalimin në lexim të parë të Ligjit sot. Po ashtu, mendojmë se teknikisht i ka plotësuar kushtet. Ndoshta edhe mua më duket ngutje, ndoshta edhe është ngutje, por nuk ka arsye

praktike që të mos kalojë më shpejt dhe t'i japim vetes më tepër kohë ndërmjet leximit të parë dhe leximit të dytë. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Kryetarja e Grupit të KKR-së, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke marrë parasysh përvojën e viteve të kaluara, nëpër të cilat kalon Kuvendi i Kosovës, dhe duke marrë parasysh që Ligji për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012, ne e përkrahim mendimin e zonjës Hadërgjonaj dhe shpresojmë që gjatë leximit të dytë do të merren parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, deputeti Sasha Milosavleviq.

SAŠA MILOSAVLEVIĆ: Hvala gospodine predsjedniče!

I Poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke se slaže da se danas uvrsti u dnevni red Nacrt zakona o budžetu.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit “6+”, kryetari Albert Kinolli.

ALBERT KINOLLI: Falemnderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah propozimin e kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe mendon se sot duhet të futet në rend të ditës ky propozim. Falemnderit!

KRYETARI: Atëherë votojmë me elektronikë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 60 vota për, 27 kundër dhe një abstenim, Kuvendi e miratoi radhitjen e rendit të ditës. Konstatohet se me shumicë absolute u miratua propozimi për plotësimin e rendit të ditës së mbledhjes së sotme plenare me pikën:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Kjo pikë radhitet si pika e tetë e rendit të ditës në mbledhjen e sotme plenare.

Dhe, kërkesa e dytë është: Në pajtim me nenin 42, pika 2, 56 dhe 84 të Rregullores së Kuvendit, Grupi Parlamentar i PDK-së i drejtohet kryetarit të Kuvendit me këtë propozim: Për shmangien nga Rregullorja e Kuvendit lidhur me procedimin e Projektligjit për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodin Penal të Kosovës.

Për miratimin e këtij propozimi, në pajtim me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit kërkohen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare. Të pranishëm janë 97 deputetë.

Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike u është shpërndarë deputetëve. Fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit zoti kryetar!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Pak më herët e pata një diskutim, por më duket se pata më shumë gjuhë policore se sa politike. Tash do të përpiqem ta përdor gjuhë politike. Dhe këtë gjuhë politike nuk e kam lehtë ta përdor për këtë lloj propozimi, por do të ma bëni të lehtë në fund nëse pajtoheni me propozimin në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike propozon që ta anashkalojmë në mënyrë legjitime procedurën e shqyrtimit të Projektligjit për ndryshimin e Kodit Penal, përkatësisht për heqjen e neneve 37, 38 dhe 39. Dhe njëkohësisht propozon që kjo të futet në rend të ditës.

Kodi Penal i Kosovës tashmë është një nga aktet ligjore që është diskutuar më së shumti, sidomos nenet të cilat nuk janë konsideruar miqësore ndaj medieve.

Po ashtu, edhe Komisioni për Legjislacion i pati dhënë rekomandimet e veta, të cilat po të ishte ligj në procedurë të rregullt, pa na u kthyer prej Presidentes, ato nene qenë hequr në votimin e fundit. Ekziston një vullnet politikë i shumicës prej nesh, një përkrahje e madhe e shoqërisë civile, po ashtu edhe shqetësim ndërkombëtar se këto nene duhet të hiqen. Ne shpresojmë shumë se vullneti politik i deklaruar tashmë nga ju herën e fundit, i deklaruar edhe nëpërmjet shefave të grupeve parlamentare nëpër medie, do të përligjet sot. Unë mendoj se praktika e anashkalimit të rregullores është legjitime për sa kohë që ju dakordoheni që ta anashkalojmë këtë procedurë dhe ky projektligj të futet në rend të ditës, e të miratohet në parim.

Ndërkohë që shqetësimet individuale të deputetëve, gjithsesi legjitime, dhe shqetësimet tjera jashtë kësaj sale, mendoj se mund t'i rregullojmë siç i ka rregulluar shumica e shteteve të BE-së me ligj tjetër, që i ka parasysh edhe gazetarët, që t'i mbrojnë nga pushteti, por edhe qytetarët t'i mbrojnë nga gazetarët. Pra, mendoj se ka mënyrë tjetër, ka akte tjera, të cilat mund t'i rregullojmë.

Prandaj, sugjeroj që propozimi i Grupit Parlamentar, që të bëhet anashkalimi i procedurës për shqyrtim të projektligjit për heqjen e neneve 37, 38 dhe 39 të votohet sot nga shumica prej jush, ashtu siç kërkon rregullorja dhe njëkohësisht të futet në rend të ditës për shqyrtim dhe aprovim. Ju falënderoj shumë dhe besoj se do ta kem përkrahjen e juaj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe në seancën, kur u miratua Kodi, përkatësisht ashtu siç u miratua, pa nenet të cilat LDK-ja votoi të hiqen, por nuk votoi PDK-ja, që sot po e kërkon këtë, Grupi Parlamentar i

LDK-së konsideron që sot nuk është urgjente dhe kjo punë mund të bëhet edhe javën e ardhshme, duke i kaluar procedurat, sepse Komisioni për Legjislacion e ka dhënë mendimin pozitiv herën e kaluar që të hiqen këto tri nene dhe ne pajtohemi që të hiqen, por nuk janë pajtuar ata që sot po ndryshojnë. Janë po të njëjtit deputetë që kanë votuar më 22 qershor që të mos hiqen këto nene dhe ata janë të Partisë Demokratike të Kosovës.

Dhe ne si Grup Parlamentar i LDK-së konsiderojmë se nuk ka urgjencë. Kjo punë mund të bëhet edhe javën tjetër. U përmend nga zoti Selimi, është e vërtetë se ne e kemi thënë publikisht, e kam thënë edhe unë, që ne e përkrahim si LDK heqjen e këtyre neneve, por e kam thanë shumë qartë që duhet të respektohen procedurat.

Dhe ne konsiderojmë me bindje të plotë se kjo është një lojë që po e bën Grupi Parlamentar i PDK-së ose individ brenda këtij grupi. Por, ajo që është e rëndësishme, po e them fuqishëm, kemi qenë, jemi dhe do të jemi të hiqen këto tri nene, por të respektohet procedura. E kjo mund të bëhet edhe javën e ardhshme, sepse, po e përsëris, nuk jemi në pushim, as nuk e kemi ndërmend të shkojmë në pushim. Nuk dëshirojmë të shkelen procedurat. Ka mundësi të bëhet javën e ardhshme. Pse mos të bëhet konform procedurës, po të shkelen procedurat dhe të bëhet kjo shmangie. Dhe vërtet edhe është e habitshme dhe për ne e papranueshme që kështu të veprohet dhe të ketë tentime të dirigjimit të asaj çfarë më herët kanë thënë diçka tjetër, e tash qenka ndryshuar. Është e drejtë sigurisht e secilit grup që ta bëjë këtë, por për ne është me rëndësi të respektohen edhe procedurat dhe ne jemi në favor, për hir të opinionit, po e them për të satën herë, kemi qenë, jemi dhe do të jemi të hiqen këto tri nene, por jo të shkelen procedurat. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Shmangien e parasheh Rregullorja. Fjalën, në emër të “Vetëvendosjes”, e ka kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Është e vërtetë që shmangien e parasheh Rregullorja, por edhe për shmangie, edhe për futje në rend të dite, aty për aty, të një pike të caktuar, duhet të ekzistojë një lloj arsytimi. Nuk mund ne të vendosim ta shmangim rregulloren vetëm se kemi dëshirë, kjo është absolutisht e pakuptimtë. Pra, mundësia dhe mekanizmi i shmangies së Rregullores së Punës, mekanizmi për futjen e një pike të rendit të ditës aty për aty në seancë, duhet ta ketë një lloj arsytimi, prandaj edhe ekziston, ekziston si një lloj deriçke e vogël e hapur që ta ndryshojmë rendin e ditës, po qe se është diçka shumë urgjente, por jo vetëm si t’i tekjet dikujt.

E dyta, sa i përket propozimit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, tash këtu e dëgjuam që edhe këta janë shumë të shqetësuar. Kemi dëgjuar edhe nëpërmjet medieve shqetësimin, turpërimin e disave me votën e deputetëve, e kështu me radhë. E gjitha kjo ndodhi tash vonë, ndërkohë që e dimë që është po ky grup parlamentar dhe po kjo Qeveri, më mirë thënë, që e kanë sjellë këtë kod me këto nene, edhe e kanë mbrojtur vazhdimisht këtë kod me këto nene, e tash përnjëherë e ndryshuan mendjen, që për mendimin tim është ndryshim i mendjes, duke u gjunjëzuar karshi presionit publik që u erdh, e tash po bëhen

sikur ata engjëjt, të cilët duan ta shpëtojnë këtë vend dhe mediet nga kodi, të cilën vetë e kanë sjellë.

Unë mendoj që nuk kemi kurrfarë nevojë, siç e tha edhe shefi i Grupit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që të ngutemi e ta futim kështu, ta shmangim rregulloren për këtë ligj të ri që na ka ardhur në Kuvend. Ky ligj pret, këto nene presin dhe ata që vërtet mendojnë që këto nene është dashur të hiqen dhe të mos jenë pjesë e kodit, janë ata që kanë votuar vazhdimisht kundër këtyre neneve prej se e kemi votuar këtë kod. Dhe, e tillë nuk është, fatkeqësisht po them, Partia Demokratike e Kosovës, për shkak se po ta bënte një gjë të tillë, atëherë nuk do t'i kishim këto probleme fare. Dhe tash ne kërkojmë që këto nene natyrisht të hiqen, që ky ligj të trajtohet në Kuvend, mirëpo të trajtohet nëpërmjet procedurave normale, sepse edhe ashtu është një kod, i cili nuk do të hyjë në fuqi deri më 1 janar të vitit 2013. Faleminderit!

KRYETARI: Për korrektësi po them, për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare dhe nuk duhet kushedi çfarë arsytimi. Fjalën e ka kryetari i AAK-së, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe një herë po shihet se Kuvendi ka ardhur në një pozitë të keqe gjatë javëve dhe muajve që kanë shkuar. Seriozisht, tash është një dilemë serioze në Kuvendin e Kosovës dhe Aleanca do të tregojë se si do të veprojë.

Dhe, sidoqoftë, është e vërtetë që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës me shumicë ka qenë ai që e ka sjellë këtë situatë, e cila ka ndodhur, domethënë me votimin e propozimit që nenet diskutabile të mbeten.

Tani, po Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës kërkon që me procedurë të shpejtë këto nene të hiqen nga Kodi Penal.

Grupi Parlamentar i Aleancës ka kërkuar që këto nene të mos jenë në Kodin Penal, ashtu edhe ka votuar në seancën kur është votuar kodi dhe do të ishte e çuditshme tani të kërkojmë të shtyhet kjo procedurë, e cila shumë saktë kërkon vetëm heqjen e këtyre dy neneve.

Mendoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka gjetur një mënyrë për t'u nxjerrë prej kësaj situatë. Nuk është mirë. Ka pas mundësi të bëhet edhe ndryshe. Nuk ka pasur nevojë që të jetë me kaq urgjencë. Dhe, sidoqoftë, meqenëse nuk ka arsye praktike, as në bazë të Rregullores së Punës, e as morale, ne mendojmë se është e mundshme që ky propozim i ri të kalojë prapë në lexim të parë.

Edhe një herë po them se këto sjellje sidoqoftë e kanë sjellë Kuvendin në gjendje jashtëzakonisht të keqe. Kanë bërë që Kuvendi në sytë e popullit të Kosovës të duket shumë i keq, që Kuvendi të duket si një organ që nuk bën diçka, që duket si diçka që e ndërron mendjen vazhdimisht.

Mendoj se, nëse ky rast do të shërbejë që një gjë e tillë të mos ndodhë në të ardhmen në Kuvend, do të ishte mirë. Do të ishte një mësim i mirë për të gjithë ne, për Kuvendin dhe për ata që, pasi ta bëjnë një punë, fillojnë të mendojnë.

Mendoj se të gjithë ne duhet të mendojmë para se ta bëjmë një punë, e të mos vijmë në momente të eskivazheve të këtilla, të cilat vetëm sa e rrënojnë autoritetin e institucionit më të rëndësishëm në Kosovë. Edhe një herë po e përsëris, të institucionit më të rëndësishëm në Kosovë.

Grupi i Aleancës mendon se ky propozim mund të kalojë sot, për shkak se nuk kemi as arsye praktike, as arsye morale, që të mos e kalojmë, për shkak se kjo ka qenë edhe kërkesë jona, që këto nene të mos jenë në kod. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetarja e Grupit të Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Falemnderit, kryetar!

Duke marrë parasysh pjesën e procedimit të ligjit të kthyer nga Presidentja dhe përkrahjen e ministrit të mëparshëm, shohim se Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re ka votuar atë ditë për heqjen e dy neneve, mirëpo duke marrë parasysh situatën momentale të shoqërisë civile dhe të medieve për tryshinë që bëhet te deputetët, unë prapëseprapë them se Koalicioni për Kosovë të Re, edhe atë ditë e ka dhënë votën që të hiqen këto nene, edhe sot do ta japë votën, mirëpo përgjegjësia është individuale te secili. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së, kryetari i Grupit, Sasha Milosavljeviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne Liberalne Stranke podržava predlog Parlamentarne grupe PDK-a, koje je uputila vama, i mi čemo ovaj predlog podržati. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit “6+”, kryetari i Grupit, Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju falemnderit, i nderuari kryetar i Kuvendit!

Grupi Parlamentar “6+” mendon se duke u bazuar në propozimin dhe arsyetimin që u dha më parë nga përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së dhe bazuar në rrethanat e reja të krijuara, e përkrahim propozimin për plotësimin e rendit të ditës me këtë propozim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e kanë kërkuar dy kryetarët e komisionit, njërit për Legjislacion dhe Gjyqësi, dhe tjetri për Integritet Evropian. Fjalën e ka Arben Gashit, e pastaj deputeti Lutfi Haziri.

ARBEN GASHI: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Ne e kemi një situatë pak konfuze për momentin, sepse e kemi një propozim të Partisë Demokratike të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës, e nuk po e dimë realisht se kush është propozues i këtij Projektligji.

Propozuesi nuk ka dalë të thotë se kush është propozues i Projektligjit, a është PDK-ja propozues, apo Qeveria.

Ne e kemi një dokumentacion që na rezulton se Qeveria është propozues i këtij Projektligji, e jo Partia Demokratike e Kosovës, prandaj mendoj se është proceduralisht e gabuar. Qeveria e Kosovës është dashur ta propozojë Projektligjin për shkak të emergjencës që e paska, megjithëse edhe këtu unë i kam dyshimet e mia, sepse nuk vlerësoj se ka ndonjë emergjencë që ky ligj të shqyrtohet siç po propozohet këtu, sepse Kodi Penal hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2013, që i bie më shumë se 6 muaj prej ditës së sotme, kështu që kemi kohë sa të duam ta ndryshojmë, ta rishikojmë, të bëjmë çfarë të duam me këtë kod dhe është një problem tjetër, sepse vetë përmbajtja e Projektligjit thotë: Projektligji për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Dhe, parimisht, çka po shfuqizojmë, diçka që nuk është në fuqi. Sepse, neni i fundit i Kodit Penal thotë se Kodi Penal hyn në fuqi më 1 janar të vitit 2013, e si mund të shfuqizojmë diçka që nuk është në fuqi? Ka non sens logjik! Përveç se fakti tjetër, që e kemi propozuesin e ligjit, që nuk e ka propozuar ligjin, kemi emërtimin e ligjit që është problematik dhe nuk mund të shkojë sipas Rregullores së Punës dhe është në kundërshtim me praktikën parlamentare që të paktën deri sot janë ndërtuar në Kosovë dhe në fund na del se ne po marrim diçka për të akomoduar ndoshta për interesa të brendshme të Partisë Demokratike, që unë nuk po besoj se janë, por ndoshta edhe janë.

Dhe, kjo situatë që po krijohet këtu është realisht problem procedural, problem konceptual, problem ligjor dhe problem praktik se çka po duam të bëjmë. Kush po propozon t'i shmangemi Rregullores së Punës? Është Partia Demokratike e Kosovës. Kush po e propozon ligjin? Po na rezulton se nuk është Partia Demokratike e Kosovës që e propozon ligjin, sepse po të propozohet ligji në rrugë të rregullt, do të duhej të vinte në Komisionin për Legjislacion. Ky nuk ka ardhur kurrë! Dhe, nuk është diskutuar kurrë në Komision ky projektligj i ri.

Pa marrë parasysh se Komisioni e ka një vendim, në të cilin thotë se nenet 37, 38 dhe 39 duhet të hiqen nga Kodi, ky është një projekt-propozim i ri dhe si i tillë duhet të trajtohet proceduralisht në gjithë hierarkinë e trajtimit dhe nuk mund të trajtohet në mënyrë emergjente, sepse edhe nuk ka nevojë, se është 1 janari i vitit 2013 kur hyn në fuqi.

Po ia shtojmë kësaj edhe elementin tjetër, që thotë “shfuqizim”, që realisht nuk është në fuqi deri në janar 2013. Dhe, mendoj se duhet të mendojnë edhe Qeveria, edhe Grupi Parlamentar, si propozues, ende më shumë se çfarë duan të bëjnë dhe pastaj të vijnë në një konkluzion, sepse unë jam i bindur që të gjitha partitë tjera, përveç PDK-së, që e ka pasur votimin siç e ka pasur herën e fundit, jemi që nenet 37, 38 dhe 39 të hiqen. E, ato nuk janë në fuqi deri më 1 janar 2013, kështu që ta bëjmë më të mirën e mundshme. Mos të ngutemi të gabojmë dhe ta ndërtojmë një praktikë parlamentare të gabueshme, sepse kjo mund të

përsëritet në të ardhmen pa nevojë, sepse ka kohë, ka mundësi, ka vullnet dhe mund të ndryshohet kurdo. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Lutfi Haziri e ka fjalën.

LUTFI HAZIRI: Falemnderit zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Deputetë të nderuar,

Ndoshta ka qenë rendi që në rrethana tjera të flitet për shkaktarin, e jo për pasojat e këtij procesi. Ne po merremi sot edhe me pasojat. Një vend, çfarë jemi ne, me këtë demokraci të zhvilluar çfarë e kemi ne, Kabineti qeveritar është detyruar që në mënyrë urgjente të merret me draftligjin e ri, i cili i eliminon pasojat që i ka shkaktuar miratimi i një ligji, që ka qenë i rëndësishëm për Kosovën dhe i cili është dashur të ndërtohet në një dialog politik dhe në një proces, i cili do të duhej t'i kënaqte të gjitha grupet politike dhe shoqërinë e Kosovës, e cila, sidomos në kategorinë që po preket, kategori e cila është transmetuese e zërit tonë dhe bartëse e fjalës sonë publike, në këtë rast të gazetarëve dhe medieve, po bën që ne t'i rikthehemi dhe të nxirremi në këtë situatë, apo të nxirremi nga kjo situatë.

Unë nuk e ndryshoj qëndrimin tim, sa i përket këtij kodi. Shkaktar i këtij procesi, me hallakamën e vet, i cili ka pasojë edhe viktimizimin e një ministri, i cili ka qenë i dalluar në këtë Kabinet qeveritar dhe i këtij procesi, i cili e ka dëmtuar imazhin e Kuvendit të Kosovës, veç atij, pa e pasur asnjë lloj faji. Sepse, sponsor i ligjit është Qeveria - ministria e linjës.

Ministri Hamza di t'i mbajë ligjet nga një vit për kosto buxhetore. Ministria për Integritet Evropian e ka të drejtën ta mbajë ligjin nëse nuk standardizohet dhe përafrohet me legjislacionin e BE-së një vit dhe ta kthejë sa herë që do, në mënyrë që kur të vijë në Kuvend, ligji të vijë i pajtuar, e jo mandej shefi i BE-së në Kosovë të dalë e të kallëzojë se nuk është kurrkund me BE-në, nuk është kurrkund i afëruar me standardin e BE-së, së paku ashtu e ka thënë, ose gazetarët kërkojnë që ata që kanë votuar kundër dhe kanë abstenuar të mos i nxjerrin më në medie, t'ua mbyllin mediet, që është shantazh i hapur. Dhe, edhe ky Kuvend, edhe kryeministri duhet t'i ruajnë vlerat që mos të lejojnë që deputeti e ministri të shantazhohen. Sepse, fundja, nëse ne bëhemi pre e shantazhit për një votë, atëherë le ta vendosin grupet e interesit qysh duhet të votojmë ne. Nuk kemi nevojë të mendojmë, u themi mblidhuni ju, kallëzoni si duhet të votohet. Sepse, vendimet po shkojnë çuditshëm.

Sidoqoftë, unë po e shoh si strategji dalëse nga situata, normalisht që u intereson dhe ky interes lidhet ngushtë me Ekzekutivin, por një ligj që nuk ka hyrë në fuqi e nuk e di pse duhet ta shfuqizojmë.

Sidoqoftë, sipas procedurës, unë dua të them si kryetar i Komisionit për Integritet Evropian që ta kërkojmë mbështetjen tuaj si kryetar dhe Kuvend, që asnjë ligj më të mos kalojë, të mos vijë pa e marrë, përveç certifikatës për standardizim, edhe zyrës së Zhbogarit t'i thuhet 'a është mirë a nuk është mirë kjo punë, a është në standard me ju a nuk është', në

mënyrë që të mos kemi më pasoja. Fundja, më mirë është t'i ndalim ligjet brenda komisioneve se sa t'i sjellim në seancë me probleme, çfarë sot i kemi.

Sidoqoftë, unë uroj që kjo situatë sot të mbyllet, të kalojë dhe pasojat të zbuten, sepse pasojat nuk do të hiqen lehtë, edhe pse ne po mundohemi ta ndryshojmë situatën.

KRYETARI: Urdhëro, kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të të gjitha partive politike,

Realisht, ligji hyn në fuqi më 1 janar 2013, por që të jemi konkretë dhe të qartë, heqja e neneve 37, 38 dhe 39, pra shfuqizimi nënkupton drejtpërdrejt dhe reflekton drejtpërdrejt për të mirën e Kosovës, për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës, të gjithë spektrit politik, shoqërisë civile, medieve, sepse Raportin e Progresit do ta kemi në tetor. Gjithashtu, do të ketë reflektim drejtpërdrejt në studimin e fizibilitetit, por edhe në procesin e liberalizimit të vizave. Prandaj, kërkoj nga të gjitha partitë politike të tregoni vullnetin e përbashkët dhe unik për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39. Ju falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Ju lutem, i kemi kryer diskutimet. Do të thotë kanë pasur të drejtë të diskutojnë edhe dy anëtarët e komisioneve, që e morën fjalën. E tani, po hyjmë në procedurën e votimit. Për t'u votuar shmangia e kërkuar nga Partia Demokratike, Ligji është nga Qeveria, natyrisht si edhe për të gjitha ligjet tjera, duhen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm. Prandaj, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 94 deputetë, sepse po lëvizin, mund të jenë 95.

(Pas numërimit të deputetëve)

Të pranishëm janë 96 deputetë. Edhe një herë po them, na duhen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm për të kaluar shmangia. Pra, lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Janë 58 vota për, 28 kundër dhe 3 abstenime, prandaj Ligji nuk kalon.

Merrni kartelat me vete. Edhe një, edhe dy, nuk e plotësojnë, 64 vota duhen të jenë, prandaj Ligji nuk hyn në rendin e ditës.

(Ndërhyrje)

Ju lutem, pa fjalë! Vazhdojmë. Tani është pika e tretë në vazhdim:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012

A ka kush vërejtje në këtë procesverbal? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj se Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 22 qershor 2012.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Votimi i raportit të punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2011

Siç e dini, në mbledhjen plenare të mbajtur më 22 qershor 2012, Kuvendi, në mungesë të kuorumit, nuk e ka proceduar për votim raportin e punës së Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2011.

Diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës kanë përfunduar në mbledhjen e kaluar plenare, andaj vazhdojmë me votimin e raportit të punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2011.

(Pas numërimit të deputetëve)

Në mbledhje janë të pranishëm janë 79 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Deputetë, duhet ta kishit përpara rendin e ditës!

Atëherë, me 71 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin e punës të Këshillit të Kosovës për Trashëgiminë Kulturore për vitin 2011.

Vazhdojmë me pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Bajram Rexhepi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë Projektligjin.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: Falemnderit, i nderuari kryetar i Parlamentit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni ta prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim, i sponsoruar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim është hartuar duke u bazuar në programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2012 dhe në pajtim të plotë me Rregulloren e Punës së Qeverisë, numër 09/2011.

Arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim numër 03/L-099 janë si në vijim:

Me këtë projektligj rregullohen procedurat e lëshimit të letërnjoftimit biometrik, sipas standardeve ndërkombëtare dhe të BE-së;

Pajisja e shtetasve të Republikës së Kosovës me letërnjoftime biometrike;

Pajisja e shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi me letërnjoftim biometrik, të cilët qëndrojnë ligjërisht në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj përmban gjithsej 12 nene, duke filluar nga dispozitat e përgjithshme, dispozitat shpjeguese, si dhe dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për letërnjoftim, me numër 03/L-099 është harmonizuar me Kushtetutën dhe instrumentet ligjore, të cilat janë pjesë direkte e zbatimit në Republikën e Kosovës. Andaj, ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj u janë përshtatur rrethanave të reja të krijuara në Republikën e Kosovës.

Hartimi i këtij projektligji është bërë në pajtim me procedurat e parapara dhe për këtë projektligj janë pranuar edhe deklaratat respektive nga Ministria e Financave dhe Ministria e Integritimit Evropian, me të cilat vërtetohet pajtueshmëria me aquit komunitare.

Të nderuar deputetë,

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij ligji, si dhe nevojën e avancimit të kuadrit ligjor në këtë fushë, si dhe duke marrë parasysh prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kërkoj nga ju miratimin në parim të këtij projektligji.

Kisha dashur të ju lus, po ashtu, deputetë të nderuar dhe Kryesi, që pas leximit të parë, me procedurë të përshpejtuar, të kalojë në leximin e dytë për arsye se është kusht për liberalizmin e vizave. Pra, derisa në vitin e kaluar ka qenë vetëm rekomandim, tash është kusht dhe duke e ditur se procedurat e tenderimit shkojnë në dy faza - në fazën parakualifikuese dhe përfundimtare, që zgjat minimum 4 muaj, në mënyrë që të arrijmë dinamikën dhe të fillojmë sivjet prodhimin e letërnjoftimeve biometrike, ju kisha lutur për mirëkuptim. Falemnderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Falemnderit, kryetar!

Përsëndetje!

Përsëndetje për Kabinetin,

Përshëndetje për deputetët e nderuar,
Faktikisht, fillimisht po flas në emër të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcave të Sigurisë, ku bazuar në nenin 56 paragrafi 2 të Rregullores së Punës të Kuvendit kemi mbajtur mbledhje më 12 qershor 2012 dhe kemi vendosur t'i propozohet Kuvendit që ky projektligj të kalojë në lexim të parë në parim për arsye të nevojës dhe domosdoshmërisë që shteti ynë të pajiset dhe ta prodhojë një letërnjoftim cilësor, me të dhëna biometrike dhe me çip, që njëherësh është edhe kërkesë e Komisionit Evropian për ta plotësuar njërin prej standardeve në drejtim të procesit të liberalizimit, kështu që edhe **letërnjoftimi ynë** t'i plotësojë kriteret minimale të standardeve të Bashkimit Evropian.

Po ashtu, edhe në emër të Grupit Parlamentar besoj se do ta japim kontributin tonë në Komision dhe në Grupin e Komisionit, në mënyrë që ky projektligj, përkatësisht Projektligji për ndryshimin e plotësimin e Ligjit për letërnjoftim të jetë sa më cilësor, andaj edhe në emër të Grupit Parlamentar i propozojmë Kuvendit që ta miratojë në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Vjollca Krasniqi.

VJOLLCA KRASNIQI: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim.

Sipas sponsoruesit të këtij projektligji, ky material ka të bëjë me pajisjen e qytetarëve me letërnjoftime biometrike dhe avancimin e të dhënave biometrike. Por, si shumë ligje të tjera, që janë proceduar në këtë Kuvend, shumë prej tyre kanë pasur implikime buxhetore dhe i tillë është edhe ky projektligj.

Ky ndryshim-plotësim i këtij projektligji nuk mbështetet në kornizën buxhetore afatmesme të vitit 2013-2015, andaj kostoja totale e këtij ndryshim-plotësimi është 9,2 milionë euro.

Departamenti i buxhetit shpreh opinionin e vet për ndikimin buxhetor të këtij projektligji për ndryshim dhe plotësim, sipas të cilit vlerësohet se kemi të bëjmë me ndikime shumë të larta shtesë buxhetore. Mirëpo, pajisja e qytetarëve me këtë lloj letërnjoftimi do të ketë edhe ndikime të tjera buxhetore, do të jetë për qytetarin edhe një kosto shtesë buxhetore, do të jetë edhe një rëndesë shtesë për qytetarët në mesin e rëndesave që po u bëhet kohëve të fundit, por meqë është një standard ndërkombëtar evropian kusht për liberalizim të vizave, Grupi Parlamentar i LDK-së do të votojë për miratimin në parim të këtij projektligji për ta dhënë një kontribut më të madh në trajtimin dhe shqyrtimin e tij ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të "Vetëvendosjes", deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përderisa arsyet për këtë projektligj qëndrojnë në faktin se disa nga dispozitat përkatëse lidhen me sistemin dhe avancimin e mëtutjeshëm të dhënave biometrike, e po ashtu qëllimi është lëshimi i këtyre letërnjoftimeve biometrike për plotësimin e standardeve për liberalizimin e vizave, ne e mbështetim në parim - në leximin e parë dhe gjithsesi do ta japim kontributin ndërmjet leximit të parë dhe atij të dytë, dhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e mbështet në parim këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Falemnderit, zoti kryetar!

Duke pasur parasysh nevojën e pajisjes sa më të shpejtë të qytetarëve me letërnjoftime biometrike, ne konsiderojmë se plotësimi dhe ndryshimi i këtij ligji duhet të bëhet në procedurën sa më të shpejtë, në mënyrë që edhe të përmbushet standardi ose kushtet për liberalizimin e vizave, që është shumë i nevojshëm për Kosovën, prandaj edhe si Grup Parlamentar, por edhe në Komision, do të punojmë që sa më shpejt ta kryejmë punën tonë si deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit për Kosovë të Re, askush nuk e do fjalën. Për SLS-në, deputeti Goran Marinković e ka fjalën.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne Liberalne Stranke podržace u načelu usvajanje Nacrta zakona i preko svojih predstavnika u komisijama daće svoj doprinos oko usvajanja istog.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit “6+”, kryetari Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftim dhe mendojmë se neni 4, paragrafi 9.1 është për ne kontestues dhe po ashtu kërkojmë që ky nen të mos ndryshohet, por të respektohet dhe të mbetet neni ekzistues i ligjit në fuqi, dhe me këtë rast Grupi Parlamentar “6+” do të abstenojë. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Është e deputetëve dhe i paraqitur për ta marrë fjalën është deputeti Lutfi Haziri. Nuk është këtu! Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Falemnderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe ju kolege deputete,

Duke pasur parasysh se ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për letërnjoftim është domosdoshmëri dhe nevojë e kohës, unë përshëndes ardhjen e këtij projektligji në Kuvend dhe konsideroj që ndryshimet e propozuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, konkretisht Ministria e Punëve të Brendshme të neneve të caktuara janë konform standardeve të legjislacionit të BE-së.

Me këtë projektligj krijohet infrastruktura ligjore që i hap rrugë pajisjes së qytetarëve me letërnjoftime biometrike. Ky projektligj ka për qëllim avancimin e të dhënave biometrike, si dhe funksionimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dhe duke pasur parasysh se tashmë veç është filluar me dhënien e pasaportave biometrike, që mund të merret si një matës i mirë i funksionimit të sistemit biometrik, konsideroj se çdo sfidë eventuale në dhënien e letërnjoftimeve, kur kemi bazë të mirë ligjore, do të tejkalohet me lehtësi.

Nenet e propozuara për ndryshim në këtë projektligj janë të studiuara mirë dhe e qartësojnë nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për letërnjoftim.

E theksoj edhe një herë se duke pasur parasysh që këto ndryshime janë të nevojshme, të domosdoshme dhe shumë të dobishme për qytetarët dhe proceset integruese nëpër të cilat po kalon Kosova, unë do ta përkrah këtë projektligj dhe e votoj në parim, e po ashtu do të mundohem që kontributin tim si deputete ta jap edhe në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së dhe njëherësh i ftoj edhe kolegët tjerë deputetë që ta përkrahin këtë projektligj.

KRYETARI: Është radha e votimit, por po kalojmë në shqyrtimin e parë të ligjit tjetër:

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologjinë

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Mimoza Kusari-Lila, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Falemnderit, i nderuari kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si bartëse e këtij projektligji, shkurtimisht të paraqes qëllimin, rëndësinë, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-203 për metrologji.

Arsyeja për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit është përmbushja e objektivave të Qeverisë së Kosovës në fushën e metrologjisë, ku janë vërejtur disa vështirësi sa i përket zbatimit të ligjit aktual në fuqi, e të cilat janë të domosdoshme të ndryshohen, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sistemit të metrologjisë, si parakusht për zbatimin e shumë udhëzimeve dhe standardeve teknike të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, në Raportin e Progresit për vitin 2011 është cekur se disa dispozita të Ligjit aktual për metrologji paraqesin dualizëm dhe përzjerje të kompetencave ndërmjet

Inspektoratit të Tregut dhe Inspektoratit të Metrologjisë dhe për këtë qëllim është propozuar të ndryshohet dhe të plotësohet ligji i lartpërmendur.

Ky projektligj është harmonizuar me ligjet tjera në fuqi, andaj edhe ndryshimet dhe plotësimet në këtë ligj i janë përshtatur legjislacionit të avancuar, sa i përket fushës së metrologjisë.

Projektligji ka për qëllim rregullimin e sistemit të njësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e parapaketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike, si dhe përgjegjësitë e strukturës përgjegjëse të metrologjisë së Kosovës.

Projektligji është hartuar në përputhje me procedurat e parapara me Rregulloren numër 09/2011 për punën e Qeverisë së Kosovës dhe është pranuar Deklarata financiare nga Ministria e Financave dhe Deklarata e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së nga Ministria e Integritetit Evropian dhe Projektligji i lartpërmendur është i harmonizuar me atë të BE-së.

Projektligji i ka 16 nene dhe e ka formën standarde, që parashihet për aktet juridike në Republikën e Kosovës.

Projektligji i propozuar mundëson forcimin e statusit të Departamentit të Metrologjisë në nivelin, të cilin e kanë të gjitha shtetet evropiane, që mundëson zbatimin më efikas të funksioneve profesionale, organizimin funksional të laboratorëve testues e kalibruar, respektivisht ngritjen e nivelit të Departamentit si pjesë përbërëse e infrastrukturës shtetërore të cilësisë, si dhe e përcakton qartë strukturën e njësive të specializuara në kuadër të metrologjisë.

Ligji për metrologjinë është propozuar të ndryshohet në disa pjesë për të mundësuar punë adekuate dhe për të optimizuar çështjet e organizimit, ridefinimit të rolit të institucioneve të metrologjisë, zbatimin e qasjes modulare për vlerësimin e konformitetit, për instrumentet joautomatike dhe për instrumentet matëse.

Disa nga ndryshimet themelore, të cilat janë propozuar për ndryshimin e Ligjit aktual janë:

- Është forcuar dhe avancuar struktura përgjegjëse e metrologjisë;
- Është shtuar një nen i ri që e rregullon përbërjen e sistemit shtetëror të metrologjisë;
- Është bërë bartja e kompetencës për autorizimin e subjekteve juridike, të cilat i plotësojnë kushtet për kryerjen e verifikimit, riparimin e mjeteve matëse në qarkullimin publik nga ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në Drejtorinë e Departamentit të Metrologjisë.

Inspektorati i Metrologjisë në disa aktivitete metrologjike, zëvendësohet me fjalët “Inspektorati i Tregut”.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për metrologji do t'i mundësojë Kosovës një avancim të sistemit të metrologjisë, si pjesë e infrastrukturës shtetërore të cilësisë.

Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, propozoj që ta shqyrtoni dhe miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputeti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Falemnderit, zoti kryetar!

E nderuara ministre,

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19.6.2012, e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji dhe në bazë të asaj që kemi vlerësuar dhe është debatuar në Kuvend, Komisioni vlerëson se Projektligji i plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar, deputetja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Falemnderit, kryetar!

Përshëndetje ministre,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar me vëmendje Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për metrologjinë.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji e rregullon sistemin e njësive matëse, etalonët shtetërorë, procedurat e vlerësimit, të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e parapaketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike, si dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Metrologjisë së Kosovës.

Gjatë analizës që e ka bërë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës ka hasur në jorregjueshmërinë e përdorimit të shprehjeve të njëjta për qëllim të njëjtë, si për shembull te neni 3, paragrafi 3 të Projektligjit thuhet “drejtori i përgjithshëm”, në paragrafët tjerë përdoret si “drejtor” dhe konsiderojmë se janë gabime të natyrës teknike. Ne si Grup Parlamentar e mbështetim në parim këtë projektligj dhe kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit në Komisionin FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Falemnderit, kryetar!

Qeveri!

Të respektuar kolegë deputetë,

Para nesh e kemi leximin e parë të ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për metrologji, do të thotë ndryshimin e ligjit, i cili veç ekziston dhe e rregullon fushën e metrologjisë.

Në fakt, sistemi i metrologjisë mund të thuhet se paraqet edhe një shenjë të rregullit dhe një shenjë të shtetësisë dhe Kosova e ka një përvojë mbi 60-vjeçare me ekzistimin e Institutit të Metrologjisë dhe me përvojat teorike e praktike, me respekt ndërkombëtar.

Pas lufte, kjo disiplinë shkencore dhe ky institut patën ndryshime dhe riorganizime të shumta.

Sot e kemi përpara këtë plotësim të ligjit. Ky projektligj, në fakt, nëse analizohet kah aspekti buxhetor, thuhet se kostoja e implementimit të këtij plotësim-ndryshimi në vitin 2012-2015 do të paraqesë 160.420 euro, si dhe do të punësojë 5 zyrtarë të rinj, dhe atë në vitin 2013 gjithsej 80.210 euro, njëjtë edhe më 2014. Por, ky buxhet shtesë nuk është i paraparë me kornizën afatmesme të shpenzimeve, ndonëse ministrja tha që Deklarata financiare është e aprovuar. Në dokumentin, të cilin ne e kemi, shihet se buxhet për këtë projektligj nuk ka në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe thuhet në deklaratë se Ministria sponsoruese duhet ta mbulojë këtë nga kursimet e veta. Në të kundërtën, ky ligj nuk mund të jetë i zbatueshëm.

Prandaj, edhe ky ligj hyn në atë grumbullin e shumë ligjeve, të cilat tashmë rregullisht vijnë në Kuvend, e të cilat nuk kanë hapësirë të paraparë e të planifikuar në Buxhetin e Kosovës. Dhe, mundësia e implementimit të këtyre llojeve të ligjeve dhe të këtij numri të ligjeve, me të vërtetë paraqet një problem.

Në memorandum, gjithashtu, thuhet se ky ligj ka prioritet dhe duhet të kalojë, e në anën tjetër pritet që prej kursimeve andej-këndej të sigurohet buxheti. Në memorandumin shpjegues, gjithashtu thuhet se për shkak të prioritetëve është kryer ndërtimi i laboratorit, pajisja me instrumente dhe me etalonë, trajnimi i stafit dhe strategjia e metrologjisë, gjë që është diçka pozitive. Por, në memorandum gjithashtu thuhet se me këtë ndryshim ligji do të bëhet ngritja e konkurrueshmërisë në treg dhe e eliminimit të barrierave.

Në ligj thuhet dhënia e mundësisë për subjekte juridike private, që të kryejnë shërbime dhe kjo është e rregulluar me disa nene. Për shembull, në nenin 2.2 flitet për autorizimin dhe dhënien e të drejtave për subjekte juridike tjera, të cilat nuk janë brenda në metrologji.

Në nenin 2.3, paragrafi 1.37, flitet për sigurimin e saktësisë së besueshme.

Në nenin 4a, 1.5, flitet se cilat janë ato subjekte të autorizuar dhe cilat janë mënyrat, dhe në dukje duket që subjektet juridike private kanë hapësirë për biznes nëpërmjet këtij ligji dhe kjo do të duhej të ishte diçka e mirë.

Mirëpo, në qoftë se shkojmë te nenet 6,7 dhe 8, atëherë e shohim një ndryshim prej kësaj ideje.

Në nenin 6.2 thuhet se drejtori i miraton ose i refuzon instrumentet matëse.

Në nenin n) 6.3 thuhet që ankesa mund të bëhet te komisioni profesional, e në ndërkohë ky komision profesional nuk është i definuar askund, nuk dihet se kush e paraqet atë komision profesional.

Në nenin 7 thuhet se drejtori, i gjithëfuqishmi, është ai i cili i autorizon subjektet juridike dhe vetëm nëse drejtorja nuk mund të kryejë ato shërbime. Do të thotë, në njërën anë thuhet që subjektet juridike tjera mund të kryejnë shërbime, në anën tjetër thuhet vetëm në qoftë se drejtorja nuk mund t'i kryejë shërbimet. Prandaj, ku është prioriteti ndaj subjekteve tjera, ndaj biznesit privat.

Në nenin 8.2, thuhet drejtori mund ta refuzojë subjektin juridik, edhe nëse ky subjekt i plotëson kushtet për autorizim.

Ju lutem, ky drejtor, i gjithëfuqishmi, i cili është në gjendje edhe të autorizojë, edhe të refuzojë, edhe të autorizojë instrumente, edhe të autorizojë etalonë! Cili ka qenë qëllimi i forcimit të këtij drejtori deri në këtë masë?

Ministrja na tha se me këtë ligj është forcuar struktura e përgjegjësisë. Cila strukturë e përgjegjësisë është forcuar? Këtu është forcuar drejtori, i cili e ka në duar komplet metrologjinë e një shteti.

Nenet tjera janë nene të cilat kanë të bëjnë me riemërime, në të cilat nuk do të ndalem, por mendojmë që biznesi me të vërtetë duhet të ketë hapësirë dhe ne si LDK mendojmë që ky projektligj mund të kalojë, por vërtet ka nevojë ta ketë një përpunim të rëndësishëm në komisionin përkatës funksional. Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri!

VISAR YMERI: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta përkrahë në parim këtë ligj. Konsiderojmë se janë disa plotësime të një ligji jashtëzakonisht të rëndësishëm sa i përket standardizimit të njësive matëse e matjeve tjera për sa i përket mallit dhe trajtimit të këtij malli në treg. Kështu që me të gjitha ato probleme, pak teknike dhe tjera që i ka ky ligj, do ta miratojmë në parim, duke shpresuar se këto pastaj do të ndryshohen dhe rregullohen sipas një logjike juridike që duhet ta ketë Kosova. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të AAK-së, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe mendon se metrologjia është infrastrukturë e rëndësishme shtetërore dhe në të njëjtën kohë disiplinë shkencore.

Ky projektligj adreson zhvillimin e një qëndrimi të qëndrueshëm dhe kompatibil të infrastrukturës metrologjike në Kosovë, me të cilën do të mundësohej ngritja e konkurrencës në tregun vendor dhe të jashtëm. Me këtë ligj, apo me udhëzime administrative, a janë përfshirë edhe këto kaptina të sistemit ndërkombëtar të njësive të standardeve, meqë Republika e Kosovës nuk e ka ende byronë për standarde dhe pesha, ku me fjalën “standard” kuptojmë përshkrimin e njëllotë të gjithë prodhimtarisë së një vendi. Kaptina të veçanta duhet të jenë: njësitë matëse, njësitë e sistemit ndërkombëtar të njësive, njësitë jashtë sistemit, njësia ES koherente, njësitë ES jokohërente, njësitë natyrale dhe atomike, njësitë e ndaluara, njësitë ES-I baza koherente, njësitë rrjedhura si koherente.

Ndryshimet në Ligjin e vitit 2006 kanë të bëjnë me ato kaptina, të cilat nuk kanë qenë mirë të punuara sipas direktivave të BE-së.

Neni 6 i këtij propozon dhe thuhet: “Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë e miraton tipin e instrumentit matës, kur ky i plotëson kërkesat teknike dhe metrologjike të parapara”. Definicioni është jokorrekt dhe i padefinuar mirë në fushën e matjeve.

Mendoj se kjo kompetencë nuk është e drejtorit, por është kompetencë e Bordit profesional të Drejtorisë së Metrologjisë dhe kërkojmë sqarim nga prezantuesi i ligjit. Cilët janë etalonët kombëtarë dhe sa është numri i tyre në nivel të shtetit? Me qëllim të zvogëlimit të kostos së këtij ligji, pse nuk janë përfshirë institucionet e tjera të matjeve në shkallë vendi për kalibrime të disa të madhësive fizike, si fakultetet përkatëse, institutet, për shembull matja e temperaturës, e shtypjes atmosferike, e lagështisë relative, matjet e tensioneve të rrymës elektrike, të shkarkimeve elektrike, të kapaciteteve e tjera.

Ne do ta përkrahim në parim, ndërsa gjatë amendamentimit të këtij ligji do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin për plotësim-ndryshimin e Ligjit për metrologji dhe duke pasur parasysh se Ligji për metrologji vetëm është në zbatim, ky plotësim-ndryshim i ligjit vjen si pasojë e Raportit të Progresit dhe më shumë shihet për përafrimin e standardeve të BE-së.

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar Projektligjin dhe në bazë të disa çështjeve teknike që duhet të adresohen në mënyrë më të qartë në Projektligj, e përkrah në parim Projektligjin për plotësim-ndryshim të metrologjisë për arsye të funksionimit të shtetit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të SLS-së nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit “6+”, deputetja Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

I Parlamentarna grupa “6+” podržaće Nacrt zakona o izmenama-dopuna Zakona o metrologiji, i svoj dalji doprinos daće kroz rad u komisiji, koja je zadužena za njega. Hvala!

KRYETARI: Falemnderit! Tani është radha e deputetëve. Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku.

LUTFI ZHARKU: Falemnderit, kryetar!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Do të mundohem shkurtimisht të paraqes disa kundërshti, të them të memorandumit shpjegues dhe të projektligjit, si dhe konceptit zhvillimor të metrologjisë.

Do të filloj nga ajo se në memorandumin shpjegues thuhet se derregullimi, si dhe shërbimet janë të orientuara kah tregu, të bazuara në kërkesë dhe në mënyrën konkurrenente.

Ky është një parim i Unionit Evropian, kurse në realitet në Projektligjin e propozuar e kemi një kundërshtim të këtij parimi në nenin 7, ku thuhet se “Drejtori i autorizon subjektet vetëm nëse Drejtoria e Metrologjisë nuk mund t’i kryejë ato shërbime”. Pra, deri sa në njërin anë, në bazë të parimeve të Unionit Evropian të shkohet në dhënien e këtyre shërbimeve kompanive, të cilat mund t’i kryejnë, ligji e bën një hap prapa dhe kthehet, do të thotë vetëm në ato shërbime që ne nuk mund t’i kryejmë, atëherë do t’ua japim kompanive të ndryshme.

Kjo i bie, në zhargonin tonë po flasim, që një biznes që mund ta kryej unë, do ta kryej vetë, kurse një biznes që s’mund ta kryej unë, do ta barti te bizneset tjera, gjë që është në kundërshtim me parimet themelore të Unionit Evropian. Janë arsye bazë, them pse Unioni Evropian tash e ka këtë qasje. E para është ajo që të hiqen institucionet shtetërore edhe Qeveria të largohet sa më shumë nga biznesi. Të mos bëjë Qeveria biznes, të mos bëjnë institucionet biznes. Dhe, e para është ajo që biznesi të lirohet sa më shumë që të jetë e mundur.

E dyta, është parimi që të mbrohet shteti nga çfarëdo padie eventuale, apo nga çfarëdo konteksti në rast se e kemi një dështim në kryerjen e një shërbimi të tillë që mund ta kryejnë kompanitë tjera.

Po e marrim si rast, që i marrim rregullisht pompat ne që jemi në biznes. Nëse Departamenti i Metrologjisë e kryen një kontroll të kalibrimit apo verifikimit në cilëndo pompë të caktuar dhe Inspektorati e vërteton më vonë që ai kalibrim ka qenë gabim, kush duhet të paditet? Në atë rast, çdo konsumator, por edhe kompania, në këtë rast pompa e benzinës, e padit ministrinë për shkak që nuk e ka bërë kalibrimin si duhet. Ministria apo

Inspektorati i ministrisë mund ta padisë kompaninë pse nuk e ka në rregull, e kompania e padit ministrinë pse ju nuk e keni kryer kalibrimin dhe kështu vijmë në një pozitë që kemi një shtyrje, të themi, të njëra-tjetrës. Kjo është arsyeja bazë që shteti duhet të jetë ai që përcakton rregulla, shteti bën mbikëqyrjen, por nuk përzihet në kryerjen e shërbimeve, të cilat mund t'i kryejnë kompanitë e ndryshme dhe çdoherë shteti është në situatë që nuk mund të jetë i paditur dhe t'i mbrojë konsumatorët e tij.

Çështja e dytë, që e përmendi edhe ministria, ligji po ndryshohet për shkak të kërkesave të Unionit Evropian. Në realitet, nëse e këqyrni në Raportin e Progresit për vitin 2011, askund nuk thuhet që Ligji i metrologjisë nuk i përshtatet apo ka dallime nga ai i Unionit Evropian. Në realitet, decidivisht thuhet në Raportin e Progresit se ende nuk është matur përputhshmëria e legjislacionit aktual me ligjet e Bashkimit Evropian.

Do të dal edhe te një çështje tjetër, në fund, e cila ka të bëjë me Inspektoratin e Metrologjisë dhe Tregut. Deri tash Inspektorati i Metrologjisë është në kuadër të Departamentit të Metrologjisë, e jo të tregut. Arsyeja e thjeshtë ka qenë për shkak se unë personalisht dyshoj në kompetencën profesionale, që inspektori i tregut mund ta kryejë një punë të inspektorit të metrologjisë.

Nuk mund inspektori i tregut kurrë ta vërtetojë një pajisje a një instrument nëse është i kalibruar, a është i verifikuar e tjera. Ajo është punë tipike profesionale. Unë plotësisht pajtohem nëse Inspektorati i Meteorologjisë kalon në Inspektoratin e Tregut, por jo që Inspektorati i Tregut t'i kryejë punët e Inspektoratit të Metrologjisë.

Për fund, më vjen mirë që në fund kanë filluar të pranohen të arriturat e kohës sa unë kam qenë në ministri. Memorandumi shpjegues thotë se ka pasur një përkushtim të madh të Departamentit të Metrologjisë për arritjen e standardeve më të mëdha, kështu që më vjen mirë për ato që janë shkruar aty, veçse e kam një dilemë, si është e mundur që gjithë ai përkushtim i madh, në fund, të kurorëzohet me performansë të dobët të drejtorit të Metrologjisë? Ju faleminderit!

KRYETARI: Mirë, qenka atëherë! Falemnderit! Për shkak se ekziston edhe disponimi për pushim, pauza deri në 14:30. A jeni dakord?

(Ndërhyrje)

Doni të vazhdojmë? Vazhdojmë atëherë.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetësi

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI FERID AGANI: Falemnderit, zoti kryetar!

I nderuari zoti kryetar i Kuvendit,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E kam kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Shëndetësisë, Kuvendit të Kosovës t'ia paraqes për miratim Projektligjin e shëndetësisë, dokumentin ligjor që e synon reformën përmbajtjesore dhe gjithëpërfshirëse të sistemit shëndetësor në vend dhe me këtë tejkalimin përfundimtar të gjendjes së jashtëzakonshme të shëndetësisë kosovare, e cila filloi qysh para 22 vjetëve.

Projektligji është punuar në kuadër të procesit gjithëpërfshirës konsultativ me kyçjen e profesionistëve vendorë shëndetësorë e të tjerë, si dhe në koordinim dhe konsultim të afërt me partnerët relevantë ndërkombëtarë dhe në veçanti me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, Organizatën Botërore të Shëndetësisë dhe agjenci të tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për shëndetësi.

Projektligji i shëndetësisë i vë themelet e reformës gjithëpërfshirëse të sistemit shëndetësor të vendit, që do të zhvillohet në dy etapa:

1. Etapa e parë e reformës organizative dhe strukturore, që do të fillojë me zbatimin e Projektligjit për shëndetësi dhe
2. Etapa e dytë, që nënkupton reformën e sistemit të financimit të sektorit shëndetësor, që do të fillojë me zbatimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore, pas dakordimit paraprak me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Projektligji i sigurimeve shëndetësore është pjesë përbërëse e pakos reformuese legjislativë dhe ai është i elaboruar në detaje me ekspertë vendorë, ekspertë ndërkombëtarë dhe është i dakorduar në tërësi me autoritetet e Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Momenti i miratimit të tij, siç e thashë më parë, do të përcaktohet në koordinim të plotë ndërmjet Qeverisë, Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së plotë financiare të sistemit të ri shëndetësor, të cilin po fillojmë ta ndërtojmë që nga dita e sotme.

Ky proces konsultativ do të sigurojë që reforma e sistemit shëndetësor të vendit të zbatohet në pajtim me standardet më të avancuara ndërkombëtare në këtë lëmi, përvojat e shteteve tjera në rajon dhe më gjerë, si dhe në koherencë të plotë me programet e tjera zhvillimore të Qeverisë së Kosovës, të përcaktuara me dokumente të përbashkëta programore, me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Projektligji i ka 22 krerë me gjithsej 96 nene dhe e përcakton kujdesin shëndetësor të organizuar, nivelin parësor, dytësor dhe tretësor, dhe definon organizimin dhe zbatimin e kujdesit shëndetësor, veprimtarinë shëndetësore, parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë shëndetësore, llojet e institucioneve shëndetësore, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore, politikat zhvillimore dhe financimin e kujdesit shëndetësor, shërbimin kombëtar të shëndetësisë ose shërbimin shëndetësor të Kosovës, nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, sistemin e informimit shëndetësor,

punëtorët shëndetësorë, veprimtarinë private shëndetësore, si dhe themelimin e odave të profesionistëve shëndetësorë.

Ndër ndryshimet më të rëndësishme reformuese, projektligji parasheh themelimin e agjencisë së financimit të shëndetësisë, si paraardhës i fondit të sigurimeve shëndetësore, që do të themelohet me rregullore të miratuar nga Qeveria dhe themelimin e shërbimit shëndetësor të Kosovës, si ndërmarrje publike, joprofite, që do të themelohet me vendim të Qeverisë, në pajtim me ligjin.

Në kuadër të kësaj ndërmarrjeje do të organizohen të gjitha institucionet publike shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Këto dy institucione do ta sigurojnë arritjen e shkallës më të lartë të cilësisë së shërbimeve shëndetësore nëpërmjet krijimit të hapësirës për autonomi financiare dhe kreativitet menaxherial dhe me këtë shtimi i efikasitetit, i efektivitetit, transparencës dhe llogaridhënies së menaxherëve të institucioneve shëndetësore dhe njërive të tyre përbërëse.

Themelimi i shërbimit shëndetësor të Kosovës paraqet të vetmen mënyrë për krijimin e mundësive për gjenerimin e të hyrave të reja në institucionet shëndetësore dhe për punësimin e shtuar të punëtorëve shëndetësorë në to, duke pasur parasysh mungesat e skajshme të kuadrit profesional në institucionet shëndetësore për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit, që ka të bëjë me mundësinë e tanishme ligjore të trajtimit të pacientëve të njëjtë njëkohësisht në institucionet publike dhe private shëndetësore, projektligji e përcakton ndalesën e punës në sektorin privat të shëndetësisë për të punësuarit në sektorin publik të shëndetësisë.

Kjo masë ligjore do të rezultojë me ndërprerjen e praktikës abuzive në institucionet publike shëndetësore të referimit, shumë herë të paarsyeshme, të pacientëve në sektorin privat për qëllime joprofionale, me çka në mënyrë të drejtpërdrejtë do të mbrohen shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore nga keqpërdorimet evidente.

Njëkohësisht, projektligji do të krijojë parakushte për ngritjen e dukshme të të ardhurave në sektorin publik të shëndetësisë, në mënyrë që punëtorët shëndetësorë, të punësuar në sektorin publik, të cilët me vite kanë investuar në institucionet e tyre private shëndetësore, të mos ndihen të cenuar me këtë masë ligjore.

Në këtë drejtim, projektligji e parasheh edhe fuqizimin e Inspektoratit shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë me 16 inspektorë të rinj.

Në vazhdim, projektligji parasheh sigurimin e mjeteve financiare për punësimin e 300 mjekëve të rinj për çdo vit, në kuadër të shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të qasjes në shërbime shëndetësore të qytetarëve në viset rurale, si dhe punësimin e 100 specialistëve të rinj për çdo vit, në funksion të përmirësimit të qasjes deri te shërbimet kualitative specialistike në nivelin dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor.

Projektligji i shëndetësisë ka kosto financiare prej 14.2 milionë euro, për vitin 2013, dhe në vlera të përafërta për dy vjetët e tjera të kornizës afatmesme të shpenzimeve 2012 - 2015, kosto kjo që është e dakorduar me Ministrinë e Financave, me Bankën Botërore dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Arsyeja pse kjo kosto nuk është e prezantuar në kornizën afatmesme të shpenzimeve është vetëm fakti se për të qenë e prezantuar në këtë kornizë, ligji paraprakisht duhet të jetë i miratuar në Kuvend.

Në momentin që ligji do të miratohet në Kuvendin e Kosovës, kostoja e këtij ligji do të prezantohet në kornizën afatmesme të shpenzimeve dhe në buxhetin për vitin 2013.

Projektligji e ka formën dhe strukturën standarde, që përdoret për legjislacionin e Republikës së Kosovës. Ai është në pajtim me Kushtetutën dhe me detyrimet ndërkombëtare, si dhe është i përafërt me dispozitat e detyrueshme të aquit komunitare të Bashkimit Evropian.

Ky projektligj është rezultat i punës së përkushtuar të numrit të madh të profesionistëve shëndetësorë dhe të tjerë, në kuadër të grupeve multidisiplinare, ndërministrorë dhe ndërsektoriale, përfshirë edhe përfaqësuesit e Federatës Sindikale të Shëndetësisë dhe Asociacionit të Mjekëve Privatë të Kosovës, Organizatën Botërore të Shëndetësisë, UNICEF-in dhe OSBE-në. Ndërsa, kontribut të veçantë në këtë drejtim, siç e përmenda më parë, kanë dhënë Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar, e në procesin e konsultimeve kanë qenë të përfshirë edhe Zyra e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë, si dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës.

Projektligji ka qenë subjekt i debateve publike dhe një dialogu të gjerë shoqëror.

I nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Duke përfunduar këtë ekspozë, më lejoni që të ju ftoj për mbështetjen e Projektligjit për shëndetësi, si rrugë e vetme ligjore. Dhe, të them ashtu, më e mira ligjore, për fillimin e ndryshimit të gjendjes në shëndetësinë kosovare, e cila, e dini shumë mirë, se çfarë është. Në 12 vjetët e pasluftës ka pasur përpjekje të shumta për ndryshimin e kësaj gjendjeje edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme ligjore, por asnjëherë nuk është arritur që të shkohet deri në fund me synimet tona.

Konsideroj se kjo pako reformuese, e cila përbëhet nga këto dy projektligje, të cilat janë komplementare plotësisht njëra me tjetrën dhe janë të dakorduara të zbatohen në mënyrë etapore, do ta sigurojnë këtë ndryshim aq shumë të pritur.

Faleminderit!

KRYETARI: Falemnderit, ministër!

Kryetari i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, deputeti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Falemnderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Deputetë,

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në mbledhjen e mbajtur më 13 qershor 2012, e ka shqyrtuar Projektligjin e shëndetësisë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të miratohet në parim.

Projektligji për shëndetësi është një ndër projektligjet më të rëndësishme të punës së komisionit dhe komisioni ka pritur një kohë të gjatë për procedimin e këtij projektligji.

Me gjithë faktin se projektligji prek një fushë shumë të rëndësishme, siç është shëndetësia, ky projektligj ka edhe disa dilema dhe disa vështirësi.

Fillimisht, kostoja buxhetore nuk është e mbuluar me buxhetin e vitit 2012 dhe nuk është paraparë as në kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015.

Gjithashtu, mjaft diskutabil është edhe menaxhimi i sektorit shëndetësor si ndërmarrje publike dhe përcaktimi i mjekëve për të punuar në vetëm njërin nga sektorët shëndetësorë, ose publikë, ose privatë.

Me gjithë dilemat që ekzistojnë, komisioni do të punojë me përkushtim dhe me të gjitha palët e interesit dhe mendojmë që brenda afatit të paraparë do ta amendamentojmë këtë projektligj.

Ju falemnderit për vëmendje!

(Seancën e merr nën drejtim nënkryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Falemnderit! Radha është e grupeve parlamentare për t'u deklaruar. Në emër të PDK-së, zonja Brovina.

FLORA BROVINA: Falemnderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë dhe kolege,

Më në fund, para vetes e kemi Ligjin e shumëpritur për shëndetësi. Nisur nga aspekti i rëndësisë së veçantë, për rregullimin e sistemit shëndetësor, të veprimtarisë së institucioneve shëndetësore dhe mbikëqyrjes së shëndetit, në përmirësim dhe rregullimit të gjendjes shëndetësore, në përgjithësi, në shtetin tonë dhe për shkak të rrënimit të pariparueshëm gjer më tani të shëndetësisë gjatë viteve të '90-ta dhe sidomos gjatë luftës, mungesës së mjeteve të mjaftueshme buxhetore të vendit tonë, si dhe mungesës së një vizioni më të qartë të zhvillimit shëndetësor dhe një vëmendje të përqendruar në këtë fushë, ne më në fund e kemi një ligj, të cilin e kemi shumëpritur.

Ligji i ri e ka një rëndësi të veçantë, siç u tha, dhe plotësohet edhe me ligjin, që duhet të vijë, e që është ligji për sigurimet shëndetësore dhe vetëm si i tillë ai mund të jetë funksional.

E kemi përcjellë punën e ministrisë dhe formimin e grupit të gjerë punues për formulimin e këtij ligji dhe kujtoj që në këtë ligj kanë marrë pjesë shumë profesionistë, sindikata - profesionistë shëndetësorë. Natyrisht, ligji parasheh hapjen e mundësisë së reformave në shëndetësi dhe përmirësimin e gjendjes aktuale të shumëpritur.

Tani ligji është para nesh. Dhe, shtrohet pyetja: A është ky pikërisht ligji, të cilin e kemi pritur dhe a i plotëson pritjet tona?

Ligji ka pritur një kohë të gjatë edhe në Qeveri, për shkak të vërejtjeve që ka pasur nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe nga Banka Botërore. Na vjen mirë që ligji, pasi e ka marrë edhe vizën nga këto dy institucione dhe institucione tjera ndërkombëtare, siç i përmendi edhe vetë ministri, vjen në Parlament.

Ligji i ri përfshin ambiciet e vetë ministrit për ndryshim dhe për të vënë rend në shëndetësi. Por, siç thashë, a i plotëson ky projektligj pritjet tona dhe sa është e mundur të jetë funksional? A mund të bëhet i tillë, pas një pune që e pret Komisionin Funksional, një punë shumë e madhe dhe amendamentimit të tij. Për të qenë funksional, ligjit i duhet nxjerrja e shumë nënligjore të reja, të cilat duhet të dalin nga ky ligj bazik.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar seriozisht Ligjin për shëndetësi. Mendojmë se vërejtjet tona do t'i japim edhe si grup parlamentar dhe pikërisht ky ligj e kërkon një debat të gjerë të opinionit publik dhe për shkak të ndjeshmërisë që ka, disa gjëra janë rregulluar shumë mirë, por i kemi vërejtjet dhe dilemat tona që lidhen me kompetencat e vetë ministrisë me formimin e odës, ose të odave profesionale, që parashihen të themelohen "si struktura të pavarura, që themelohen nga Kuvendi i Kosovës, ku të gjithë profesionistët mjekësorë duhet të jenë anëtarë (e nënvizoj - duhet të jenë anëtarë) në këto oda dhe të cilat vetëfinancohen. Fjalët janë pak jologjike dhe duhet dhënë shpjegime. A do të jetë një odë, a do të jenë shumë oda dhe si mund të jenë ato pra të pavarura dhe të vetëfinancohen?

Roli i vetë këtyre odave, gjithashtu është i paqartë - roli ose duhet shpjeguar se roli i Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik si një institut këshillëdhënës i ministrisë gjer më tani, zvogëlohet në bërjen e politikave dhe strategjive kombëtare të shëndetit, sikur zbehet, sepse dalin funksione tjera, siç është oda e merr një pjesë shumë të rëndësishme të këtij roli në strategjinë dhe në politikëbërje.

Në rangimet e mbrojtjes shëndetësore, në nivelin primar, sekondar dhe terciar, aty ku janë qendrat familjare, spitalet në nivelin komunal, ekzistojnë edhe qendrat rajonale. Këtë nuk e them vetëm për këtë ligj, por edhe në ligjet tjera, e vërejtje të tilla kam pasur edhe në ligjet, që i takojnë lëmit të çështjeve sociale.

Kujtoj se fjala “regionale”, një kuptim që nuk ekziston në Kushtetutën e Kosovës, duhet evituar edhe në Ligjin e shëndetësisë, sepse regjionet thashë se tash nuk janë. Ky është një kuptim shumë i hershëm, në kohën e sistemit okupues, pra në kohën e Milosheviqit, e ndoshta edhe më herët. Por, në Kushtetutën e Republikës së Kosovës regjione nuk ka.

Ndarja e mjekësisë private nga ajo publike, bashkëveprimi publiko-privat duhet sqaruar në detaje, sepse mund të na sjellë deri te rënia e nivelit ose kalimi i kuadrove shumë të rëndësishme nga njëri sistem në tjetrin. Prandaj, duhet të ketë parametra të ndjeshëm të ruajtjes së kuadrove në nivelin e shëndetit publik.

Vërejtjet tona jo të vogla, e përsëris, janë të lidhura edhe me specifikat e mbrojtjes shëndetësore, që janë vetëm e vetëm për vendin tonë, e që lidhen me strukturën e popullatës. Pikë së pari, dihet se Kosova e ka një mortalitet prenatal më të lartë në Evropë, prandaj kujtoj që duhet kushtuar vëmendje kësaj çështjeje dhe themelimit të këshillimoreve për nënat dhe fëmijët. Gjithashtu, mbrojtjes shëndetësore të fëmijëve, në veçanti, kur dihet numri i madh i fëmijëve parashkollorë, shkollorë, adoleshentë, të rinjve shkollarë dhe studentë. Kujtoj se ministria duhet të mendojë për shëndetin ose specializimet në shëndetësinë shkollore.

Problemet e lidhura me sëmundjet ngjitëse gjithnjë e më shumë po shtohen në këtë kategori të ndjeshme të popullatës, siç janë sëmundjet ngjitëse, higjiena, sëmundjet e veçanta, që duhet të detektohen në këtë moshë, pastaj paraqitja e veseve jo të mira, siç është pirja e duhanit, e alkoolit dhe e narkotikëve.

Kam vërejtje, të cilat ia kam theksuar edhe ish-ministrit, zotit Alush Gashi, kur është fjala për preventivën kundër kancerit të gjirit dhe kundër kancerit në përgjithësi dhe këto i theksoj edhe tani, meqë mendoj se nuk janë paraparë ose nuk janë theksuar në veçanti në këtë projektligj, e që është lufta kundër kancerit të gjirit dhe mitrës dhe futja e obligueshme e papatestit për moshën mbi 40-vjeçare në çdo dy vjet ose një vit, sipas mundësive tona ekonomike. Por, pse jo edhe futja e vaksinës, e cila praktikohet në shumë vende të botës.

Në projektligj mungon qasja për sëmundjet kronike, siç janë: sëmundjet kardiovaskulare, diabeti, tiroideja ose sëmundjet tjera, pra edhe ethet hemorragjike ose ethet reumatike. Ndërsa përmendet, sepse po të mos ishte përmendur, nuk do ta theksoja, tuberkulozi, kariesi, mjekësia sportive e të tjera.

Unë kujtoj që secila e ka vendin e vet dhe ndoshta duhet një përkushtim për secilën nga këto.

Të mos them se edhe sëmundjet gjenetike gjithashtu nuk trajtohen në nivel të duhur. Ne do të angazhohemi që ligji të plotësohet me vërejtjet tona dhe këto vërejtje të përkrahen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe dy minuta!

FLORA BROVINA: Do të kontribuojmë si grup parlamentar, por edhe veç e veç, duke qenë se kemi dëshmuar se dimë dhe mund të punojmë në organizimin shëndetësor dhe në mbrojtjen shëndetësore.

Sa i përket Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, besoj se kjo është baza, por së shpejti e presim edhe Ligjin për sigurimet shëndetësore.
Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Breca e ka fjalën!

NAZANE BRECA: Falemnderit!

I nderuari kryesues,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për shëndetësi dhe ne i kemi disa vërejtje, të cilat do t'i paraqes.

Koorporatizimi i sistemit të shërbimeve shëndetësore nuk premton asgjë sa i përket përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të sistemit të kujdesit shëndetësor. Përkundrazi, mund të jetë vetëm një fazë e shkurtër drejt privatizimit, për të cilin shoqëria kosovare akoma nuk është e përgatitur, e as e pjekur.

Centralizimi i qeverisjes së këtij shërbimi bie ndesh me tendencat bashkëkohore të decentralizimit të të gjitha shërbimeve. Nuk është rregulluar apo sqaruar përbërja e bordit të shërbimit kosovar të shëndetësisë, duke ia lënë Qeverisë duart e lira që në atë bord të emërojë militantë partiakë, pa asnjë prapavijë të paracaktuar shkencore, apo profesionale.

Nuk mendojmë se shërbimet shëndetësore mund të trajtohen si produktet tjera dhe mund të shiten e të blihen si ato. Prandaj, baza mbi të cilën qëndron ky koncept i propozuar me ligjin, shitblerja e shërbimeve shëndetësore apo zbatimi i ekonomisë së tregut në raportet mjek-pacient apo mjek-sigurim shëndetësor-pacient nuk ekziston fare, përderisa nuk ekziston as sistemi i sigurimeve shëndetësore.

Nëse ky ligj është aq origjinal dhe i veçantë, sa mund të ndërtohet dhe të qëndrojë edhe pa e pasur bazën, mbi të cilën pretendon të ndërtohet, atëherë propozuesi i tij duhet ta mbështesë të paktën me një analizë të mirë dhe të faktuar shkencore të fizibilitetit të tij.

Kjo është e domosdoshme para se t'i hyjmë një ndërmarrjeje të tillë. Ky mund të jetë dështim i përcjellë me një privatizim të egër dhe në mungesë të sistemit të sigurimeve shëndetësore, sistemi shëndetësor do të shitet dhe privatizohet shpejt. Në atë rast, përgjegjësinë do ta mbajmë të gjithë.

Në anën tjetër, në qoftë se ky lloj koorporatizimi i pretenduar si origjinal dhe pa mbështetje të mirëfilltë në ndonjë model të dëshmuar deri më tani, është menduar si paraetapë e natyrshme dhe e butë e privatizimit. Është më e ndershme, me kosto më efektive dhe më e drejtë që të tejkalohet fare.

Mendoj se më lehtë dhe më sigurt ka qenë të gjenden shembuj dhe modele të privatizimit të pjesshëm apo të plotë të shërbimeve shëndetësore. Nuk mendojmë se e kemi luksin, as material, as kohor, për të eksperimentuar me shërbimet tona shëndetësore edhe ashtu pothuajse të lodhura deri në kolaps.

Ky projektligj disa herë u referohet ligjeve, që priten apo planifikohen të përgatiten më vonë, gjë që shihet në disa nene, për shembull në nenin 4. Në kujdesin parësor shëndetësor nuk janë përmendur shërbimet në komunitet, ku hyjnë ato shërbime të kohëpaskohshme shëndetësore dhe edukativo-shëndetësore nëpër shkolla, krahas atyre shtëpiake, meqë janë me rëndësi për konceptin e mjekësisë familjare dhe në shëndetësinë publike.

Nuk besojmë në asnjë rast se Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik është institucion apo organ më i thirrur të përpilojë protokolle mjekësore. Gjithkund në botë, protokollet përpilohen dhe zhvillohen nga ata që i zbatojnë, pra nga ata që drejtpërdrejt janë të involvuar në ofrimin dhe zbatimin e shërbimeve përkatëse të kujdesit shëndetësor.

Në nenin 17, pika 2, përfshirja e Qendrës së Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të të Folurit në kujdesin parësor shëndetësor tregon qartë që edhe në këtë projektligj nuk janë qartësuar shërbimet shëndetësore si duhet, sepse në nivelin parësor parashihen të jepen shërbime të specializuara, që i takojnë nivelit sekondar.

Neni 18, pika 2, hap rrugë për shërbime mjekësore nëpër shkolla, që është në kundërshtim me konceptin e mjekësisë familjare.

Komunat janë përgjegjëse për sigurimin dhe zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor, por këtë duhet ta kenë të mbështetur në një strategji për kujdesin parësor shëndetësor, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë.

Në nenin 25 përmenden shërbime, të cilat nuk mund të jenë private, por për shumë arsye është mirë që këtu të futen edhe shërbimet urgjente dhe emergjente.

Në nenin 50, mendojmë se më e logjikshme është që SISH-in ta mbikëqyrë dhe organizojë Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik dhe raportet t'i përcjellë në fund. Në një mënyrë, forma e propozuar e organizimit i favorizon keqpërdorimet nga fondi dhe është konflikt interesi. Fondi që pagan për shërbime shëndetësore mbledh të dhënat për sasinë e atyre shërbimeve. Nëse këtë do ta bënte Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, atëherë kjo do të ishte edhe një formë e verifikimit të shpenzimeve të mjeteve nga fondi. Ndërkaq, kështu si propozohet, kjo nuk është e mundur.

Do ta futnim edhe një përgjegjësi në nenin 52, qoftë e menaxhuar nga Fondi apo Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, duhet të obligohet t'i sigurojë raportet përmbledhëse kthyesë dhe krahasuese për të gjitha institucionet shëndetësore, që i raportojnë të dhënat e tyre.

Mendojmë se është dashur të përcaktohen me një nen të veçantë të ligjit edhe kriteret e ndarjes së specializimeve, me të cilat aq shumë po manipulohet viteve të fundit.

Me gjithë këto vërejtje, Grupi Parlamentar i LDK-së në parim do ta miratojë këtë projektligj dhe kontributin tonë, këto vërejtje dhe vërejtje tjera, do t'i japim në Komisionin Funksional. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Ymeri e ka fjalën, në emër të Grupit “Vetëvendosje”.

VISAR YMERI: Falemnderit, kryesues!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jemi duke folur këtu për njërin prej sigurisht sektorëve më të rëndësishëm të zhvillimit shoqëror dhe zhvillimit të shtetit në përgjithësi, pra për shëndetësinë, duke e diskutuar Ligjin për shëndetësi.

Ky ligj është konsideruar dhe është përfolur mjaft, që prej se ka filluar të draftohet si pjesë e një reforme, që do të ndodhë në sektorin e shëndetësisë, pra me reformë, duke u nënkuptuar, edhe pse jo ndoshta në mënyrë eksplicite, një lloj përmirësimi. Pra, zakonisht fjala reformë te ne ka marrë konotacionin e përmirësimit, e ka humbur atë kuptimin fillestar të saj, që është rformatizim në njëfarë mënyre, i jepet një formë e re. Jo domosdoshmërisht ajo formë e re do të jetë më e mirë se sa kjo e vjetra.

Pra, është zgjedhur, në këtë rast, po them, një fjalë e këndshme për vesh, duke pasur parasysh se çfarë gjendje kemi në shëndetësi sot dhe duke pasur parasysh se të gjithë qytetarët e Kosovës, përfshirë madje këtu edhe zyrtarët në këtë Kuvend, por edhe zyrtarët e Qeverisë, e dinë dhe e pranojnë që në sektorin e shëndetësisë kemi shumë probleme, për shkak të keqmenaxhimit dhe për shkak të arsyeve tjera. Herë arsyetohet me mungesë fondesh, herë arsyetohet me mungesë të investimeve, e kështu me radhë, por të gjithë pajtohen në një pikë, se gjendja në shëndetësinë e Kosovës është jashtëzakonisht e keqe.

Me keqardhje duhet të them që ky ligj, që e kemi përpara, mënyra se si e kemi lexuar ne, nuk ka të bëjë fare me kurrfarë reforme për të mirë, pasi reforma natyrisht nënkupton një ndërmarrje të projektuar të hapave nga shteti për një periudhë të ndryshimit, ku shteti është aktori kryesor i udhëheqjes dhe zbatimit të kësaj reforme.

Pra, nënkuptohet, në këtë periudhë, të paktën, një lloj centralizimi i reformës në mënyrë që të forcohet sistemi dhe pastaj të shkohet me decentralizim, po qe se ideja e reformës është decentralizimi.

Këtu, në rastin në të cilin po flasim, reforma po mëton të realizohet me një ligj, ku decentralizimi është baza dhe ku decentralizohet madje edhe vetë ministria. Por, decentralizimi që erdhi nga Pakoja e Ahtisarit ka bërë që shëndetësia primare, pra mjekësia familjare, të jetë e decentralizuar në kompetencë të komunave, dhe kjo pa e pasur asnjë sistem të rregullt fillimisht.

Në vend se kjo të kompensohej me monitorim të shquar dhe të shtuar nga ministria, këtu edhe sistemi sekondar, pra me këtë ligj, spitalet rajonale, si dhe ai terciar, që është Qendra Klinike Universitare, po bëhen ndërmarrje publike joprofitabile, e cila do të quhet, sipas

këtij ligji, shërbimi kombëtar i shëndetësisë me bord udhëheqës dhe të tjera, duke i pasur parasysh parimet se si funksionojnë ndërmarrjet joprovitabile apo ndërmarrjet publike, të cilat në Kosovë pak a shumë janë korporatizuar.

Pra, ky është dekompozim i shtetit. Kjo është heqje dorë e shtetit nga përgjegjësia, të cilën e ka karshi këtij sektori me një akt të vetëm dhe kjo po quhet reformë, sikur reforma pastaj do të bëhet vetë. Pra, të hiqet dorë njëherë nga sektori, në përgjithësi, dhe pastaj ai reformohet vetvetiu! Natyrisht, ajo edhe do të reformohet vetvetiu, se do të reformohet nga kapitali privat. Mirëpo, a është kjo reformë, të cilën ne po e duam për sektorin e shëndetësisë? Pra, a është qëllimi i këtij ligji që ta krijojmë tërë sektorin e shëndetësisë në një ndërmarrje publike, të cilën pastaj do ta shesim, pasi ta kemi shitur KEK-un, PTK-në, “Trepçën”, e kështu me radhë. Pra, për ta vazhduar avazin e Qeverisë suaj për të shitur çdo gjë publike?

Çështja tjetër është që reforma në shëndetësi nuk mund të ketë dhe nuk ka kuptim pa e pasur edhe ligjin për sigurime shëndetësore. Këto janë dy ligje, të cilat duhet të shkojnë bashkë me njëra-tjetrën, për shkak se kanë ndërlidhje shumë të madhe me njëra-tjetrën. Dhe, varësisht prej vendimeve që i merrni, në njërin anë, duhet të reflektohen edhe në anën tjetër. Këto nuk janë të shkëputshme. Vetë ministri e ka deklaruar këtë. Fillimisht ka thënë se Ligji për shëndetësinë do të vijë bashkë me atë të sigurimeve shëndetësore. Pra, ky ka qenë premtimi fillestar, kur kemi filluar të flasim për këtë çështje. Madje-madje, ligji për sigurime shëndetësore ka dalë pjesërisht në publik shumë para këtij për shëndetësi.

Në pranverën e këtij viti pastaj, para Komisionit për Shëndetësi të Kuvendit ka deklaruar se në qershor do të vijë Ligji për shëndetësi, që e kemi këtu, kurse në shtator do të vijë Ligji për sigurime shëndetësore. Tash, pak a shumë po e kemi të qartë të gjithë se Ligji për sigurime shëndetësore ka mundësi të mos vijë edhe për disa vite. Kjo, sepse sigurimet shëndetësore janë në kundërshtim me atë politikë neoliberale të shtetit, të cilin po e zbaton verbërisht Qeveria e Kosovës.

Pra, këtu nuk bëhet fjalë për ndonjë reformë. Krejt çka bëhet fjalë është një ndarje e sektorit të shëndetësisë nga përgjegjësia shtetërore në një përgjegjësi të një ndërmarrjeje publike fillimisht, pastaj për t'i hapur rrugë privatizimit të kësaj, të kalimit të sektorit të shëndetësisë në një ndërmarrje absolutisht private. Dhe, kjo po na shitet pastaj si interes primar i qytetarëve.

Te neni 41 i ligjit parashihet ndalesa strikte e punës në të dy sektorët. Pra, këtu është fjala për mjekët në sektorin publik dhe atë privat. Dhe, parimisht kjo është në rregull. Me këtë pajtohem. Mirëpo, kjo mund të bëhet edhe mirë, edhe keq. Po që se bëhet në mënyrën qysh e ka paraparë ligji, pa pasur kurrfarë hapi të dizajnuar, që të merren masat paraprake për ta parandaluar dëmtimin e sektorit publik, që mund të ndodhë nga kjo ndalesë, atëherë natyrisht që e kemi një situatë, të cilën mund ta parashikojmë shumë lehtë. Shumica e mjekëve do të shkojnë te sektori privat dhe do ta kemi sektorin publik pastaj pa mjekë.

Kjo është e dëmshme edhe në një aspekt tjetër, kur ta kemi parasysh që këta mjekë të sektorit publik janë mjekë të cilët janë shkolluar dhe janë trajnuar nga paratë publike të

Kosovës, pra nëpërmjet Buxhetit të Kosovës. Dhe, tash, në njëfarë mënyre kemi prodhuar kuadro të një niveli të caktuar, të tillë çfarë janë për sektorin privat, pra për kapitalin privat për të realizuar profite në një ndërmarrje, e cila nuk i sjell profite shtetit të Kosovës, si e tillë.

Një çështje tjetër ka të bëjë me mbikëqyrjen profesionale. Pra, në ligj nuk është qartësuar fare mbikëqyrja profesionale. Përderisa Inspektorati thuhet që do ta monitorojë zbatimin e ligjit, mbikëqyrja profesionale do të duhej ta monitoronte cilësinë dhe profesionalizmin që ofrohet në shërbimin shëndetësor.

Në nenet 7, 41 dhe 71, në të cilat flitet për mbikëqyrjen profesionale, kjo çështje lihet e paqartë dhe në kompetencë të Odës së Mjekëve, për të cilën nuk përcaktohet kurrfarë afati se kur do të themelohet.

Mbikëqyrja duhet të jetë përgjegjësi e personave konkretë që mbikëqyrin dhe ata duhet të jenë të verifikuar si mbikëqyrës e jo kjo të lihet në përgjegjësinë e një ode, e cila as nuk e dimë se kur do të themelohet dhe pastaj nuk e dimë edhe si do ta bëjë këtë mbikëqyrje.

Dhe, një çështje e fundit, që dua ta përmend për këtë ligj, përveç këtyre që i thashë, është edhe ajo që u përmend më herët nga disa deputetë. Është çështja e këtij parimi të partneritetit publiko-privat, i cili mëtohet të futet edhe në shëndetësi dhe nuk qartësohet në ligj të paktën a do ta ketë një trajtim të veçantë ky lloj parimi sa i përket sektorit të shëndetësisë apo do ta trajtojmë këtë partneritet sikur e trajtojmë në aspekte tjera të shërbimeve, që i ofron e që do të duhej t'i ofronte shteti i Kosovës dhe me këtë barazohet në njëfarë mënyre sektori i shëndetësisë me sektorët tjerë. Pra, në njëfarë mënyre, sektorin e shëndetësisë apo këtë ndërmarrjen e re, që do ta krijojmë me këtë ligj po e trajtojmë sikur të ishte Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës. Edhe këtë mund ta japim me koncesion dhe pastaj t'i barazojmë këto dy shërbime, të cilat në asnjë mënyrë nuk mund të barazohen për nga rëndësia, jo vetëm për shtetin, po veçanërisht për qytetarin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Pas shumë kohë pritjeje, më në fund erdhi ligji i shumëpritur i reformave në shëndetësi, Ligji i shëndetësisë. Ligj që është dashur të vijë më herët dhe të vijë si pako e ligjeve, bashkë me Ligjin e sigurimeve shëndetësore, sepse ashtu do të kishin kompletuar njëri-tjetrin dhe hezitimet që kemi për këtë ligj, se mund të bëhen reforma në shëndetësi, do të kishin qenë më të vogla.

Në vazhdim po i cekim disa të meta të ligjit ose disa paqartësi, sipas renditjes.

Neni 17, - Llojet e institucioneve shëndetësore, që ndahen në primare, sekondare dhe terciare, në nivelin sekondar janë renditur, përpos të tjerave, qendra e mjekësisë sportive dhe qendra e mjekësisë së punës. Ndërsa, në institucionet e nivelit terciar, prapë janë

renditur qendra kombëtare e mjekësisë së punës dhe qendra kombëtare e mjekësisë së sportit. A ekzistojnë këto qendra?

Neni 26, paragrafi 2, thuhet se barnat e përshkruara nga mjeku ose stomatologu mund të jepen vetëm nga prania e farmacistit të diplomuar. Si keni menduar ta kontrolloni këtë, kur një farmacist punon në më shumë se sa në një barnatore?

Neni 41, - “Parandalimi i konfliktit të interesit”. Këtu përcaktohet se profesionisti shëndetësor i punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesshëm të punës, nuk ka të drejtë të punojë në institucionet private të kujdesit shëndetësor.

Ne pajtohemi që të bëhet kjo ndarje. Por, sikur ta kishim Ligjin e sigurimeve shëndetësore, sepse profesionistët me këtë pagë që ofron institucioni publik, pa dyshim se do ta zgjedhin institucionin privat dhe me këtë dëmtohet edhe pacienti, sepse nuk ka mundësi të zgjedhjes së mjekut adekuat, sepse në sektorin privat pagesa është shumëfish më e madhe, e pacientët në këtë situatë ekonomike nuk mund të zgjedhin, por detyrimisht janë të detyruar të trajtohen në sektorin publik. A mendoni se mjekët do të besojnë në reforma të shpejta dhe në pagesë sipas performansës, që të binden të punojnë në sektorin publik? Kjo formë ndoshta ka pasur sukses në vendet më të zhvilluara, por në situatën aktuale buxhetore të shëndetësisë, kjo është e pamundur të realizohet.

Dhe, kush do ta ndalojë konfliktin e interesit, si në pikat në vazhdim: dy, tre, katër, sepse vetë Inspektorati Shëndetësor, apo disa punëtorë vetë kanë konflikt interesi, sepse mbajnë dy detyra të punës, në kundërshtim me ligjin.

Apo çështja e inspektimit në kundërshtim me Ligjin e Inspektoratit, së cilës pyetje në takimin e kaluar nuk iu përgjigje, zoti ministër, duke u bërë se s’po di, apo se nuk po e kupton pyetjen. Nëse mendon ta luftosh konfliktin e interesit, nisja nga vetë Ministria e Shëndetësisë!

Neni 60, - “Shërbimi kombëtar i shëndetësisë”. Mendojmë se këtu po bëhet edhe një ministri tjetër, sepse rolin e mbikëqyrjes së nivelit sekondar dhe terciar të shëndetësisë, që bëhet nga Ministria e Shëndetësisë, tash bëhet nga shërbimi kombëtar, i cili drejtohet nga Bordi drejtues i emëruar nga ministri i Shëndetësisë. Kemi ndërrim të titullarëve në këto sisteme dhe dyfishim të titullarëve. Ndoshta në të ardhmen do të sjellë probleme, nëse nuk definohen si duhet detyrat e tyre.

Neni 71, - “Odat e profesionistëve shëndetësorë”. Sipas projektligjit, këto oda formohen nga Kuvendi i Kosovës. Këto oda për punën e tyre e informojnë rregullisht ministrin. Oda financohet nga anëtarësia, gjë që nuk është në rregull. Odat duhet ta kenë një vijë buxhetore, në mënyrë që të funksionojnë si duhet.

Odat kanë një mori detyrash: rregullimin dhe mbikëqyrjen profesionale gjatë punës, trajnimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Ministër, çfarë do të bëhet me bordet që ekzistojnë në Ministrinë e Shëndetësisë e që merren me këto veprimtari?

Këto borde dhe ky personal, a do të kalojnë në odat përkatëse profesionale dhe a do të kalojë ai buxhet në oda?

Atëherë, Ministria e Shëndetësisë do të merret veç me politikat zhvillimore dhe Inspektoratin. Këto janë disa nga vërejtjet e shumta, por nëse sot kalon ky projektligj, gjatë amendamentimit do ta japim maksimumin që ai të jetë ligj, që në qendër do ta ketë pacientin dhe mirëqenien e tij shëndetësore. Unë si anëtare e komisionit, për hir se ky ligj është vonuar, e kam përkrahur në komision, që sot të vijë në seancë. Ndërsa, pas shqyrtimit si Grup Parlamentar, ne mendojmë se vetë Aleanca e ka një program më të mirë shëndetësor dhe në parim nuk do ta përkrahim këtë projektligj. Falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Nga Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka Gëzim Kelmendi.

GËZIM KELMENDI: Falemnderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim që procedimi i Projektligjit për shëndetësi në Kuvendin e Republikës së Kosovës ka qenë më se i domosdoshëm dhe i mirëseardhur për shumë arsye. Në radhë të parë, të gjithë e dimë dhe jemi dëshmitarë se shëndetësia kosovare në vitet e pasluftës, edhe pse shumë më herët, është e zhytur në një situatë mjaft të rëndë, sidomos për pacientët.

Duhet me keqardhje ta pranojmë se në shëndetësinë kosovare aktualisht e kemi një krizë të thellë etike, morale dhe profesionale. Pacienti, në të shumtën e rasteve, jo në të gjitha rastet, nuk shikohet si objekt, të cilit i ofrohet ndihma dhe humanizmi, por si një objekt i përfitimit.

Është fakt që mjekët, shumica e tyre, kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë me nder dhe zell në profesionin e tyre, nuk duhet ta harrojmë edhe një fakt, se është një numër shumë i madh i mjekëve, të cilët aktualisht e kanë shfrytëzuar situatën aktuale në shëndetësinë e Kosovës dhe kanë tentuar që në vetë vendin ku punojnë, në institucionin publik, të marrin përfitimet e tyre materiale, qoftë në vendin ku punojnë, qoftë me referimin e pacientit të tyre nëpër institucionet private.

Prandaj, pa dyshim që Projektligji për shëndetësi paraqet një reformë bazë për shëndetësinë kosovare aktuale, për faktin që u cek më herët se në nenin 41 ndalohet konflikti i interesit, më pas themelimi i odave të profesionistëve dhe themelimi i shërbimit të shëndetësisë kosovare.

Sa i përket nenit 41, në të cilin ceket ndalimi i konfliktit të interesit, kjo është çështja më se e domosdoshme dhe e nevojshme që të ndalohen të gjitha ato dukuri tashmë të njohura për shëndetësinë kosovare.

Me keqardhje e them, por shumë mjekë kanë rënë pre e kësaj dukurie, edhe pse po them jo të gjithë mjekët. Ka shumë mjekë, të cilët punojnë me ndershmëri dhe me përgjegjësi të plotë profesionale dhe etike. Por, një numër shumë i madh i tyre janë duke e keqpërdorur pozitën e tyre aktuale, duke marrë në vendin e punës, në institucionin publik, mjete, gjë që është e ndaluar, e njohur si mitomani dhe, dukuria e dytë, referimi i pacientëve nëpër institucionet private.

Neni 41 pikërisht paraqet një masë ndaluese kësaj dukurie mjaft të përhapur dhe të dëmshme për shoqërinë kosovare.

Sa i përket kujdesit primar shëndetësor, mund të themi se pa dyshim kjo kategori apo ky nivel i kujdesit shëndetësor nuk ka qenë i përfshirë në këto dukuri negative shumë, për faktin se mjeku, kryesisht në shëndetin primar, konkretisht mjeku familjar, ka qenë i ngarkuar me punë me një numër jashtë normës së pacientëve dhe, megjithatë, ai është mjaftuar me një rrogë, të cilën e ka marrë nga institucioni përgjegjës, përderisa një dukuri të tillë nuk e kemi pasur në institucionet sekondare dhe terciare, ku mjekët, kolegët e tyre, përveç numrit të pacientëve, përveç pagës së tyre, kanë pasur edhe përfitime të tilla.

Dukuri të tilla kryesisht hasim në klinikat e ndryshme, do të thotë të nivelit sekondar, duke përfshirë kirurgjinë, në përgjithësi, të gjitha lëmit e kirurgjisë, pastaj gjinekologjinë, urologjinë, kardiologjinë, në të gjitha këto lëmi të cilat kemi vërejtur se ka shumë keqpërdorime të pozitës.

Sa i përket asaj, për çka u hapën shumë dilema, se nëse vjen deri te ndarja, ashtu siç është paraparë me nenin 41, që një punëtor shëndetësor nuk lejohet të punojë njëkohësisht edhe në sektorin publik, edhe në sektorin privat, do të ballafaqohemi me ikje të personelit shëndetësor. Unë e them me plot përgjegjësi se nuk do ta kemi atë problem, për faktin se ne si Komision Parlamentar i Shëndetësisë kemi realizuar vizita jashtë Kosovës dhe kemi marrë përvojat e tyre, që kjo është e vetmja rrugë që të parandalohet konflikti i interesit.

Të mos e harrojmë edhe një gjë! Në kohën kur u ngrit shëndetësia kosovare, kur u ngrit Universiteti i Prishtinës, ishin mjekët e rinj të posadiplomuar ata që e mbajtën barrën kryesore të themelimit të institucioneve shëndetësore. Prandaj, edhe sot kemi shumë kuadro, qoftë profesorë, qoftë asistentë, qoftë doktorë, të cilët janë të punësuar, por edhe të cilët presin të punësohen në sektorin publik.

Përparësi tjetër e këtij neni, i cili parasheh ndarjen, përveç luftimit të konfliktit të interesit, është se nëpërmjet këtij neni gjenerohen edhe vende të reja të punës. Ne sot jemi duke u ballafaquar me një numër shumë të madh të mjekëve të posadiplomuar, qoftë në Universitetin e Prishtinës, qoftë në atë të Tiranës, apo edhe jashtë rajonit, më pastaj edhe të specializuar, e po ballafaqohen me vështirësi punësimi.

Prandaj, ky nen, kjo mundësi e ndarjes së sektorit publik dhe privat, u hap mundësi dhe gjeneron vende të reja të punës, ku mjeku definitivisht do të profilizohet për sektorin publik, apo për atë privat.

Tash na vjen në pyetje edhe një send tjetër, të cilin disa grupe interesi apo disa mjekë e kanë vënë në pikëpyetje për shkak të përfitimeve materiale. Çka nëse do të profilizohet, qoftë në sektorin publik, qoftë në sektorin privat? Ai mjek i cili punon në sektorin privat e ka numrin e vet të pacientëve dhe i ka të ardhurat e veta mujore, ashtu siç i ka paraparë. Por, nëse ai në sektorin publik nuk do të mbijetojë dhe nuk do të punojë vetëm falë rrogës, pasi fort mirë është paraparë se mjeku, i cili punon në sektorin publik nuk do të paguhet njëjtë me kolegun e tij, i cili ka numër më të vogël të pacientëve, por pagesa do të jetë në bazë të performansës, varësisht nga puna e tij, nga numri i pacientëve të tij mjeku do të arrijë të gjenerojë të ardhura mujore më shumë. Kështu që kjo dilemë e numrit, e largimit të profesionistëve, largohet.

Dilema e përfitimit material, largohet. Do të thotë, kemi ardhur në një kohë, kur vetëm ne si vend kemi mbetur me një sistem të tillë shëndetësor dhe ky ligj-projektligj e rregullon siç është më së miri reformën shëndetësore, duke filluar në masë të madhe me parandalimin e konfliktit të interesit dhe në masë të madhe gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Si bazë tjetër e kësaj reforme, pa dyshim është edhe themelimi i odave të profesionistëve shëndetësorë, meqë deri më tash një gjë e tillë ka munguar. Ka qenë absurde si Ministria e Shëndetësisë si institucion të merret me politikat e specializimit apo edukimit pasdiplomik të mjekëve. Një gjë e tillë, në asnjë vend nuk e bën Ministria e Shëndetësisë. Një gjë e tillë e bëjnë odat e profesionistëve shëndetësorë. Ata, në bazë të nevojave, kriteriumit dhe kushteve, i plotësojnë kriteret për specializime, studime pasdiplomike, subspecializime dhe profilizime të tjera.

Prandaj, ky ligj parasheh themelimin e këtyre odave të profesionistëve shëndetësorë, që pa dyshim është një lehtësim dhe decentralizim i kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë te personat, konkretisht te institucionet kompetente për edukimin specialistik të mjekëve të posadiplomuar.

Është për t'u përshëndetur gjithashtu edhe vendimi i Ministrisë së Shëndetësisë që është paraparë nëpërmjet këtij ligji, që të hapen vende të reja të punës për 300 mjekë të posadiplomuar dhe 100 mjekë specialistë të rinj.

Pa dyshim, pjesë reformuese e këtij sistemi është edhe themelimi i Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë. Që të tria këto bashkë, do të thotë ndalimi i konfliktit të interesit, themelimi i odave të profesionistëve shëndetësorë dhe themelimi i Shërbimit Shëndetësor të Kosovës, paraqesin rrënjën kryesore të kësaj pakoje reformuese të këtij Ligji për shëndetësi, gjë që aktualisht në shëndetësinë kosovare nuk e kemi pasur.

Ne e dimë se aktualisht jemi duke u ballafaquar me mundësi jo të mira materiale. Një krahasim i thjeshtë dhe i qartë: Vendi ynë fqinj në rajon, Sllovenia, me një numër të njëjtë të banorëve sikur Kosova - 2.000.000 banorë, ka buxhet vjetor për shëndetësi - 3.000.000.000 euro, ndërsa ne kemi një buxhet 120.000.000 euro. Prandaj, ne nuk mund të presim ndryshime brenda natës, po ky projektligj hap rrugën, që në radhë të parë, të gjenerohen vende të reja të punës, në radhë të dytë të ndalohej konflikti i interesit dhe në radhë të tretë, decentralizimi i kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë te personat,

konkretisht institucionet profesionale për edukimin pasdiplomik të mjekëve të posadiplomuar.

Ne si Koalicion për Kosovën e Re do ta përkrahim këtë projektligj dhe gjithashtu vërejtjet dhe sugjerimet tona do t'i japim në Komisionin për Shëndetësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi Parlamentar SLS, nuk është paraqitur. Grupi Parlamentar "6+", zoti Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA:

Sayın Meclis Başkanına teşekkür ederim,

Sağlık Yasa Tasarısı uzun zamandır beklenen ve Kosova'da iyi gitmeyen olan sağlık sektörünün iyileştirmeye yönelik radikal adımlar atılacağını görmekteyiz. Yasa, sağlık sektöründeki hastanelerin işletilmesini yeniden düzenlemektedir. Bu düzenlemeye göre hastaneler, kar elde etmeyen kamu şirketleri olarak çalışacaklardır. Günümüzde Kosova'daki kamu şirketlerinin işletilmesini göz önünde bulundurursak bu konuda hastanelerin işletilmesi, bizim açımızdan soru işaretleri getirecek diye düşünüyoruz.

Yasada özellikle sağlık sektöründe doktorlarımızın hem devlet hem de özel sektörde çalışmalarının yasaklanması, Kosova sağlık sektöründe risk içeren yeni bir sayfa açmaktadır. Bu yasayla yeni yönetim şekli hastanelerizin daha işlevsel, daha kaliteli, daha şeffaf ve hesap veren işletme birimleri olarak düzenlenmektedir.

Yasanın bu şekilde uygulanması, elbette ek bütçeye ihtiyaç olduğunu görülmektedir. Tüm bu konuları vurgularken "6+", Parolmenter Grubu olarak Yasa Tasarısını desteklemekteyiz.

KRYESUESI: Falemnderit!

Duhet ta kërkoh një mendim tuajin, po mendoj që ndoshta është koha për pauzë. Janë edhe 11 të paraqitur. Doni të vazhdojmë apo të bëjmë pauzë?

Pauzë për drekë deri në orën 15:00!

Ju lus të ktheheni në orën 15:00, të mos e zvarritim! Kemi mjaft kohë për drekë, një orë e pesëmbëdhjetë minuta.

* * *

(Pas pauzës së drekës, seanca i vazhdon punimet.)

KRYESUESI: Po e vazhdojmë seancën. Diskutuesja e radhës është Blerta Deliu.

BLERTA DELIU: Falemnderit, kryesues!

Unë do ta dorëzoj diskutimin tim me shkrim. Jam parapërgatitur më herët, por do ta dorëzoj fjalimin me shkrim. Falemnderit!

(P:S: Diskutimi deri më tani nuk është dorëzuar.)

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Deputetë të Kuvendit,

Diskutimin tim lidhur me këtë draftligj do ta filloja me komentimin e dispozitave të nenit 94, sipas të cilit Qeveria dhe Ministria e Shëndetësisë do t'i miratojnë akte të nevojshme nënligjore, për zbatimin e këtij ligji.

E meta e kësaj dispozite, është se nuk i cakton ndonjë afat kohor Qeverisë dhe Ministrisë për miratimin e këtyre akteve nënligjore, kurse e meta e përgjithshme e këtij ligji, është se shumë çështje që duhet rregulluar me dispozitat e tij, kanë mbetur të rregullohen me akte nënligjore. Diku përafërsisht, mbi 30 akte nënligjore duhet miratuar për zbatimin e këtij ligji. Kurse, vërejtja tjetër ka të bëjë me disa prej përkufizimeve për shprehjet e përdorura në këtë ligj.

Kësisoj nuk është e qartë pse dallohet qytetari prej banorit, kur sipas nenit 4, paragrafit 2, të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor. Andaj, jam i mendimit se nuk ka nevojë të bëhet një ndarje apo një dallim ndërmjet shprehjes “qytetar” dhe shprehjes “banor”.

Më tutje, në nenin 18, pika 8, kërkohet, citoj: “prej çdo qytetari dhe banori që të përcaktohet për një mjek familjar” Duke pasur parasysh gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale të popullatës kosovare, ku mbi 45% janë të papunë dhe duke pasur parasysh strukturën dhe organizimin e sistemit tonë shëndetësor, mendoj se dispozitat e këtij paragrafi do të mbesin vetëm shkronjë në letër, të cilat edhe një kohë të gjatë nuk do të mund të zbatohen në praktikën tonë, kurse është e ditur se dispozitat e ligjit aprovohen për t'u zbatuar e jo vetëm sa për sy e faqe.

Dispozitë, po ashtu të pazbatueshme, thuaja se përmban edhe paragrafi 5 i nenit 64, në të cilin thuhet: “Pas licencimit të profesionistit shëndetësor nga Oda përkatëse, ai që përcaktohet për të punuar në ambulancat të mjekësisë familjare në viset rurale, do të punësohet menjëherë, në kuadër të shërbimit mjekësor familjar për periudhën prej dy vjetëve.”. Unë vërtet, do të isha i lumtur sikur profesionistët shëndetësorë do të mund të punësoheshin menjëherë pas licencimit, por duke pasur parasysh numrin e madh të punëkërkuesve të këtij profesioni dhe kapacitetet e sistemit tonë shëndetësor, dyshoj se kjo dispozitë do të zbatohet në tërësi dhe ndaj të gjithë punëtorëve shëndetësorë në Kosovë.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me masën e ndalimit të punës së institucionit shëndetësor, që rregullohet me nenin 88 të këtij ligji. Në paragrafin 2 theksohet se institucionit shëndetësor, tek i cili në mënyrë të përsëritur Inspektorati konstaton parregullsi, i ndalohet puna.

Siç po shihet, në këtë paragraf, përdoret shprehja “në mënyrë të përsëritur”, që është shprehje jo përcaktuese, sepse “përsëritje” konsiderohet kryerja dy herë e parregullsisë, por “përsëritje” konsiderohet edhe kryerja 200 herë e veprimit të tillë. Andaj, mirë është të përcaktohet më konkretisht numri i shkeljeve ligjore dhe afati i kryerjes së tyre.

Sipas paragrafit 4 të këtij neni, pra nenit 88, institucioni shëndetësor që i është ndaluar puna, ka të drejtë ankese në pajtim me këtë ligj. Por, e vërteta është se ky ligj nuk e rregullon fare zbatimin e së drejtës së ankesës së këtillë, që domethënë se as nuk parasheh afatin, as organin i cili vendos për ankesën e as çështje tjera që kanë të bëjnë me ankesën. Thjesht, ajo është përmendur vetëm në mënyrë deklarative.

Dhe, vërejtja e fundit, që mund t’i bëhet këtij ligji, nga ana ime, kuptohet, ka të bëjë me procesin e licencimit të institucionit, si njërin prej kriterëve bazike për fillimin e punës së tyre.

Ç’është e vërteta, në nenin 42 të këtij ligji theksohet se licencimin do ta bëjë Ministria konform aktit nënligjor, që do ta nxjerrë, por unë jam i mendimit se duke pasur parasysh rëndësinë që ka akti i licencimit për punën, ekzistimin dhe veprimtarinë e çdo institucioni shëndetësor, pikërisht me dispozitat e këtij ligji duhet të rregullohen kriteret e hapësirës punuese, kuadri profesional dhe pajisjet si dhe procedura për licencimin e këtyre institucioneve. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI: Falemnderit! Zonja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për shëndetësi ka qenë nevojë e kahershme që të plotësohet dhe ndryshohet, por bashkë me këtë projektligj do të ishte më mirë që të ishte edhe Projektligji për sigurimet shëndetësore, sepse po të ishin në paket këto ligje, edhe miratimi edhe zbatimi i tyre në praktikë do të ishte më i lehtë.

Por, meqenëse tani kemi për shqyrtim Projektligjin për shëndetësi, unë do të fokusohem vetëm në të.

E di se në hartimin e këtij projektligji kanë marrë pjesë ekspertë të fushave përkatëse, por edhe ne si Komision për Shëndetësi kemi parë për së afërmi punën e tyre gjatë prezantimit në njërën nga takimet e grupeve punuese. Edhe pse shumicën e takimeve i ka udhëhequr vetë ministri i Shëndetësisë, konsideroj se ky projektligj për shkak të rëndësisë që ka, ka shumë për t’u plotësuar edhe nga Kuvendi.

Për shembull, te përkufizimet ka nevojë që të sqarohet çka është Agjencia Financiare e Shëndetësisë, si do të funksionojë, cili është roli i saj, kush do të jetë në këtë agjenci? Do të pranohen punëtorë apo ka burime njerëzore brenda Ministrisë së Shëndetësisë?

Përsëri, në nenin 13, për këtë agjenci thuhet se do të përcaktojë skemën stimulative, me qëllim të përmirësimit të standardeve në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, skemë e cila deri më tash ka funksionuar vetëm në teori e jo në praktikë. Për këtë na duhen më shumë sqarime nga ministri i Shëndetësisë.

Neni 16, paragrafi 3, sistemi unik, po citoj: “Tërësia dhe vazhdimësia e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në të tri nivelet e organizimit, sigurohet me zbatimin e sistemit të plotë të referimit nga niveli parësor në atë dytësor dhe nga niveli dytësor në atë tretësor të kujdesit shëndetësor, si dhe me zbatimin e koordinimit dhe komunikimit të ndërsjellë, në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor.”. Edhe pse me ligjin në fuqi ka qenë e rregulluar mënyra e referimit dhe komunikimit, por nuk ka funksionuar, për arsye se sistemi shëndetësor është menaxhuar nga nivele të ndryshme, niveli parësor nga komunat, e ai dytësor dhe tretësor nga Ministria e Shëndetësisë.

Do të ishte më mirë, sikur edhe niveli dytësor t’i kalojë në menaxhim komunave. Politikat zhvillimore strategjike të hartohen nga Qeveria, gjegjësisht Ministria e Shëndetësisë, por menaxhimi si përgjegjësi do të duhej të kalojë në nivelin lokal, për shkak të adresës së përgjegjësisë, e cila do të ishte pranë personelit dhe qytetarëve.

Praktikat e deritanishme kanë treguar se këto dy nivele nuk koordinohen dhe nuk funksionojnë mirë ndërmjet tyre, kur llogaridhënia nuk e ka një adresë të vetme.

Te neni 41, parandalimi i konfliktit të interesit, sipas këtij neni profesionistët shëndetësorë të punësuar në sektorin publik, me orar të plotë ose të pjesshëm të punës, nuk kanë të drejtë të punojnë në institucionet private. Ky nen duhet shikuar me kujdes dhe paraprakisht do të duhej t’i parashtronim vetes disa pyetje. A do të zbrazen institucionet publike nga profesionistët me përvojë, a do të ndalen dukuritë negative në shëndetësi, a shkelet Ligji i punës, sipas të cilit lejohet puna shtesë pas orarit të rregullt të punës?

Profesionistët shëndetësorë, thënë të drejtën, shumica e tyre e kryejnë punën me nder. Deri në vitin 2010 ata kanë punuar me paga shumë të ulëta, por përherë kanë qenë të përkushtuar profesionalisht. Është e mundur që disa nga profesionistët shëndetësorë kanë keqpërdorur pozitën e tyre profesionale duke i dërguar pacientët në ordinancat private apo edhe siç përflitet për lëshime të tjera. Për shembull, defunksionalizimin e pajisjeve në institucionet shëndetësore publike.

Mendoj se kjo çështje kaq e ndjeshme mund të rregullohet me mbikëqyrje më serioze, nëpërmjet mekanizmave institucional të saj, në të gjitha nivelet menaxheriale, si dhe në vetëdijesimin e qytetarëve për paraqitjen e rasteve.

Neni 65, i cili flet për specializimet, për mua ky nen është i paqartë, sepse paragrafi 4 - planifikimi, zbatimi dhe financimi i specializimit është në përgjegjësinë e institucionit shëndetësor publik, privat ose publiko-privat.

Ndërsa, sipas paragrafit 7, specialistët, të cilët kanë përfunduar trajnimin e specialistit, në bazë të kontratës me Ministrinë e Shëndetësisë, do të punësohen sipas programit të veçantë

të Ministrisë për periudhën trevjeçare. Pra, nuk precizohet se në cilat raste do të mund të nënshkruhej kontrata me Ministrinë e Shëndetësisë.

Ndërsa neni 71, i cili flet për odat e profesionistëve shëndetësorë, këtu duke pasur parasysh se odat kanë shumë kompetenca sipas këtij projektligji, do të ishte më mirë që së pari të miratohej Ligji për odat e mandej t'u jepej kaq shumë kompetencave odave, në bazë të Ligjit të shëndetësisë.

Është për t'u përshëndetur neni 64, paragrafi 5, sepse u mundëson mjekëve të rinj, që nëse përcaktohen të punojnë në viset rurale, u jepet mundësia e punësimit menjëherë. Me këtë, përveçse mjekët e rinj punësohen, ata e bëjnë përvojën e duhur për të vazhduar me specializim, por njëherësh edhe qytetarëve u ofrojnë shërbimet shëndetësore më afër.

Unë e përkrah në parim, Projektligjin për shëndetësi dhe kontributin tim do ta jap në Komisionin Funkcional. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Falemnderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë do të ngre për diskutim vetëm një dy çështje të shkurta, pra për nga mënyra se si janë formuluar, më duket që krijojnë më shumë paqartësi dhe konfuzion, për të ardhmen se sa realisht i zgjidhin problemet reale në këtë drejtim.

Kështu, bie fjala neni 4, pika 3 e Projektligjit thotë se secili qytetar dhe banor është i obliguar të përkujdeset për shëndetin e tij. Ky formulim më duket shumë i paqartë, sepse shtrën pyetjen se me çfarë masash mund të realizohet një obligim i tillë. Pra, konsiderojmë se ky formulim do të kishte pasur kuptim, sikurse të ishte investuar edhe në drejtimet tjera, pra në përpunimin e një strategjie të mirëfilltë preventive dhe edukuese, e jo siç është gjendja në këtë mënyrë dhe në aspektin shëndetësor, sepse me këto deficite konsiderojmë se mund të vijmë në një situatë absurde, ku pacienti përkundër që është kapluar nga sëmundja, ai mund të ndëshkohet edhe si fajtor për gjendjen e tij, në të cilën ndodhet, për shkak se gjoja ai nuk qenka përkujdesur për shëndetin e tij, e që e ka pasur obligim dhe s'e ka realizuar këtë obligim ligjor.

Çështje tjetër, po ashtu, që e konsiderojmë problematike, dispozitën 2 po ashtu, të nenit 4, ku thuhet se të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor. Edhe ky formulim e konsideroj se do të kishte një kuptim, nëse do të parashihej një menaxhim tjetër i institucioneve shëndetësore e jo siç e parasheh ky projektligj, madje edhe me mundësi të privatizimit të kësaj sfere dhe me mungesa të sigurimeve shëndetësore.

Për shkak, sepse prapa kësaj deklarate të barazisë formale- juridike si dhe mungesave të sipër cekura, që i specifikova, konsiderojmë se në të vërtetë ndodhet pikërisht ideja e pabarazisë reale edhe në shëndetësi. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputetja Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Falemnderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për shëndetësinë, një ligj i shumëpritur për qytetarët dhe punëtorët shëndetësorë, më në fund arriti për lexim në Kuvend, por për dëshpërimin tonë, pa Projektligjin për sigurime shëndetësore, me të cilin pritnim të vinin bashkë.

Shëndetësia në vend është në një gjendje shumë të rëndë dhe për pozitën, në të cilën është shëndetësia jonë sot, nuk dua të flas, sepse këtë temë e kam trajtuar disa herë në Kuvend, por se duhet një bazë e mirë ligjore si pikënisje për ta reformuar atë, është e padiskutueshme.

Dhe, projektligji që kemi para vetes parasheh një varg ndryshimesh rrënjësore në sistemin shëndetësor, si themelimi i Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë, ku do të përfshihen niveli dytësor dhe tretësor shëndetësor dhe që ato do të shndërrohen në ndërmarrje apo korporatë. Themelimi i Agjencisë të Financimit Shëndetësor, themelimi i odave të profesionistëve shëndetësorë, te të cilët bartet një pjesë e madhe e përgjegjësisë aktuale të Ministrisë së Shëndetësisë, përkritazi me profesionistët shëndetësorë, përcaktimi strikt i punëtorëve shëndetësorë për sektorin publik apo privat, si masë për parandalimin e konfliktit të interesit, ndryshime këto, të cilat nëse kalojnë si të tilla në këtë Kuvend, na mbetet të shohim se a do të jenë të frytshme apo në të kundërtën, duke u nisur nga pozita buzë humnerës, ku jemi tani, është e tepërt të them se ku do të përfundojmë.

Dhe, përgjegjësinë për këtë do ta bartim të gjithë. Prandaj, ne si deputetë e posaçërisht ata që i përkasim këtij sektori, kemi obligim, që në fazën e amendamentimit t'i marrim vërejtjet dhe sugjerimet nga palët e interesit dhe të vijmë deri të përfundimet racionale.

Në vazhdim do të prezantoj disa vërejtje lidhur me Projektligjin.

Qysh te neni 1, që ka të bëjë me qëllimet e ligjit, konsideroj se përpos se ky ligj ka për qëllim përmirësimin dhe gjendjen shëndetësore të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duhet të shtohet se ligji ka për qëllim edhe rregullimin e statusit të punëtorëve shëndetësorë dhe atyre që ofrojnë shërbime shëndetësore, pasi që vetë ligji thirret Ligj i shëndetësisë e jo ligj i mbrojtjes së shëndetit, siç emërohet në shumicën e vendeve të tjera.

Te neni 3, - përkufizimet, pika 1.8, thotë: “Personi me aftësi të kufizuara është person me aftësi përkohësisht ose përherë dhe plotësisht të kufizuara, i cili ka më shumë se 18 vjet dhe më pak se 65 vjet”, po e theksoj “më shumë se 18 vjet dhe më pak se 65 vjet, që ka diagnozën mjekësore të gjendjes së tillë fizike, ndijore dhe mendore të sëmundjes ose të aftësisë së kufizuar, që e bën atë të paaftë për çfarëdo pune shpërblyese dhe kështu me radhë”. Sipas kësaj i bie se një person me aftësi përherë të kufizuara, që për shembull, është në karrocë, pasi i mbush 66 vjet gjendja e tij shëndetësore do të përmirësohet apo edhe pse është i varur nga karroca, kur është i aftësuar apo riaftësuar të kryejë ndonjë punë shpërblyese, çfarë edhe duhet të jetë objektivi i shoqërisë sonë, sipas këtij përkufizimi nuk i takon personave me aftësi të kufizuara.

Unë mund të paramendoj se me përkufizimin, çfarë është dhënë në këtë projektligj, është dashur të thuhet se personat sipas këtij përkufizimi, gëzojnë mbështetje sociale në kuadër të skemës së personave me aftësi të kufizuara, por një gjë e tillë është dashur të theksohet edhe në ligj.

Gjithashtu, te përkufizimet, kur jemi te neni 1.3 dhe 1.31, urgjenca dhe gjendja e urgjencës, mendoj se me këtë ligj, më në fund duhet të qartësohen dhe të ndahen “urgjenca” nga “emergjenca” apo fundja të përcaktohem ekskluzivisht vetëm për njërin term. Përdërisa, për “emergjencën” nuk është dhënë kurrfarë përkufizimi, vetë termi përdoret shumë më shpesh më vonë në projektligj, se sa termi “urgjencë”.

Kur jemi te neni 10, që ka të bëjë me politika zhvillimore të shëndetësisë, e kam të paqartë sepse është paraparë vetëm plani afatmesëm, ndërsa nuk parashihen politika afatshkurta dhe afatgjata të zhvillimit.

Neni 11, pika 3 parasheh se shërbimet të kujdesit shëndetësor për personat që nuk janë qytetarë ose banorë të Republikës së Kosovës, rregullohen me akt nënligjor. Ndërsa, unë propozoj që kornizat për këtë çështje të vendosen këtu, ndërsa detajet të rregullohen me udhëzim administrativ.

Te neni 12, që ka të bëjë me masat dhe veprimet për kujdesin shëndetësor, ku parashihet diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve dhe i trajtimi i tyre, pika 17 ka të bëjë me zhvillimin e burimeve institucionale dhe njerëzore në shëndetësi të domosdoshme për zvogëlimin e nevojës për trajtim jashtë vendit, pikë kjo, që mendoj se e ka vendin te neni 10, mbi politikat zhvillimore në shëndetësi dhe në fakt fare nuk inkorporohet me konceptin e pikave të tjera të nenit, ku ndodhet aktualisht.

Me këtë projektligj parashihet stimulimi i punëtorëve shëndetësor, në bazë të performansës të shërbimeve. Kriteret për përcaktim të performansës nuk janë paraparë me këtë ligj, gjë që paraqet edhe një dilemë se si dhe nga kush do të përcaktohen ato?

Në nenin 16, parashihet se referimi i të sëmurëve bëhet nga niveli parësor në atë dytësor dhe nga niveli dytësor në atë tretësor. Konsideroj se edhe niveli parësor duhet të ketë të drejtë referimi në nivelin tretësor nëse indikacionet janë të tilla, për aq më tepër për një banor të Prishtinës, ku nuk ka spital të përgjithshëm, i bie se nga një qendër e mjekësisë familjare i sëmuri duhet të referohet në ndonjë qytet tjetër, ku ka nivel dytësor për tu referuar pastaj në nivelin tretësor në QKUK në Prishtinë.

Te neni 18, që ka të bëjë me kujdesin parësor shëndetësor, te pika 8, thuhet se çdo qytetar dhe banor ka të drejtë të përzgjedhë mjekun familjar. Pikë së pari kjo pikë ka më shumë kuptim pas implementimit të sigurimeve shëndetësore, për më tepër Ministria e Shëndetësisë duhet të parasheh numrin maksimal të qytetarëve dhe banorëve, që mund t'i mbulojë një mjek familjar.

Dhe, këtë po e them duke u bazuar në praktikat e vendeve perëndimore, që kanë paraparë një limit të tillë, në mënyrë që të ketë distribuim për të gjithë mjekët, ndryshe një mjek me nam do t'i ketë nën ombrellë numrin absolut të qytetarëve të një ane.

Te neni 20, kujdesi dytësor shëndetësor në komuna, nuk e kam të qartë pse ky nivel mund t'i lihet organizimit edhe në nivelin komunal. Do të thotë, nuk e kam të qartë pse nuk ka uniformitet në këtë nivel?

Te neni 21, kujdesi tretësor shëndetësor, pika 4, që parasheh se udhëheqësit e njësive profesionale shëndetësore, pos kualifikimit specialistik duhet të kenë edhe thirrje akademike të profesorit, konsideroj se është diskriminuese, prandaj nuk duhet të jetë e formuluar si e tillë.

Te neni 22, konsideroj se me këtë ligj e jo me akt nënligjor, duhet të përcaktohet se në cilin nivel të shërbimeve shëndetësore mund të ofrohet procesi mësimor universitar.

Në nenin 24, thuhet se mjeku është i obliguar, po theksoj “i obliguar” të udhëzojë qytetarin në institucionin tjetër shëndetësor, që ta trajtojë rastin të cilin nuk ka mundësi ta trajtojë në institucionin ku ai punon. Ndërsa, unë konsideroj se duhet të shtohet, se Ministria e Shëndetësisë obligohet të pajisë çdo institucion shëndetësor me listën e shërbimeve që kryhen në institucione publike dhe private të vendit.

Neni 41, pika 2, thotë se është rreptësisht e ndaluar, që të referohen pacientët nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, tek institucionet private të kujdesit shëndetësor, për shkaqe të cilat nuk mund të arsyetohen me argumente mjekësore, pavarësisht nga lista e pritjes.

Sipas kësaj, del se nga një ndalesë e tillë janë të kursyer mjekët e nivelit parësor.

Neni 47, lidhur me inspektoratet, të cilët do të kenë një rol shumë të rëndësishëm në mbikëqyrjen e këtij ligji, është nën shumë i shkurtër dhe konsideroj se përgjegjësitë kryesore të këtij sektori duhet të parashihen edhe me këtë ligj.

Neni 64, pika 2, për licencimin e profesionistëve shëndetësorë parashihet të bëhet nga Oda përkatëse, por mendoj se duhet një lloj mbikëqyrjeje nga Ministria e Shëndetësisë, sidomos në fazat fillestare, duke pasur parasysh se aktualisht pothuajse të gjitha shoqatat e profesionistëve, prej të cilave do të derivojnë odat e profesionistëve, aktualisht janë të fraksionuara.

Neni 64, pika 3, mbi licencimin e profesionistëve të huaj, parashihet me akt nënligjor, ndërkaq nga praktikat e deritanishme, ku aktet nënligjore dinë të jenë shumë liberale, konsideroj se edhe kornizat e kësaj çështjeje duhet të vendosen në këtë ligj.

Me këtë ligj parashihen, për herë të parë te ne edhe subspecializimet, megjithatë duhet të precizohet me anë të akteve nënligjore, se cilat lëmenj konsiderohen subspecialistik. Ndërkaq, në këtë nen duhet të parashihen veprime, që të mos lihen anash profesionistët, të

cilët mund të anashkalohen si rezultat i tranzicioneve dhe reformave në sistemin edukativ shëndetësor.

Te neni 73, detyrimet gjatë grevës në pikën 1.3, duhet të bëhet qartësimi lidhur me dhënien e terapisë.

Neni 77, lidhur me hulumtimet klinike në njerëz, parashihet të monitorohet nga organi profesional i autorizuar nga Ministria e Shëndetësisë. Konsideroj, se këtu nevojitet një decentralizim pasi që çdo institucion shëndetësor duhet të ketë komitetin e tij etik, që jep leje për këto hulumtime.

Ne, si Lëvizje për Bashkim do të votojmë në parim këtë projektligj, por do të jemi aktiv gjatë amendamentimit të tij. Ju falemnderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Falemnderit! Deputeti Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Falemnderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra të nderuar,

Falënderoj ministrin e Shëndetësisë për përgatitjen e projektligjit dhe për vizionin e tij të qartë për reformat në sistemin shëndetësor dhe dakordimin me institucionet ndërkombëtare, në lidhje me këtë projektligj.

Me aq sa e kam lexuar projektligjin dhe arsyetimin e paraqitur këtu, kam vërejtur se projektligji synon: ngritjen e cilësisë së menaxhimit, depolitizimin, decentralizimin e sistemit të financimit të sektorit të shëndetësisë, rregullon dhe barazon sektorin publik dhe privat, rregullon odat e profesionistëve shëndetësorë dhe të tjera.

Me këtë projektligj mundësohet gjenerimi i të hyrave plotësuese në institucionet shëndetësore dhe punësimin e shtuar në to, me themelimin e Shërbimit Shëndetësor të Kosovës.

Neni 55, i projektligjit hap rrugën për themelimin e fondit të sigurimeve shëndetësore. Gjithashtu, sigurohet mundësia për punësimin e 300 mjekëve të posadiploimuar për çdo vjet si dhe 100 specialistëve të rinj për çdo vjet, si dhe të mira të tjera të parapara me këtë ligj.

Unë ftoj kolegët deputetë, që ta përkrahin në parim këtë projektligj dhe për vërejtjet eventuale t'i diskutojnë në komision. Ju falemnderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Mendoj se ky projektligj ka nevojë për disa shpjegime shtesë, ose disa analiza shtesë nga Kuvendi i Kosovës, përpos atyre se çka ka synuar që të rregullojë. Kuvendi, deputetët dhe Qeveria duhet të shohin se si përkthehet në praktikë një ligj, po i them ligj në momentin që

votohet dhe hyn në fuqi. Do të thotë, çka ndodhë ditën e parë, kur provizionet e një ligji janë të plotfuqishme, duhet të zbatohen?

Në këtë projektligj, shembull ta marrim, e keni parë se në një paragraf thuhet: “është rreptësisht e ndaluar...” dhe vazhdon. Fjala “rreptësisht e ndaluar” është piktoreske.

Në vendet, ku sundon ligji me të vërtetë, fjala e ndaluar mjafton që të jetë q e ndaluar. Aty ku përpos sundimit të ligjit, ka edhe norma tjera që sundojnë, duhet të thuhet është rreptësisht e ndaluar. Do të thotë, aty ku ka edhe diçka përtej ligjit, që mund të bëjë diçka shtesë, duhet thënë është rreptësisht e ndaluar, për shkak se domethënë, ka dallim në mes fjalës “ndaluar” dhe togfjalëshit “rreptësisht e ndaluar”.

Dhe, unë kisha kërkuar, që në definicione të ligjeve, tani e tutje Qeveria të na shpjegoj cili është dallimi në ligj në mes “ndaluar” dhe “rreptësisht e ndaluar”, për shkak se po tregon një mendësi interesante të Qeverisë së Kosovës, të tregojë se përpos ligjit, i cili saktë mundet të ndalojë diçka, mund të ketë edhe diçka që është rreptësisht e ndaluar dhe te kjo “rreptësisht e ndaluar”, ndoshta duhet të ndërhyjë Qeveria, për shkak se duhet të ketë diçka përpos normës ligjore, e cila shpjegon se çka është “rreptësisht e ndaluar”.

Unë mendoj se qëllimi i këtij ligji ka qenë i mirë. Fillimisht, me ligj provohet që të rritet kualiteti i shërbimeve shëndetësore, që qytetarët e Kosovës të ndihen më të sigurt kur kanë nevojë për shërbime shëndetësore dhe ky duhet të jetë qëllimi final i projektligjit, kurrgjë tjetër. Dhe, nëse ky është qëllimi final i projektligjit, atëherë nuk mund të nisët ndërtimi i ligjit prej një situatë hipotetike, duhet të nxjerrët situata e vërtetë, reale, cila është situata në Kosovë, pa e gënjyer vetveten, pa e mashtruar vetveten, pa paramenduar se diçka është ndryshe prej asaj që është në të vërtetë dhe, kur shihet totali i pastër, atëherë ndërtohet një projektligj, i cili tenton ta sjellë situatën prej gjendjes aktuale, në një gjendje më të mirë.

Tani, te neni 41, paragrafi 1, është tepër e saktë të shkruhet që punëtorët shëndetësorë, prej atyre që janë shumë të kualifikuar ose me kualifikim specialistik, shembull ta marrim, deri te ata që janë me kualifikime më të ulëta dhe kryejnë shërbime dytësore, ndoshta, nëse mund t’i quaj kështu, nuk guxojnë të punojnë në institucione shëndetësore dhe në institucione private. Prapë, ky provizion në dukje është në rregull. Domethënë, është provizion i mirë, pse të punojnë në dy vende të punës? Por po ju lutem, paramendoni se çka ndodhë në momentin kur ky ligj hyn në fuqi nëse nuk ka provizion rreptësisht të ndaluar, nëse ka të ndaluar dhe më pak të ndaluar, domethënë. Në atë moment me siguri se do të kemi çoroditje serioze të sistemit shëndetësor në Kosovë dhe po ju tregoj pse. Unë kisha dashur t’i pyes deputetët e Kosovës dhe të gjithë qytetarët e Kosovës – a mendoni se paga prej 500 eurove me të vërtetë është e barasvlershme me vlerën e punës së një mjeku specialist? Nëse i shohim edhe pagat tjera dhe nëse shohim se sa të ardhura krijon një autolarje në Kosovë, një person pra që e ka një autolarje, sa të ardhura në muaj krijon dhe sa të ardhura krijon një mjek specialist? A është kjo vlera e punës e vërtetë e një mjeku specialist? Nuk do mend, se nuk është. Domethënë, vlera prej 500 eurove nuk është e barasvlershme me vlerën e punës së një mjeku specialist as në Kosovë, e lëre më diku tjetër.

Tani, çka po ndodhë në Kosovë? Në Kosovë po ndodhë që shoqëria, çuditshëm po ua jep vlerën e vërtetë mjekëve specialistë, se ata po punojnë edhe privat dhe shumë njerëz po i çojnë fëmijët nëpër klinika private dhe po iu del muaji diku nga 2.000 euro, mesatarisht, ndoshta dikujt më shumë e dikujt më pak.

Domethënë, shoqëria si e tillë po e kërkon një shërbim për të cilin shteti, tash në këtë rast, po them pa faj, nuk ka mbërri t'ia japë vlerën e vërtetë punës së mjekëve, për shkak të evazionit e tjera, e tjera, nuk po dua të ndalem në këtë temë tani. Dhe, nëse ky provizion ligjor do të zbatohet pa rreptësisht, e me rreptësisht, si të doni, atëherë me siguri se mjekët specialistë kanë për të kërkuar ta realizojnë vlerën e vet të punës, qysh e realizojnë sot. Ky realizim i vlerës së punës do t'i detyrojë ose të shkojnë nëpër klinika private dhe t'i lëshojnë ato klinika shëndetësore publike, ose, që është edhe më keq, të punojnë në të zezën. Domethënë, të punojë zyrtarisht në klinikë publike, ndërsa të krijojnë të hyra nëpër klinika private, pa u regjistruar.

Të dy këto raste janë shumë të këqija për Kosovën. Dhe, fundi i fundit, niveli ose kualiteti i shërbimeve shëndetësore bie. Pse bie? Sepse nuk kanë të gjithë mundësi të shkojnë nëpër klinika private dhe ata që shkojnë në klinika publike, në spitale e ambulanca, çka do qofshin, ata kanë do të gjejnë shërbime më të ulëta shëndetësore, për shkak se nuk do të punojë një mjek specialist për 500 euro vetëm, për shkak se kjo nuk është e barasvlershme me vlerën e tij të punës. Sepse ky është realiteti në Kosovë. Në këtë realitet edhe po jetojmë ne.

Kjo është politika e ligjit. Kjo është politika e këtij projektligji, projektligj i cili nuk do të sjellë dobi në rritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore që duhet me qenë siç thash në fillim qëllimi primar i këtij projektligji.,

Tani, çka duhet të bëjmë ne? Aleanca, nuk e voton këtë ligj se është kundër politikave tona për shëndetësinë, të cilat i kemi shumë të sakta.

Mirëpo, çka bën Kuvendi? Kuvendi e voton këtë projektligj. Por, në momentin që ka për t'u votuar dhe ka për të hyrë në fuqi, pa Ligjin për sigurime shëndetësore, ne do të kemi probleme tepër të mëdha në sistemin shëndetësor, të cilat edhe tani i kemi. Unë prej kësaj foltore të Kuvendit e kam përmendur se në klinikat tona rrjedhin ujërat fekale. Domethënë, më keq nuk ka ku të shkojë, kishim për të menduar atëherë. Por, po e shihni se mund të ketë edhe më keq, se shumica dërmuese e mjekëve specialist mund t'i lëshojnë klinikat publike, të shkojnë në klinika private dhe ekzakt ata që nuk kanë mundësi të paguajnë nëpër klinika private do të pësojnë.

Unë ju kisha thirrur që këtë ligj ta ruani në fiokë edhe për një kohë dhe Qeveria të na e sjell ligjin për sigurime shëndetësore, që ai ligj për sigurime shëndetësore do t'u mundësojë edhe atyre që nuk kanë mundësi të shkojnë në klinika private, ta kenë një pjesë, të paktën një pjesë të paguar në cilëndo klinikë në mënyrë që njerëzit e thjeshtë të kenë shërbime më kualitative shëndetësore.

Unë këtë pjesë të vogël të këtij ligji e mora për bazë, mirëpo mendoj se kjo e shpjegon politikën e këtij ligji, sepse secili ligj e ka politikën e vet prapa. Kjo është politika e këtij ligji. Provon të bëjë diçka, duke u nisur prej një situatë krejt hipotetike, thuaja se ne kemi me mijëra mjekë specialistë që rrinë dhe janë shumë të aftë, thuaja ti se rrogat janë në sistemin shëndetësor publik përafërsisht të njëjta me sa do të përfitonte një mjek specialist në një klinikë private.

Këto janë krejt hipotetike. Domethënë, projektligji nuk është shkruar duke u nisur prej gjendjes reale në Kosovë dhe nuk guxon të shkojë më tutje, për shkak se gjendja në shëndetësinë e Kosovës vetëm sa ka për t'u përkeqësuar.

Është e vërtetë se është një segment, por është një segment që e shpjegon, edhe një herë thashë politikën, politikën e sundimit të ligjit, politikën e sundimit rreptësisht ose pa rreptësisht, që në fund të fundit mund t'ju them, pa dashur t'i komplikoj çështjet tash, është mendësi qeverisëse në pesë vjetët e fundit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për shëndetësinë duhet t'i trajtojë problemet kryesore të sistemit shëndetësor të Kosovës. Është fakt i pamohueshëm se gjendja në sistemin shëndetësor është jo e mirë, po të krahasohet edhe me pjesë tjera të Evropës, po edhe me vende të rajonit.

Organizimi i deritashëm i sistemit shëndetësor në Kosovë ka treguar dobësitë e deritanishme. Nuk ka dhënë rezultate dhe është sipas një modeli jo të mirë dhe i përshtatshëm për rrethanën në të cilën po jetohet në Kosovë. Është një infrastrukturë e lënë pas dore, e rinovuar dhe mirëmbajtur dobët, me pajisje të vjetruara apo me mungesë të tyre. Këtë projektligj e kam shikuar me kujdes dhe mund të them se kohëve të fundit, prej se Qeveria e ka miratuar dhe dërguar në Kuvend, jam marrë seriozisht me të.

Ministria e Shëndetësisë e ka bërë një punë të mirë që e ka punuar këtë draftligj, i cili sigurisht se ka nevojë edhe për plotësime tjera, për definime dhe adresim të përgjegjëse.

Ministria është përgjegjëse për politikën shëndetësore, planifikimin strategjik, miratimin e akteve nënligjore, të rregulloreve, planifikimit të potencialit njerëzor, licencimin, sigurimin e kualitetit dhe financimin.

Mendoj se Ministria e Shëndetësisë duhet t'i përmbahet dhe synojë me anë të këtij ligji edhe 5 prioritete të cilat janë një pjesë e prioriteteve edhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe ajo ka të bëjë me fillimin e shëndetshëm të jetës, përmirësimin e shëndetit të rinjve, përmirësimin e shëndetit mental, zhvillimin e potencialit njerëzor të sektorit shëndetësor si dhe reduktimin e sëmundjeve ngjitëse.

Gjithsesi edhe sa i përket organizimit, Ministria e ka bërë një punë të mirë sa i përket organizimit dhe i është përmbajtur sistemit apo elementit kryesor në organizimin e sistemit të kujdesit primar, dytësor dhe terciar dhe sigurisht se duhet pasur kujdes këtu që kujdesi parësor shëndetësor të jetë bazë të sistemit shëndetësor. Banorët duhet të zgjedhin mjekun familjar personal, ndërsa kujdesi esencial stomatologjik do të duhej të ishte pjesë e kujdesit parësor shëndetësor. Specialistët e spitaleve apo ata të lidhur me to, duhet të ofrojnë kujdes specialistik vetëm me posedim të udhëzimeve nga mjeku i kujdesit parësor shëndetësor.

Organizata Botërore e Shëndetësisë sugjeron që mbrojtja shëndetësore duhet të decentralizohet, orientohet kah preventiva, të jetë pjesë e të arriturave të gjithëmbarshme. Andaj shi për këtë, mendoj se Ministria e Shëndetësisë duhet të ketë kujdes që t'i përmbahet këtyre udhëzimeve dhe me krijimin e bordit apo të Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë mendoj se nuk është duke shkuar nga decentralizimi, mirëpo një pjesë të kompetencave sa i përket sistemit shëndetësor i ka fokusuar në një bord i cili i merr kohë pas kohe edhe kompetencat e vet Ministrisë. Kemi një dualizëm në mes politikë bërjes nga ana e Ministrisë dhe bordit, i cili parasheh, prandaj duhet të mendojmë mirë për funksionimin e këtij bordi të precizohen qartë përgjegjësitë dhe obligimet e këtij bordi, të formuar nga ana e Ministrisë.

Pastaj, do të fokusohem edhe në disa çështje që kanë të bëjnë me ligj, te përkufizimet në nenin 3, nuk shihet se është e shënuar lista e çmimeve të shërbimeve shëndetësore. Mendoj se më vonë në ligj, po edhe në akte tjera nënligjore do t'i referohemi këtij termi, prandaj është mirë që te neni 3 të futet te përkufizimi edhe lista e çmimeve të shërbimeve shëndetësore.

Në nenin 11, te pika 3 - shërbimi i kujdesit shëndetësor për persona që nuk janë qytetarë ose banorë të Republikës së Kosovës, rregullohet me akt nënligjor. Kështu shkruan në pikën 11, pika 3.

Mendoj se duhet të thuhet saktë se shërbimet e kujdesit shëndetësor për personat që nuk janë qytetarë ose banorë të Republikës së Kosovës, janë me pagesë dhe rregullohet me akt nënligjor nga ana e Ministrisë. Të gjithë e dimë dhe jemi dëshmitarë se sa para paguajnë qytetarët tanë për shërim jashtë vendit, andaj nuk besoj që ne si shoqëri dhe si shtet kemi luksin që qytetarëve të vendeve tjera t'u ofrojmë shërbime shëndetësore pa pagesë.

Pastaj te neni 17 pika 6, do të thotë, duhet të definohen institucionet që i takojnë shërbimit terciar.

Dhe, te neni 20 pika 11, domethënë është në kundërshtim me pikën 2, të po këtij neni, prandaj e kemi një përzierje të kompetencave në mes kujdesit parësor me atë dytësor dhe terciar. Nuk janë terciar, nuk janë të definuara qartë këto çështje.

Te neni 21, pika 3, thuhet: Institucionet nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të kenë drejtorë për arsim dhe shkencë, që propozohen nga fakulteti përkatës i shkencave mjekësore.

Mendoj se duhet të precizohet saktë se kush propozon anëtarin në këto institucione, dekani, prodekani, këshilli i Fakultetit. Duhet saktë të precizohet se do të ketë pastaj probleme rreth kësaj çështjeje, apo me automatizëm ky drejtor duhet të jetë dekani apo prodekani për arsim dhe shkencë.

Te pika 4, do të thotë, i referohet thirrjeve akademike profesorë, jo siç duhet të jetë profesor, se mund të ketë që në atë lami mos të ketë profesorë, prandaj është e preferuar të jetë profesor dhe ajo që shumica e atyre punëtorëve shëndetësorë janë te neni 41, pika 1 do të ishte e papranueshme sikur të arrihet që me këtë të bëjmë një listë unike të pagave të profesorëve në formën çfarë është në këtë formë edhe e asistentëve që punojnë në Fakultetin e Mjekësisë dhe personelit tjetër shëndetësor që punojnë në sektorin terciar dhe nëse kjo me anë të këtij ligji definohet qartë se personat të cilët punojnë në sektorin privat apo ata publik, nuk mund, do të thotë, të punojnë herë në këtë sektor e herë në atë, prandaj do të duhej paraprakisht që Ministria e Shëndetësisë të bëjë një kategorizim të pagave të këtij personeli shëndetësor bazuar në thirrjet akademike dhe bazuar në përvojën e punës dhe të caktohet paga bazë për ta dhe pastaj nga kjo të fillohet me procedurën çfarë e ka menduar ministria, do të thotë, të ngritjes apo pagesës për ta.

Gjithsesi, nëse me anë të këtij ligji kjo mbetet në këtë formë si është, atëherë profesionistët më të mirë shëndetësorë, të cilët i kemi në Fakultetin e Mjekësisë e që janë profesorë të këtij fakulteti dhe asistentë të këtij fakulteti dhe shpeshherë ndodhë që një profesor apo një kirurg më i mirë i cili është profesor në Fakultetin e Mjekësisë dhe e marr një rrogë sekondare në Qendrën Klinike Universitare, ky profesor do t'i bie që në punë të përcaktohet në mes të publikut dhe privat dhe për punë 300 euro në sektorin publik, atëherë nuk e ka të leverdishme për 300 euro të rri për arsye se një profesor i mirë apo një profesionist i mirë edhe i kirurgjisë apo i gjinekologjisë, apo të një profesioni tjetër shëndetësor, të profilit tjetër shëndetësor, me një punë apo me një operacion të thjeshtë brenda muajit do të arrinte këtë pagesë.

Prandaj do të ishte vështirë të ndalen te profesionistët më të mirë shëndetësorë në këtë formë.

Mendoj që do të duhej të ishte një listë unike e sektorit terciar dhe mos të kemi në këtë sistemin e pagesave të dyfishta, në mes asaj primare dhe sekondare, të sistemit për arsye se Qendra Klinike Universitare është universitare dhe nëse mbetet në këtë formë atëherë ne do të rrezikojmë që këtë termin universitare t'ia largojmë Qendrës Klinike Universitare dhe të kemi vetëm Qendrën Klinike të Kosovës, ndërsa Universiteti të punojë i pavarur nga kjo.

Do të ishte mirë që Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë të angazhohet në ngritjen e kuadrit akademik, ndërsa pagesat të bëheshin unike, vetëm në Qendrën Klinike Universitare apo në sektorin tjetër terciar, varësisht nga ajo.

Dhe një çështje tjetër, që ka të bëjë me nenin 28, vetëm përmendet Inspektorati Sanitar, ndërsa fare nuk merret me anë të këtij ligji me fushëveprimin e këtij inspektorati, i cili nuk është pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, mirëpo i takon një sferë tjetër apo rregullohet me Ligjin e inspektoratit sanitar. Unë mendoj dhe është mendim imi, që Inspektorati Sanitar

duhet të jetë pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe duhet të funksionojë në kuadër të kësaj Ministrie.

Mendoj se me propozimet tjera, gjatë amendmentimeve tjera, do ta arsyetoj dhe do sjell propozime konkrete.

Dhe, të kthehemi te neni 60, domethënë, formimi i Shërbimit Kombëtar të Shëndetësisë. Thashë edhe më herët se është në kundërshtim edhe me thjesht me politikat e Organizatës Shëndetësore të Shëndetësisë, mirëpo mendoj se do ta rregullojmë këtë çështje gjatë amendamentimit dhe do të ishte mirë që të definoheshin edhe profesionistët të cilët do të duhej të jenë në këtë sferë, kush janë përbërësit e këtij bordi dhe formën e zgjedhjes dhe numrin e anëtarëve të këtij bordi, dhe forma sigurisht e zgjedhjeve duhet të precizohet me këtë ligj e mos të lëmë pastaj mundësi të keqinterpretimit.

Dhe, në nenin 70. 1 – Oda e Profesionistëve Shëndetësorë, nuk precizohet por përmenden disa herë në ligj. Nga se duhet të mendohet që të rregullohet qartë përbërja e Odës dhe kompetencat, detyrat, fushëveprimi, funksionimi, përgjegjësitë dhe të rregullohen me këtë ligj.

Unë e di që Ministria ka punuar në një akt nënligjor dhe është në përfundim e sipër, mirëpo mendoj se baza e atij ligji duhet të jetë i përfshirë edhe tek neni 71, të plotësohet.

Mendoj se Ministria e ka bërë një punë të mirë sa i përket këtij ligji. Shëndërimi i sektorit terciar të Qendrës Klinike Universitare në tipin e ndërmarrjes publike dhe financimi me bashkë pagesa dhe vetëfinancimi e stimulimi, do të ishte mirë mendoj që edhe juristët po edhe në komision....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues! Në përfundim jam. Mendoj se këtu do të ishte mirë të konsultohen- a është kjo në përputhje me Ligjin mbi financat publike, për arsye mendohet që me anë të këtyre bashkëpagesave të bëhet një stimulim për punëtorët shëndetësorë në bazë të performansës, e pastaj mendoj që kjo nuk është në përputhje me Ligjin mbi financat publike, prandaj do të ishte mirë të konsultohet edhe kjo, dhe sigurisht që ligjit i jap përkrahje, mirëpo mendoj se do të ketë mjaft punë në Komisionin gjegjës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rita Hajzeraj-Beqaj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,
Deputetë,

Projektligji për shëndetësinë, e dimë shumë mirë që ka kohë të gjatë që është kërkuar edhe nga stafi shëndetësor edhe nga qeveritë e kaluara dhe Qeveria e tanishme, mirëpo edhe pse

është lënë një kohë jashtëzakonisht e gjatë pa ardhur ky projektligj në plotësim-ndryshim, prapëseprapë ky ligj lë për të dëshiruar.

Unë po filloj menjëherë me vërejtje konkrete, duke filluar nga neni 3, që edhe kolegët e mi më herët e përmendën – qytetari dhe banori, pra pika 1.4 dhe pika 1.5. Çka ka menduar Ministria kur e ka bërë specifikimin se çka është qytetari dhe çka është banori?

Unë konsideroj se ju e keni bërë një lëshim, duke e pasur parasysh këtë, me siguri keni pasur parasysh që ky të jetë banor rezident dhe jo rezident dhe jo dallimi në mes qytetarit dhe banorit se banorë mund të jenë edhe kafshët, jo vetëm njerëzit.

Po filloj me nenin 17, pika 3.2. ku janë poliklinikat specialistike, llojet e institucioneve shëndetësore. Këtu askund nuk janë përmendur klinikat private, në të cilat punon sot stafi shëndetësor dhe nuk e di a ka harruar Ministria t'i përmendë këto klinika apo i ka lënë me qëllim?

Kalojmë pastaj te neni tjetër, i cili mendoj se është më problematik dhe besoj se ka zgjuar zhurmë të madhe sa i përket këtij ligji- themelimi, licencimi dhe akreditimi i institucioneve shëndetësore, neni 40 - themelimi dhe drejtimi, e po ashtu neni 41 – parandalimi i konfliktit të interesit.

Konsideroj se kjo ka qenë kërkesa kryesore që të bëhet një ndarje në mes sektorit publik dhe sektorit privat, punonjësve të cilët punojnë në sektorin publik dhe sektorin privat. Nuk e di çfarë modeli është marrë këtu se: të gjithë ata punonjës shëndetësorë të cilët në sektorin publik, apo ata që punojnë në sektorin privat, do të thotë mund të punojnë vetëm në ato dy fusha, jo në një pjesë të ditës në sektorin publik dhe një pjesë të ditës në sektorin privat, kur e dimë që kemi edhe deficit të kuadrove për profesione apo specializime të caktuara këtu menjëherë vijmë në përfundim që ky projektligj nuk i plotëson nevojat.

Konkurrenca në treg, e dimë çfarë është dhe sa është shuma të cilën e marrin punonjësit të cilët punojnë në institucionet publike dhe ata që punojnë në institucionet private.

Zoti ministër, Ligji i punës, e lejon që punonjësit shëndetësorë të punojnë edhe jashtë orarit të punës, nëse ata e kanë vullnetin e tyre. Ndërsa, ju me këtë ligj po bini edhe në kolizion me Ligjin e punës, e po ashtu po ia ndaloni punën shtesë apo vullnetare që mund ta bëjnë pas orarit të punës nëse e përfundojnë në një institucion tjetër dhe ky mendoj se është një diskriminim.

Kalojmë te financimi i kujdesit shëndetësor. Sa herë që përmendet se duhet ky projektligj të financohet, ne ndeshemi me mungesën e Ligjit për sigurime shëndetësore. Shihni nenin 55, sistemi i financimit të kujdesit shëndetësor, që thotë – Financimi i kujdesit shëndetësor në Republikën e Kosovës bëhet sipas modelit të kombinuar të financimit dhe asnjëherë nuk e kemi pa atë nivel të kombinuar të financimit, përveç të buxhetit të Republikës së Kosovës i cili është ndarë në fillim të vitit. Po ashtu, e përmend edhe sistemin e sigurimeve shëndetësore publike dhe private, që ne nuk e kemi atë mundësi. Domethënë, ky menjëherë

të lë për të dëshiruar dhe lë për të kuptuar që ky projektligj nuk mund të zbatohet që nga viti 2013.

Kalojmë te neni 87. – sanksionet për shkelje administrative dhe kundërvajtje. Unë konsideroj nëse e shihni pikën 1.3, thotë – ushtron veprimtari pa licencë valide të punës duke e shkelur nenin 4.2.1, domethënë dikush nëse ushtron veprimtari joligjore, ne e dimë se ai është krim në shëndetësi, atëherë është shuma jashtëzakonisht e vogël nëse dënohet 2.000 deri në 8.000 euro, unë konsideroj që këto sanksione janë jashtëzakonisht të vogla.

Sa i përket ligjit në përgjithësi, konsideroj se duhet të kalojë në lexim të parë, duhet t'i marrë parasysh vërejtjet tona Komisioni i cili do ta punojë këtë projektligj.

(Drejtimin e mbledhjes, e merr zoti Petar Miletiq, nënkryetar i Kuvendit)

KRYESUESI: Hvala! Reč ima poslanik Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: Falemnderit, zoti kryesues!

Ka kaluar mjaft kohë dhe unë do të përpiqem, në mënyrë sa më koncize t'i them mendimet e mia.

Unë mendoj se ardhja e këtij ligji në Kuvend paraqet një zhvillim të rëndësishëm pozitiv për disa arsye. Së pari, nëpërmjet këtij ligji, ne kemi një përkufizim të një sistemi integral shëndetësor në Kosovë, gjë që është mjaft e rëndësishme.

E dyta, ligji synon që t'i vë disa baza për ngritjen e cilësisë dhe standardeve të shërbimeve shëndetësore që iu ofrohen qytetarëve të Kosovës.

E treta, e cek si një nga objektivat të depolitizimit të shëndetësisë, që është shumë e rëndësishme.

Dhe, e katërta- synon që t'i zgjidhë problemet e konfliktit të interesit.

Këto janë pra disa objektiva shumë të rëndësishme dhe mendoj se në ligj janë arritur të prezantohen, ndonëse sigurisht në leximin e dytë edhe më tutje disa gjëra mund të përkufizohen edhe më mirë.

Të shkojmë me radhë, shkurtimisht, sa i përket përkufizimit të sistemit shëndetësor, mendoj se kemi një situatë relativisht të qartë, kemi edhe sistemin integral informatikë shëndetësor që e mbështet këtë sistem. Ajo që duhet të shihet është se në ligj ndoshta duhet më mirë të përkufizohen kompetencat e organeve të ndryshme, sidomos Shërbimit Shëndetësor Kombëtar, që unë e shoh si mundësi që në këtë shërbim të bashkërenditen më mirë punët e ndërmarrjeve publike shëndetësore në nivelin terciar dhe sekondar, pra të përdoren më mirë burimet njerëzore, pajisjet dhe financat. Për shembull, bëhet një prokurim për të gjitha këto bashkë dhe mund të mbërrihet më mirë. Mjekët që i kemi më të mirët, të gjithë për t'i përdorur dhe planifikuar.

Mirëpo, sado që në nenin 60 është thënë se themelohet kjo ndërmarrje publike jo profitabile, si një lloj holdingu, dhe unë po e kuptoj si një lloj ndërmarrjeje holding, të ndërmarrjeve tjera publike që janë në këtë sferë të shëndetësisë, mirëpo ky nen nuk e ka përkufizuar sa duhet se çka do të bëjë dhe cilat do të jenë kompetencat dhe si do të funksionojë? Këto mund t'i përcaktojë bordi më vonë, pajtohem, por ligji duhet t'i japë disa kufiza në mënyrë që mos të ketë dyfishime dhe mos të ketë konflikte midis kompetencave të institucioneve të ndryshme të shërbimit informatikë shëndetësor.

Sa i përket depolitizimit, unë mendoj decentralizimi mund të çojë te depolitizimi më i madh, dhënia e kompetencave dhe autorizimeve ndërmarrjeve publike në nivel të ndërmarrjeve të Qendrës Klinike dhe ndërmarrjeve publike tjera, por duhet të shkohet kah ajo që mënyra e zgjedhjes së bordeve, mënyra e zgjedhjes së organeve përdrejtuese, ajo mund të sigurojë depolitizimin e vërtetë. Prandaj, krahas këtij decentralizimi që është bërë, duhet t'i shohim mënyrën e emërimit, mënyrën e zgjedhjes, kriteret dhe të gjitha tjerat a janë siguruar që të arrihet ky qëllim të cilin unë e mbështes, sepse një nga problemet kryesore është interferimi i interesave politike dhe i interesave të ngushta grupore në shëndetësi sot dhe në periudhën e pasluftës.

Prandaj, këto qëllime janë për t'u përshëndetur dhe vetëm duhet të shihen se a janë siguruar të gjithë mekanizmat aty.

Te cilësia e shërbimeve, ajo që më ka pëlqyer mua shumë te ky ligj, është neni 13, ku theksohet- duhet të ekzistojnë standardet, duhet të ekzistojnë protokollet për mënyrën e trajtimit të sëmurëve, dhënien e diagnozave, dhënien e terapisë e tjera. Kjo është diçka që ka munguar dhe shpeshherë në institucionet tona shëndetësore bëhen gabime se nuk ndjekin standardet, nuk ndiqet një ecure apo hapat në diagnostifikim ose dhënie të terapisë. Kjo është esenciale.

Prandaj unë e mbështes, kjo duhet të lidhet me etikën dhe duhet të lidhet edhe me sanksionet në fund atje. Në qoftë se dikush këta udhëzues që i përbëjnë standardet, e përbëjnë ecurinë duhet të shihet kush i aprovon ato, e aprovon Ministria, po supozoj apo dikush, ndonjë trup apo Oda Profesionale, sepse edhe Oda Profesionale e Shëndetësisë do të ndikojë në rritjen e profesionalitetit, atëherë në qoftë se në ndonjë institucion, ata që e kanë bërë diagnostifikimin, ata që kanë dhënë terapinë, ose ata që kanë bërë intervenime, nuk i janë përmbajtur asaj ecurie, atij algoritmi të them, atyre hapave – ata duhet t'i kenë sanksionet e caktuara në ligj. Dhe kjo do të na mbrojë prej abuzimeve, prej qëndrimeve, prej asgjësë të cilat shpeshherë rezultojnë me probleme në kujdesin shëndetësor.

Te konflikti i interesit, u diskutua. Unë mendoj se krejtësisht është në rregull kjo që është propozuar dhe duhet të jetë një përcaktim që ata që punojnë në sektorin publik nuk mund të punojnë e të jenë edhe pronarë, të jenë menaxhues e të jenë të institucioneve private. Dhe, kjo mundësi që njerëzit punojnë në tre-katër vende, në sektorin publik e sektorin privat, mund t'ju them që ka krijuar probleme edhe në sistemin e arsimit, deri diku, por mos të përgatitet e njëjta gjë të na ndodhë dhe mos të lejojmë të na ndodhë edhe në shëndetësi. Prandaj kjo duhet të mbështetet, por menjëherë porsa të mendosh që kjo të zbatohet, ne duhet të jemi të vetëdijshëm si Kuvend edhe Ministria duhet të jetë e vetëdijshme të intervenojë t'i rrisë pagat e mjekëve specialistë. Pra, menjëherë, atë ditë që hyp në fuqi ky

nen, ne duhet të jemi të gatshëm ta paguajmë specialistin me një çmim adekuat, dhe ky Kuvend duhet ta marrë atë përgjegjësi me aprovimin e këtij buxheti, sepse përndryshe nuk do të kemi nivelin e shërbimeve çfarë na duhen në Qendrën Klinike. 300 – 500 euro, kirurgu e të kërkojmë të bëjë operacione, mendoj se janë gjëra jo logjike që ne si shoqëri duhet t'i zgjidhim, në qoftë se kërkojmë ta ndërpresim derdhjen e buxhetit jashtë vendit për shërimet dhe ta rrisim cilësinë e shërbimeve mjekësore. Ju faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr zoti Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit)

KRYESUESI: Falemnderit! Fjalën e ka zoti Bahri Thaçi.

BAHRI THAÇI: Falemnderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji i shëndetësisë është një nga ligjet themelore dhe njëherit më të rëndësishmit në gjithë spektrin e legjislacionit të një vendi, sepse ky ligj i dedikohet një fushe shumë të gjerë, në të cilën në një mënyrë ose tjetrën, gravitojnë të gjithë qytetarët e vendit.

Procedimi i këtij projektligji në Kuvend, është i vonuar, krahasuar me zotimet e Qeverisë për një gjë të tillë.

Ky projektligj ka qenë i paraparë me programin legjislativ të vitit 2011 gjatë të cilit vit nuk ka ardhur në Kuvend. Është ... i pa arsyeshme për rrethanat tona vonesa dhe procedimi i këtij projektligji.

Ligji i shëndetësisë, i miratuar në vitin 2004, me shumë dimensione në shumë dimensione është i tejkaluar dhe nuk përmbushë kënaqshëm kërkesat e këtij sektori për zhvillimin e mëtejshëm dhe ndryshimin e natyrshëm të tij. Shpesh na është thënë se Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore, dhe instancat e tjera relevante ndërkombëtare janë pengesë për procedimin e këtij projektligji dhe atij për sigurime shëndetësore. Duhet të kuptojmë një gjë, se Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Banka Botërore duhet t'i perceptojmë si partnerë të zhvillimit të shëndetësisë dhe fushave tjera në Republikën e Kosovës.

Dialogimi konstruktiv me ta dhe shtruarja e problemit me qëllim arritjeje të një zgjidhje, asnjëherë nuk ka qenë e pamundur, siç dëshmon edhe në këtë rast Ligji për shëndetësinë. Sikur shihet, në këtë projektligj, ndryshohet mënyra e funksionimit dhe e financimit të gjithë sistemit tonë shëndetësor. Përmes këtij ligji themelor Shërbimi Shëndetësor i Kosovës, pra një mënyrë tërësisht të re e funksionimit të sistemit shëndetësor të ne, projekcioni real i një modeli të tillë është i mundur vetëm kur së bashku me këtë ligj të miratohet edhe ligji për sigurimet shëndetësore.

Te neni 41, u fol shumë, s'kam çka të them, do të thotë a është kushtetues, a s'është kushtetues, janë tjerë ata që e përcaktojnë, por këtu kisha theksuar se janë tre aktorë kryesorë, është pacienti, është personeli shëndetësor dhe është pushteti.

Ne si Komision për Shëndetësi, meqenëse shumica janë mjekë aty, besoj se na pret një punë e madhe dhe duhet të debatojmë me këta tre aktorë dhe duhet të gjejmë një zgjidhje e cila do të jetë e kënaqshme për të gjithë. Përpos aktorit të parë, që është shumë i rëndësishëm, nuk është më pak i rëndësishëm edhe personeli shëndetësor.

E tha profesori në fjalën e tij të fundit se duhet gjetur një mënyrë që menjëherë të stimulohet personeli shëndetësorë, pastaj edhe siç quhen në ligj që nëpërmjet performansës përsërit të shpërblehen, por është kusht i domosdoshëm që mos të na dështojë implementimi i këtij ligji që në start mjekët specialistë që të bëjnë një punë të madhe sidomos në klinike, në start të stimulohen.

Sa i përket, kam një vërejtje te neni 60 i këtij projektligji, ku thuhet që “institucionet publike shëndetësore të nivelit komunal mund të bëhen pjesë e Shërbimit Shëndetësorë të Kosovës”. Trajta mund nuk është në natyrën e tekstit të ligjit, sepse si e tillë ajo nuk obligon. Duke qenë kështu pra, çështja e anëtarësimit në Shërbimin Shëndetësor të Kosovës vetëm si mundësi dhe jo si detyrim, atëherë pyes, se po qe se nuk do të ekzistojë vullneti i ndonjë organizate shëndetësore komunale ose tjetër për t’u anëtarësuar në Shërbimin Shëndetësor të Kosovës, çka do të ndodhë me atë organizatë, me çfarë statusi do të funksionojë ajo, kujt do t’i japë llogari, kush do ta financojë?

Paqartësitë e kësaj natyre dhe trajta “mund” lenë shumë hapësirë për manipulime, e cila hapësirë duke ditur kontestin politik dhe tjetër ka shumë mundësi të keqpërdoret dhe për rrjedhojë ta kanosë integritetin e sistemit tonë shëndetësor. Pra, nuk duhet të lenë zbrazëti të kësaj natyre të cilat mund të keqpërdoren dhe nga kjo të krijohen organizime paralele me sistemin shëndetësor sikur ndodhë në shumë sektorë të tjerë të jetës shoqërore në vendin tonë.

Unë personalisht si deputet, por besoj që edhe deputetët e Lidhjes Demokratike, do të votojnë këtë projektligj dhe besoj që me përkushtim duke marrë parasysh që është një ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm për jetën e qytetarit tonë, mendoj që duhet të punojmë të gjithë dhe të bëjmë një ligj të mirë për shëndetësinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Falemnderit! Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë ju falënderoj të gjithëve për komentet, për paraqitjet e juaja, reflektimet e juaja në këtë dokument ligjor, më mirë të themi në këtë projektligj.

Mendoj se debati e ka reflektuar në një farë mënyre tërë atë periudhë 15- mujore të punës në këtë dokument. Pra, qëllime të mira, synime të mira, shumë moskuptime, qasje ndoshta sipërfaqësore, preokupim me detaje në momente dhe në shumë aspekte edhe harresë të realitetit tonë, i cili shkon përtej kualifikimit se gjendja në shëndetësinë kosovare është shumë e rëndë. Realiteti jonë nënkupton aspektet e marrëdhënieve fillimisht midis aktorëve të ndryshëm të jetës shoqërore dhe reflektimit të këtyre marrëdhënieve në sektorin e

shëndetësisë, çështjen e prioriteteve të një shoqërie ndaj një sektori reflekton interesa të ndryshme, partiake, grupe e të tjerë.

Nuk është thënë kot se reformat në sistemin e shëndetësisë janë reformat më të vështira për t'u zbatuar, nga teoria e ekonomikes shëndetësore janë mirë të njohura këto fakte. Pse janë të vështira, sepse janë shumë komplekse prekin në segmentet e ndryshme të shoqërisë. Duhet marrë parasysh shumë aspekte njëkohësisht, filluar nga resurset institucionale, teknologjike, njerëzore, strukturën demografike të popullatës, gjendjen ekonomike e tjerë e tjerë.

Kur e kemi dizajnuar këtë projektligj, jemi nisur mu nga ajo që e tha zotëri Gjini, si do ta bëj një projektligj i cili në fund do të rezultojë me një cilësi më të mirë të shërbimeve për qytetarët? Po për cilët qytetarë tash? Për qytetarët të cilët janë më të varfrit, për qytetarët që kanë nevojë më të madhe, për këto shërbime të mbuluara nga ana e shtetit.

Me buxhetin që e ka në dispozicion Ministria e Shëndetësisë sot dhe me atë që ne e parashohim edhe pas miratimit të Projektligjit të sigurimeve shëndetësore, ne nuk mund të llogarisim në një buxhet i cili do të jetë diku rreth 250 milionë euro për shtetin tonë edhe me atë buxhet në kushte ideale ne do të jemi larg prej standardeve ndërkombëtare në këtë aspekt.

Prandaj, është dashur që ta dizajnojmë një sistem shëndetësor i cili do të jetë në gjendje të siguroj cilësinë më të mirë të mundshme të shërbimeve shëndetësore për qytetarët e varfër në radhë të parë të cilët sot i marrin shërbimet “falas” dhe atë do të thotë shërbimet më të mira të mundshme brenda kushteve të gjendjes ekonomike, financiare në të cilat funksionon shteti ynë.

E patë edhe vetë se të njëjtat formulime ligjore te grupet e ndryshme parlamentare reflektojnë ndryshe. Për shembull u përmend nga Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike se kemi një centralizim pak më të madh të qeverisjes se sa që duhet, ndërsa nga Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes” e patëm vërejtjen se shteti duhet të jetë aktor më aktiv, nuk mund të ketë ashtu një decentralizim, një lloj liberalizmi në këtë aspekt. Po të njëjtat formulime janë po perceptohen nga njëri grup parlamentar si centralizim i tepruar, nga tjetri grup parlamentar si centralizim i mangët që flet për atë se , ta qartësoj

edhe një herë t'ju qetësoj. Bëhet fjalë për Shërbimin Kombëtar të Shëndetësisë. Shërbimi Kombëtar i Shëndetësisë kuptohet si një persistim i dorës së shtetit në sektorin e shëndetësisë, si një qeverisje që vazhdon të jetë politike, ndërsa nga grupi tjetër parlamentar se është mungesë e kësaj dore të fortë. Do të thotë është çështja se për të gjetur masën, ekuilibrin në këto aspekte kërkohet ndjeshmëri dhe njohje e mirë e realitetit.

Të nderuar deputetë,

Unë kam qenë në bankat ku jeni ju në vitin 2004, kur është miratua Projektligji i shëndetësisë 2004 dhe madje kam qenë edhe kryetar i Komisionit sa kam qenë në ministri që e ka përpiluar atë ligj...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e seancës e merr kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi)

KRYETARI: Ministër, rumbullakoj!

MINISTRI FERID AGANI: Do të thotë, ta rumbullakoj. Mendoj që ky projektligj e paraqet zgjidhjen më të mirë të mundshme aktuale me të cilën ne mund t'i qasemi problemeve në sektorin e shëndetësisë në mënyrë gjithëpërfshirëse duke i adresuar të gjitha çështjet. Njëkohësisht, ju kisha lutur për një debat edhe më tutje, pavarësisht se çka ndodhë me këtë ligj, një debat të informuar mirë, sepse për këtë lloj të debatit pritet me të vërtetë një informim i mirë për gjendjen në sektorë. Vetëm një send po ju them e debatuar çështjen e nenit 41 dhe disa herë u përmend që kemi mungesë të kuadrove, s'kemi kuadro etj. 160 specialistë janë pa punë që dy vjet në Kosovë. Prandaj, të jemi të informuar mirë kur debatojmë, unë jam i gatshëm edhe në periudhën e ardhshme, komisionet parlamentare, qëndrojnë në dispozicion maksimalisht me të gjitha njohuritë që i kam dhe me gjithë Ministrinë e Shëndetësisë, në mënyrë që në fund të dalim me një dokument ligjor i cili do t'i ofrojë sa është e mundur qëndrimet përkitazi me këtë dokument. Faleminderit!

KRYETARI: Ne kemi debatuar për tri ligje në parim.

Atëherë, po shkojmë po votojmë për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Të pranishëm 71 deputetë.

Votojmë tash!

Me 65 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për letërnjoftimin.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Tani votojmë për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologjinë. Faleminderit!

Kemi tash edhe një ardhje të re të deputetëve, pra kemi një numër më të madh.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash.

Të pranishëm 80 deputetë,

Me 77 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për metrologji.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Tani është radha e Projektligjit për shëndetësi.

Votojmë tash.

Konstatoj se me 64 vota për, 16 kundër dhe 2 abstenime, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për shëndetësi.

Kërkohej nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Dhe tani kemi ardhur te pika e tetë e rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në parim.

Ftoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza që para deputetëve të Kuvendit ta prezantoj dhe arsyetoj projektligjin. Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Deputetë të nderuar,

Më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

Ky plotësim-ndryshim i këtij ligji bazohet me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përkatësisht në nenin 8 të këtij ligji, ku sa i përket deficitit primar të buxhetit kërkon që ky deficit të jetë neutral.

Gjatë vizitës së fundit Fondit Monetar Ndërkombëtar, prej 28 majit deri më 11 qershor, një prej pikave të diskutimit ka qenë edhe rishikimi i buxhetit.

Rishikimi i buxhetit është diskutuar deri në detale dhe ne kemi arritur pajtueshmëri të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar për formatin dhe standardin, i cili është prezantuar ky dokument sot para jush.

Rishikimi i buxhetit ka ardhur edhe si nevojë e kërkesave të organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe sidomos lokal, me qëllim që t'i mundësohet fleksibilitet në punën e tyre të gjitha organizatave buxhetore, ministrive dhe komunave dhe ne këtë mundësi ua kemi dhënë dhe u kemi dhënë mundësi që brenda kategorive ekonomike t'i bëjnë riprioritetizimin apo rirangimin e prioritetëve të gjitha organizatat buxhetore.

Sa i përket fleksibilitetit për komunat ky rishikim i buxhetit është i fundit ku sa i përket të hyrave vetjake të komunave dhe do ta përcaktojmë vendosjen e tyre, ndërsa në të ardhmen ne kemi arritur pajtueshmëri që për të hyrat vetanake komunat të kenë autonomi të plotë se a do t'i përdorin për investime kapitale, për mallra e shërbime apo për subvencione.

Sa i përket indikatorëve makroekonomikë ne si Ministri e Financave kemi vlerësua se indikatorët makroekonomikë të prezantuar me rastin e aprovimit të buxhetit për vitin 2012 janë të qëndrueshëm. E kemi diskutuar edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe ne kemi ardhur në përfundim që nuk kemi nevojë ta zvogëlojmë ... e të hyrave. Ne vlerësojmë se rritja ekonomike në Kosovë për vitin 2012, do të jetë rreth 5%, inflacioni 1.2%, të hyrat në raport me GDP do të jenë 27.7%, shpenzimet primare 30.7% dhe deficitin primar i projektuar 2.4%, ndërsa ne në fund të vitit presim që dy deficit të jetë edhe më i vogël edhe si rezultat i grumbullimit të hyrave shtesë tjera po edhe si rezultat i mundësisë të nënshpenzimit në ndonjë pozicion të caktuar.

Gjatë projektimit të hyrave për buxhetin e Kosovës, ne kemi marrë për bazë edhe ecuritë edhe vështirësitë që i kemi në eurozonë dhe këto vështirësi i kemi reflektuar edhe në këtë buxhet dhe kemi qenë mjaftë të kujdesshëm me rastin e planifikimit të hyrave. Këto vështirësi në eurozonë dhe situata e përgjithshme në eurozonë, mund të ketë ndikim në eksportet, në investime dhe në remitenca edhe pse të dhënat e fundit tregojnë se sa i përket remitencave është duke u ruajtur niveli i planifikuar dhe përafërsisht i njëjtë me vitin e kaluar me një... të vogël.

Borxhi publik vazhdon të jetë në nivel mjaft të ulët që sillet vetëm rreth 5.5% e GDP.

Sa i përket të hyrave për buxhetin e Kosovës, dallim me buxhetin fillestar kemi 8 milionë të hyra shtesë më tepër në total i kemi rreth 23 milionë, 8 milionë i kemi te Doganat dhe kjo si rezultat i masave të reja të cilat janë ndërmarrë. Kemi 10 milionë më tepër te dividendat, ku me buxhetin fillestar kemi deklaruar 35 milionë, ndërsa tash i kemi 45 milionë dividendë të deklaruara. Kemi biseduar me Bordin Ekzekutiv dhe Bordin e PTK-së dhe kjo dividendë nuk e rrezikon për asnjë moment planin dhe afarizmin e kësaj ndërmarrje.

Dhe gjithashtu kemi një ndryshim prej 7 milionë më tepër te fondet e Bankës Botërore se sa buxheti fillestar.

Me rastin e aprovimit të buxhetit fillestar me të drejtë kanë mund të ngritën disa dilema siç ajo se a mund të inkasohen mjetet e planifikuara nga Banka Botërore, nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe financimi i brendshëm?

Tani në rishikim këto dilema nuk i kemi, nga Banka Botërore kanë ardhur në buxhetin e Kosovës, 37 milionë, domethënë 7 milionë më tepër se sa që kanë qenë të planifikuara me buxhetin fillestar.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka derdhur 5 milionët e parë dhe presim që rishikimi i parë i marrëveshjes stand by të përfundohet në korrik dhe gjatë muajit korrik të vijë edhe 47 milionë tjerë.

Ndërsa sa i përket financimit të brendshëm tregu i letrave me vlerë ka startuar në kohë, ka startuar sipas planifikimeve dhe deri më tani ne kemi nga ky burim rreth 30 milionë për buxhetin e Kosovës. Presim që të zhvillohen ankandet e ardhshme, presim që të rritet

maturimi i letrave me vlerë dhe të kalohet në 6 muaj maturim me qëllim që në fazën e ardhshme të kalojmë në një vjet.

Është arritur një normë e interesit rreth 3% dhe ne presim që pas aprovimit të ligjit për Trustin e Pensioneve dhe hapjen e mundësisë që edhe fondet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të investohen në letrat me vlerë, të kemi ulje të normës së interesit dhe rritje të maturimit.

Sa i përket të dalave buxhetore nga një miliard e 520 milionë sa kanë qenë të parapara me buxhetin fillestar, tash i kemi një miliard e 524 milionë. Kemi një ndryshim të vogël në strukturë të buxhetit, nga masa 407 milionë sa ka qenë e paraparë me buxhetin fillestar, tani kemi 410 milionë dhe kjo vjen kryesisht si rezultat i nevojës për fonde shtesë të pagat të Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe disa ndryshime të vogla simbolike.

Dhe, kemi një ndryshim të mallrat dhe shërbimet, kjo kryesisht për shkak se komunat kanë pasur nevojë për shkak të kushteve të vështira atmosferike në muajt e parë të këtij viti, që të kenë një lëvizje, nga kategoria kapitaleve në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe një ndryshim i vogël që është shumë simbolik të investimet kapitale që në buxhetin fillestar i kemi pasur 617 milionë dhe tash i kemi 615 milionë. Dhe, në përgjithësi kemi një përmirësim të deficitit primar ku nga buxheti fillestar prej 159 milionëve, tash i kemi 20 milionë më pak se sa buxheti fillestar.

Kemi edhe një ndryshim tjetër sa i përket financimeve të njehershme. Në buxhetin fillestar kemi pasur 300 milionë euro, ndërsa tash i kemi 330 milionë. Kjo vjen kryesisht si rezultat i ndryshimit për Ligjin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ku e dimë që 5% e të hyrave nga fondet e përgjithshme të grumbulluara nga ky institucion janë të hyrat të dedikuara që përdoren për financimin e nevojave të këtij institucioni dhe kjo vjen pastaj si rezultat i rritjes së bilancit bankar.

Disa procese janë në zhvillim, një prej tyre është edhe procesi i privatizimit të PTK-së, ne nuk paragjykojmë përfundimin e këtij procesi - a do të mbyllet suksesshëm apo si do të mbyllet edhe në çfarë vlere do të mbyllet, është tregu ai që do ta vlerësojë. Mirëpo të gjitha projektet, të gjitha shpenzimet, në të gjitha kategoritë, pavarësisht se si do të përfundojë procesi i privatizimit të PTK-së, do të kenë fonde të mjaftueshme për financimin e tyre. Dallimi do të jetë vetëm në lartësinë e rezervës buxhetore apo bilancit bankar.

Ky ish një prezantim i shkurtër, kemi brenda këtij rishikimi tri gjëra ka ndodhur, ka ndodhur transfer brenda të njëjtës organizatë buxhetore, ka ndodhur disa kursime në disa organizata buxhetore që kemi të bëjmë me rreth 10 milionë dhe nëse ju e vlerësoni, unë mund t'ua jap specifikat edhe në cilat organizata buxhetore kanë ndodhur këto kursime.

Dhe kemi rritje të fondeve për disa organizata buxhetore që gjithashtu janë rreth 10 milionë. Dhe unë vetëm po e përmend se nga fondet shtesë pa hyrë transferet e brendshme se ne transferet e brendshme brenda të njëjtës kategori ia kemi lejuar të gjitha organizatave buxhetore edhe të nivelit qendrorë edhe të nivelit lokal. Fonde shtesë kanë marrë Kuvendi i Kosovës, 226 mijë euro, Zyra e kryeministrit, 184 mijë euro, kur jemi te Zyra e kryeministrit kemi të bëjmë me krijimin e një zyre shtesë, që është vendim i Kuvendit për

punësimin e 8 anëtarëve për gjuhë edhe çështje tjera. Ministria e Financave i ka 137 mijë, Ministria e Administratës Publike, 30 mijë euro, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, 1 milion e 500 mijë, Ministria e Infrastrukturës, 1 milion e 650 mijë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, 300 mijë, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, 2 milionë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë, 800 mijë, Ministria e Drejtësisë, 55 mijë, Ministria e Punëve të Jashtme, 205 mijë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, 3 mijë euro, Instituti i Avokatit të Popullit, 44 mijë euro, Agjencia Kosovare e Pronës, 50 mijë euro dhe shpenzimet e paparashikuara të rezervave është ngritur për 931 mijë euro.

Ndërsa, në nivelin komunal, domethënë, përveç ndryshimeve që ka ndodhur brenda organizatave buxhetore, fondet shtesë kanë qenë 2 milionë e 210 mijë euro.

Deputetë të nderuar,

Ne i mirëpresim gjithë alternativat, i mirëpresim të gjitha propozimet e juaja, pse jo edhe kritikën, të gjitha propozimet tuaja ne do t'i marrim në konsideratë gjatë punës tonë në komisione, sigurisht se ka një numër të kërkesave të organizatave buxhetore që janë drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ne si Ministri e Financave dhe Qeveria në përgjithësi, do të jemi në dispozicion në Kuvend gjatë gjithë këtyre ditëve, me qëllim që ky material, i cili sot është prezantuar para juve edhe më tutje të përmirësohet dhe të begatohet.

Prandaj, duke pasur për bazë që organizatat buxhetore kanë nevojë që të vazhdojnë me ekzekutimin e buxhetit, unë ju lus që të njëjtin ta votoni dhe të vazhdojmë me punë në komisione. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Tani është radha e diskutimeve. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 26.6.2012, shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012 dhe i ka rekomanduar Kuvendit ta shqyrtojë dhe ta miratojë në parim projektligjin dhe t'i mundësohet Komisionit që të punojë më tutje në amendamentimin e tij në bazë të arsyeshmërisë së kërkesave që kanë arritur në Komision gjatë këtyre ditëve.

Në pjesën tekstuale janë bërë plotësime ndryshimet e ligjit bazë, sidomos në pjesën që ka të bëjë me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, rregullime këto të nevojshme, pas miratimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Edhe në pjesën tabelore janë bërë ndryshime në krahasim me buxhetin e miratuar në fillim të vitit, janë bërë transfere të brendshme, rialokime, ka mjete shtesë për disa projekte, por edhe kursime.

Është për t'u vlerësuar se ky rishikim është diskutuar hollësisht në misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili ishte i pranishëm në Kosovë.

Menaxhimi dhe administrimi i mirë i të hyrave tatimore, disiplina fiskale dhe përdorimi i kujdesshëm i financave publike, mbajtja e borxhit publik dhe deficitit buxhetor në kufij të lejuar, ka bërë që gjatë 6 mujorit të parë të këtij viti të rikthejmë marrëveshjen me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, është paraparë mundësia që Qeveria të rishikojë buxhetin në 6 muor dhe po thuaj se çdo vit Qeveria ka bërë rivlerësimin e buxhetit dhe ka rishikuar kuadrin makroekonomik, ka rishikuar objektivat në përputhje me zhvillimet ekonomike, si dhe ka bërë rialokimin e fondeve në strukturimin e tyre në raport me realizimin.

Është për t'u vlerësuar se ekonomia e Kosovës po ecë me një rritje ekonomike pozitive kur dihet se kriza ekonomike ka shkaktuar rënie ekonomike në ekonominë e eurozonës, por edhe në shtetet e rajonit.

Nëse e analizojmë mirë këtë projektligj vërejmë se rishikimi i buxhetit është bërë me qëllim që organizatat buxhetore, sidomos ato komunale të kenë fleksibilitet më të madh ashtu siç e tha edhe ministri dhe mundësi për t'i bërë rregullimet e brendshme, si dhe alokimet e nevojshme.

Gjatë këtij 6 mujori vërehet se ka pasur një kursim prej 10 milionë euro, të cilat nëpërmjet këtij projektligji janë shpërnda nëpër kategori tjera buxhetore konform nevojave.

Në periudhën 5 mujore ka një rritje pozitive të hyrave buxhetore sidomos të hyrave doganore.

Nga rishikimi vërejmë se te pjesa e të hyrave ka lëvizje pozitive nga një miliard e 361 milionë euro, në një miliard e 384 milionë euro, që ka lëvizje pozitive për 23 milionë euro.

Kurse te pjesa e shpenzimeve ka rritje nga një miliard e 520 milionë në një miliard e 524 milionë që do të thotë që ka rritje për 4 milionë euro.

Nëse analizojmë tabelën 2, përmbledhja e ndarjeve buxhetore, vërejmë se buxheti i institucioneve qendrore është për një miliard e 370 milionë euro apo 0.40% më i ulët se buxheti fillestar.

Buxheti i nivelit komunal është për 1,38% më i lartë se buxheti fillestar kurse të Agjencia Kosovare e Privatizimit, pas rregullimeve të cilat janë bërë sipas Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është për 69,62% më i lartë se buxheti fillestar.

Kam për obligim t'i thekson edhe disa çështje të cilat janë ngritur nga deputetët në Komisionin për Buxhet dhe Financa.

Deputetët e kanë vlerësuar si të nevojshme të sillen nga Qeveria një analizë makroekonomike financiare më të detajuar, e cila do të ofronte informata se si është situata ekonomike dhe financiare në vend.

Çështje tjetër që është ngritur në Komision ishte bilanci bankar, sipas deputetëve rezerva e detyrueshme bankare krijon stabilitet, por njëkohësisht edhe bllokun mjetet të cilat nuk mund të shfrytëzohen.

Rezerva bankare duhet të jetë më e matur, të përcaktohet se cili është niveli optimal i bilancit bankar i cili i ndihmon zhvillimit ekonomik, ishte rekomandimi i anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Çështja e rritjes së kategorisë së pagave po ashtu është ngritur në Komision ku sipas ministrit kjo ka të bëjë me pagat e Agjencisë të Privatizimit ku pagat e tyre kanë kaluar në ngarkesë të buxhetit të Kosovës dhe nuk ka rritje tjetër tek pozicioni i pagave.

Anëtarët e Komisionit në fund e kanë vlerësuar nevojën për rishikim të buxhetit dhe pas diskutimeve rekomandojmë që të miratohet plotësim-ndryshimi i Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Prandaj, ftoj deputetët që ta përkrahin këtë projektligj për plotësim-ndryshimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Nëse më lejohej kisha folur edhe në emër të Grupit Parlamentar që të mos marrë fjalën më vonë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar me kujdes plotësim-ndryshimet në Ligjin e buxhetit për vitin 2012, i ka vlerësuar si ndryshime të cilat kanë qenë më së të nevojshme për t'u bërë dhe ka vlerësuar rialokimet dhe plotësimet, të cilat janë bërë nëpër organizatat buxhetore.

Me qenë se kërkesa ka ardhur nga shumica e organizatave buxhetore. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka përkrahur plotësim-ndryshimin e Projektligjit për ndryshimin e Ligjit për buxhetin e vitit 2012 dhe rekomandon që të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Sali Asllanaj.

SALI ASLLANAJ: Falemnderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së të konstatoj që LDK-ja nuk do ta votojë këtë projekt- ndryshim për arsye të thjeshta që nuk e ka votua as ligjin bazë Ligjin e buxhetit për vitin 2012 dhe këto ndryshime janë simbolike, janë të vogla dhe në këtë aspekt mendoj që arsyeja bazike është kjo.

Por më lejoni pak që të ndalem pak edhe në analizë të këtij projektligji duke konstatuar që realisht, unë personalisht dhe Grupi Parlamentar i LDK-së, ka pritur që me këtë projekt-

ndryshim të ndodhin ndoshta edhe krijimi i fondeve të reja të cilat do të bënin të mundur aplikimin e Ligjit për pensionistët , i cili është diku në procedurë, pastaj Ligji për veteranët e luftës i cili është premtuar që me pastrimin e listave do të gjendet financimi për ta, Ligji për financimin e partive politike, një ligj që sot me një konsensus e kemi arritur dhe nuk kemi parë kurrfarë fondi të krijuar për këtë destinim dhe si kundër shpërblim më lejoni të konstatoj, i nderuar zoti ministër, që qytetarët, pensionistët, të punësuarit kanë marrë si shpërblim taksën e rritur për goma të vjetra, taksën për qese të plastikës, taksën për poçet elektrike, taksën ekologjike dhe kësaj i shtohet edhe shtrenjtimi i rrymës. Kjo flet për një degradim të mirëqenies sociale edhe ashtu skajshmërisht të cenuar të qytetarëve tanë.

Prandaj, këto janë disa arsye të cilat na bëjnë që këtë projekt-ndryshim të mos e aprovojmë ne Grupi Parlamentar i LDK-së. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të “Vetëvendosjes”, kryetari Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Pra, siç u tha pak më herët ky buxhet, ky rishikim i buxhetit, nuk bën ndonjë ndryshim thelbësor, domethënë, në buxhetin i cili është miratuar nga ky Kuvend, në vitin 2012, të cilin ne e kemi votuar “kundër” për arsye që kemi përmendur atëherë.

Dhe këto ndryshime kozmetike vetëm sa njëfarë mënyre janë për ta përmirësuar pak pozicionin financiar të Kosovës, karshi të këtij 6 mujori që ka mbetur deri në fund të vitit, mirëpo, mua po më duket pak interesante kjo, ato që edhe i tha ministri edhe kryetarja e Komisionit, domethënë disa kështu vlerësime për suksesin ekonomik të Kosovës, përkundër krizës ekonomike në eurozonë dhe në rajon, pastaj se si ky buxhet do ta reflektojë këtë sukses dhe kështu me radhë, që mua po më duket pak si hiperbolizim absolutisht i pavërtetë edhe i pasaktë i asaj çfarë e kemi parë që 6 muaj. Domethënë, nëse e kemi një buxhet i cili është i njëjti me këtë 6 mujor, si u bë që tash për këtë 6 mujorin e dytë ky buxhet i rishikuar, automatikisht po reflektuaka këtë farë shpërthimi ekonomik të Kosovës, të cilin të gjithë po thonë që nuk ka për të ndodhur, përveç, ndoshta Qeverisë së Kosovës.

Një çështje tjetër është që ministri e përmendi që rritja e të hyrave për sa i përket tatimeve është rritje qind për qind e doganave. Për shkak të ndryshimeve që janë bërë në sistemin doganor, pra kjo jo domosdoshmërisht nënkupton që të rritet importi, por ka mundësi që edhe për shkak të rritjes së importit ose rritjes së çmimit të importit, do të na reflektojë kjo. Por, është interesante se shumica e planifikuar dhe e projektuar për t’u mbledhur nga të hyrat vendore, nuk kanë ndryshuar fare në këtë rishikim. Pra, ka qenë 288.000.000 euro ka mbetur 288 milionë euro.

Kjo nënkupton në terma shumë të vrazhdë makroekonomikë që në fakt ne nuk planifikojmë të kemi ndonjë rritje të kapacitetit të brendshëm të mbledhjes së tatimeve e as në rritje të kapacitetit të brendshëm që gjeneron kesi tatime, po eventualisht do të kemi rritje të importit ose do të kemi ndryshime për sa i përket rritjes së taksave të importit që hynë në Kosovë dhe rrjedhimisht do të kemi edhe këtë rritje të të hyrave. Pra, kjo nuk është

reflektim për mendimin tim i ndonjë suksesi ekonomik të Kosovës, është pak a shumë si të them, mjete, mekanizëm që Qeveria e Kosovës e ka përdorur duke i rritur tatimet për ta ruajtur sadopak shëndetësinë financiare dhe fiskale të vendit, e cila edhe ministri, njëfarë mënyre në mënyrë indirekte e pranoi që ka qenë dhe mbetet e rrezikuar.

Një çështje tjetër që kisha dashur ta ngrit dhe kjo është e fundit natyrisht, është te numrat që ndryshojnë pak a shumë prej buxhetit origjinal të vitit 2012, e kisha dashur këtu të ndalem kryesisht te kjo te dividendat e cila u tha që po rritet kryekëput si meritë e Postës dhe Telekomit të Kosovës, pra 10.000.000 i shtohet 35.000.000 që është planifikuar të merret nga kjo kompani, të cilën prapë ministri mendon që ne duhet ta shesim, pra ta privatizojmë që të humbim këtë mundësi të marrim dividendë nga ajo dhe një çështje tjetër që kisha dashur po ashtu, ta përmend në këtë është te financimi i njëhershëm.

Është një shifër e cila vazhdimisht po na ndjek në buxhet pas buxheti përherë me arsyetimin se ne nuk paragjykojmë asgjë, nuk paragjykojmë se do t'i privatizojmë kompaninë, ndërkohë që planifikojnë se do t'i marrin 300.000.000 euro nga privatizimi i këtyre kompanive. Unë s'po e kuptoj qysh mund të mos paragjykohet privatizimi në njërën anë, por pastaj për t'i bërë llogaritë buxhetore duke u bazuar në një 300.000.000 i cili do të na vijë nga privatizimi. Pra, kjo është një shumë që ka filluar me 300.000.000 dhe ka mbetur 300.000.000, si një lloj shumë fiktive, të cilën ne e përdorim ose Qeveria në këtë rast e përdor në secilin buxhet për ta mbuluar sadopak një zbrazëti aty dhe njëfarë mënyre për të na qitur hi syve se megjithatë nuk i kemi punët aq keq financiarisht se ja e kemi një 300.000.000 i cili me njëfarë shkopi magjik mund të na vijë në Kosovë.

Pra, Lëvizja Vetëvendosje nuk mund ta votojë këtë rishikim të buxhetit për shkak se nuk ka ndryshime substanciale në të dhe ne e kemi kundërshtuar substancialisht këtë mënyrë të buxhetimit për shkak se e shohim si një buxhetim, i cili është tash me rishikim, veçanërisht goxha shumë i brengosur në kursime se sa që është në investime të mirëfillta në ekonomi dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës dhe unë si anëtarë i Komisionit të Buxhetit, në fillim të gjithë anëtarët e Komisionit, kemi përkrahur në parim rishikimin e buxhetit, përveç një vote që ka abstenuar. Dhe, e kemi pasur një anëtarë të Komisionit që ka nevojë që buxheti të rishikohet, për arsye se komunat kanë pasur disa vështirësi edhe financiare, sidomos gjatë kohës së vështirë të dimrit është dashur të bëhen ndërrime edhe të kodeve, nga një kod në kodin tjetër dhe është mjaft e rëndësishme të bëhet rishikimi.

U dëgjua edhe nga deputetët tjerë dhe nga kryetarja e Komisionit dhe nga ministri se nuk ka ndonjë ndryshim substancial të buxhetit, mirëpo me këto ndryshime dëshirohet që të realizohen disa projekte dhe të realizojnë ata komunat, të cilat nuk kanë mundur t'i

realizojnë. Në parim kërkesat tona të anëtarëve të Komisionit të Buxhetit, por edhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka qenë që të kemi shënime më të sakta rreth të dhënave për ekonominë e Kosovës, mos të marrin këto vetëm nga Banka Qendrore, por të marrin nga Ministria e Financave. Është shqetësuese që dhe kemi thënë që fondi rezervë nuk bën të rritet aq shumë për arsye se kemi edhe Fondin e Privatizimit dhe kemi edhe Fondin e Trustit Pensional, i cili është jashtë funksionit, jashtë zgjerimit, qarkullimit në Kosovë dhe edhe Fondit Monetar Ndërkombëtar i kemi thënë këtë edhe ministrit që ky fond nuk bën të jetë aq i madh për arsye se Kosova ka nevojë për mjete gjeruese dhe ka nevojë që të mos jetë jashtë qarkullimit edhe një buxhet i tërë ose një buxhet i tërë i ngrirë.

Besoj që kërkesat, të cilat i kemi bërë në komision për Buxhet dhe Financa nga ana e Aleancës, shpresoj se do të merren parasysh nga ana e ministrit dhe me këtë qëllim e përkrahim në leximin e parë dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit në pjesën tjetër si komision. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re deputeti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Edhe Koalicioni për Kosovën e Re e mbështet rishikimin e buxhetit edhe gjithashtu raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ne japim mbështetje dhe i kuptojmë arsyet që i tha ministri këtu, megjithatë mbetet një dilemë për mua personalisht, a ia vlen të harxhojmë kaq shumë kohë dhe kaq shumë energji në diskutimet vijuese që do t'i kem për ndryshimet, të cilat nuk janë esenciale dhe të cilat ndoshta kanë mundur që të harmonizohen brenda autorizimeve të Qeverisë, Ministrisë dhe agjencive buxhetore. Për arsye se do të kërkojnë mjaftë kohë, shpenzime, energji procedurat në rishikimin e buxhetit.

Kjo do të ishte natyrisht e dobishme në qoftë se domethënë diskutohet në esencë për situatën financiare dhe diskutohet si të rritet performansa dhe efektiviteti në shfrytëzimin e fondeve publike, por kam frikën që ne do të humbim shumë kohë në shqyrtimin e shumë kërkesave nga agjencitë buxhetore, apetiti i të cilave është rritur mjaftë me faktin se ato janë formuar se do të ketë rishikim, kurse objektivist Komisioni për Buxhet brenda këtyre kufizimeve që janë dhënë do të ketë shumë pak mundësi që t'u përgjigjet kërkesave të këtyre agjencive buxhetore.

Ajo që unë dëshiroj kështu si deputet ta theksoj edhe mendoj se e kemi diskutuar edhe me ministrin edhe në Komision, na kemi nevojë që ta analizojmë në mënyrë kritike metodologjinë e prezantimit të dokumenteve të buxhetit dhe buxhetimit. Duhet të shohim se sa këto dokumente dhe kjo mënyrë e prezantimit e cila unë e kuptoj se është një prezantim i këshilltarëve të ndryshëm nëpër ministritë tona, në qoftë se janë ata të jashtëm apo të brendshëm, por ne kemi nevojë që të kemi një prezantim, një metodologji që është më miqësore për deputetin edhe për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit, sepse prezantimi i buxhetit duhet të jetë i qartë, duhet të jetë miqësor, duhet të tregojë gjithçka që na mundëson që të kemi një transparencë.

Dikush do të thotë: “Gjithçka është, gjithë shifrat janë dhe transparent është”. Unë pajtohem, gjithë shifrat janë aty, por, në qoftë se e shihni për shembull në tabela e keni vitin 2011 edhe vitin 2012, tash na duhet të shkojmë ta marrim buxhetin që e kemi aprovuar, buxhetin e aprovuar të shohim sa ka ndryshuar ky me rishikim. Në vend që ta kemi një tabelë, këto pozicione janë ndryshuar, në 2011 ka qenë kaq, buxhetin që e kemi të aprovuar në 2012 është kaq edhe ndryshimi është kaq. Dhe, këtu është diferenca, dhe një arsyetim për secilën diferencë. Ministri i arsyetoi sot shumicën e sendeve shumë mirë, por deputetët kanë nevojë që të kenë një arsyetim për çështjet makroekonomike dhe për arsyeshmërinë e këtyre ndryshimeve që i kemi këtu. Prandaj, unë ju propozoj që të ardhmen edhe në Ministri edhe Qeveritë të mendojnë seriozisht që na e bëjnë punën më të lehtë me këto tabela, me këto buxhete, sepse numrat janë të rëndësishëm, por më e rëndësishmja është arsyeshmëria, filozofia, trendi makroekonomik, efektet sociale, efektet ekonomike, këto janë esenciale për neve a votojmë a s’votojmë. Dhe, kjo është e nevojshme, po them.

Unë për veti mund të gjendem diqysh, domethënë, por unë mendoj se shumica e deputetëve e kanë problem. A, edhe mu më duhet shumë kohë të harxhoj derisa t’i bie në fije krejt situatës këtu. Kështu që besoj që me një punë, besoj që me ministri edhe me Qeveri, me një punë mund të përmirësohet shumë kjo situatë. Ajo që u tha për rezervën bankare nuk dua me e përsëritë e përkrahi raportin e Komisionit. Mendoj se është në interes të Kosovës edhe në interes të rritjes ekonomike dhe stabilitetit duhet të gjendet një drejtpeshim për stabilitetin makroekonomik fiskal dhe për rritjen ekonomike.

Në qoftë se rezerva bankare, fondi bankar është i madh, është mirë për stabilitet, por jo mirë për rritje ekonomike dhe anasjelltas. Edhe politika të mira janë ato që e bien një drejtpeshim taman. Mua po më duket që ky drejtpeshim ka nevojë të rishikohet dhe të rirregullohet. Në këtë në fund të fundit ia kemi prezantuar edhe Fondit Monetar, se unë e di që Fondi Monetar Ndërkombëtar, është duke bërë presion, po supozoj, s’e di, s’kam qenë aty, por po supozoj që Fondi Monetar po kërkon të rriten këto mjete edhe mu mobilizuar aty në një bilanc bankar, ajo duhet të rishqyrtohet, ne kemi kërkuar... Komisioni për Buxhet, kemi pasur një takim me fondin e kemi thënë që duhet këto sende të shikohen pak më një drejtpeshim pak më racional të gjendet në këtë situatë. Ju faleminderit edhe ju dëshirojmë sukses në realizimin e këtij buxheti!

KRYETARI: Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIČ: Hvala, predsedavajući!

Poštovani ministri i kolege,

Poslanička Grupa Samostalne Liberalne Stranke i kroz rad komisije i iz materijala koji je dostavljen poslanicima, radila je na tekstu rebalansa budžeta i za njega će uz isticanje naših najvećih zamerki glasati.

I kod usvajanja budžeta i sada kada se radi njegov rebalans, znamo da budžet Kosova ne može da pokrije sve njegove potrebe, zato smo želeli da realno sagledamo da li je ova preraspodela učinjena u skladu sa osnovnim principima budžetiranja.

Naša najveća zamerka na ovom budžetu je da on osim putne infrastrukture neće imati infrastrukturne objekte u srpskim sredinama. Šta više, ugroženi su već započeti projekti, poput bolnice u srpskim sredinama. Nadam se da će resorna ministarstva u dogovoru sa lokalnim samoupravama iznaći rešenje iz ove situacije.

Takođe, preporuke iz progresa i porta Evropske Komisije jasno su istakle ocene da budžet Ministarstva za Povratak nije dovoljan i da ga treba povećati, međutim predloženi rebalans ne tretira ovo pitanje. Svesni smo stanja u privredi i problema sa punjenjem budžeta, ali mislimo da treba iznaći način da se on učini pravednijim i u interesu svih građana na Kosovu, što ćemo pokušati da popravimo amandmanima do konačnog usvajanja rebalansa budžeta. Hvala Vam!

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah rishikimin e buxhetit për vitin 2012 me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në parim do ta votojë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Hasime Krasniqi e ka fjalën.

HASIME KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar ministra,
Kolegë deputetë,
Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012, është i përgatitur në mënyrën më profesionale të mundshme dhe ofron të dhëna të detajuara për leximin e parë.

Me këtë plotësim -ndryshim, konkretisht do të ndalem në një kërkesë drejtuar ministrit të Arsimit dhe ministrit për Financa, duke kërkuar mjete shtesë për dy shkolla të mesme të kompetencës në Malishevë dhe Skenderaj, në të cilat për herë të parë hapen klasat e dymbëdhjeta nga shtatori i vitit 2012 dhe për të cilat nuk kanë mjete buxhetore për fillimin e këtij viti shkollor. Atëherë, kërkoj konkretisht tek arsimi i mesëm në Malishevë dhe Skenderaj, kategoria paga dhe mëditje, të shtohen mjete të nevojshme financiare dhe të lejohet punësimi për mësimdhënës të nevojshëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Po ashtu, në kategori mallra dhe shërbime, për këto dy shkolla të lejohen mjete të nevojshme financiare për mirëmbajtjen e këtyre shkollave, të cilat kanë një hapësirë të madhe të standardeve evropiane. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe unë dua ta përshëndes ardhjen e Projektbuxhetit, ose rishikimit e projektbuxhetit për rishqyrtim dhe faktikisht atë çka unë kisha paraparë që të diskutoj në këtë seancë veç u përmend nga deputetja, parafolësja jona, zonja Hasime Krasniqi. Gjithashtu të njëjtën kërkesë e kisha edhe unë për këto dy shkolla të mesme në Malishevë edhe në Skenderaj, duke pas parasysh që në këto dy shkolla është bërë një investim shumë i madh nga përkrahja e Qeverisë norvegjeze dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kërkoj nga dy ministrat kompetentë që këtë çështje ta shqyrtojnë edhe njëherë dhe me të vërtetë këtyre shkollave t'ua japin thjeshtë vlerësimin e merituar dhe të krijojnë kushte për punë nga cilat shkolla presin shumë, si qytetarët e Skenderajt me rrethinë, ashtu edhe qytetarët e Malishevës. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Dëshiroj t'i falënderoj të gjithë deputetët për diskutimet e tyre. Sigurisht se ne gjatë punës në komisione do të bëjmë përpjekje brenda mundësive reale buxhetore, të reflektojmë në diskutimet dhe kërkesat e tyre.

Vetëm një sqarim të vogël desha ta jap , me këtë po e përfundoj se Ligji për pensionet është proceduar nga Qeveria në Kuvend dhe qysh me buxhetin fillestar kostoja e këtij ligji ka qenë e paraparë në buxhet. Ne presim që Kuvendi ta aprovojë këtë ligj, varësisht në çfarë formati, në çfarë forme e aprovon këtë ligj nëse kostoja është e mjaftueshme, atëherë fillon zbatimi i këtij ligji. Nëse ka kosto shtesë mbi këtë çka kemi paraparë, ne jemi të detyruar që ta mbulojmë koston e këtij ligji. Unë edhe njëherë dëshiroj t'ju falënderoj dhe për shkak të rëndësisë të këtij projektligji për plotësim- ndryshimin e Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, ju lus që të njëjtin ta votoni. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Falemnderit! Atëherë, shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Të pranishëm janë 81 deputetë. Me 50 vota për, 26 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/ L-079 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2012. Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin sa më të shpejtë të mundshëm, ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën e 9 të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve në Bordin e Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe Kuvendit i ka rekomanduar që ta miratojë.

Ftoj kryetaren e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me nenin 62 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur, më 12.6.2012, ka shqyrtuar propozim- vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve në Bordin e pavarur për shqyrtimin e ankesave dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të miratojë këtë rekomandim.

Në bazë të nenit 4 dhe nenit 6, paragrafi 2, të Ligjit nr. 04-L102 për ndryshim dhe plotësim në Ligjin nr. 3 – L 222 për Administratën Tatimore dhe procedura, Bordi i pavarur për shqyrtim i themeluar sipas këtij ligji është përgjegjës për të pranuar dhe për t’u marrë me të gjitha ankesat e tatimpaguesve, të cilat duhet të dorëzohen deri më 30 nëntor të vitit 2012 dhe të atyre të pazgjidhura deri në atë kohë në pajtim me juridiksionin e caktuar nga ky ligj.

Të gjitha rastet e pazgjidhura në bord para datës 30 nëntor 2012, duhet të shqyrtohen dhe të vendoset nga i njëjti, jo më vonë se deri më 31 dhjetor të vitit 2013. Komisioni ka shqyrtuar këtë propozim të Qeverisë dhe ka ardhur në përfundim se anëtarët e propozuar kanë përgatitjen profesionale, kanë eksperiencën në fushën përkatëse dhe në këtë mënyrë përmbushin kushtet ligjore të parapara me Ligjin për Administratën Tatimore dhe procedurat, si dhe Ligjin për plotësim- ndryshimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Komisioni i rekomandon Kuvendit të miratojë propozim-vendimin e Qeverisë dhe njëkohësisht mandati i anëtarëve duhet të jetë në pajtim me mandatin e bordit të përcaktuar në ligj për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A e kreve edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike? Mirë! Në emër të Lidhjes Demokratike, kryetari Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Ne duke i parë edhe CV-t ose të dhënat për këta kandidatë ose të propozuar, Grupi Parlamentar i LDK-së, meqenëse këta votohen në pako, sigurisht mund të ketë ndonjë vërejtje eventuale, por megjithatë si propozim e pranojmë dhe do të votojmë “për”.

KRYETARI: Falemnderit! Nga “Vetëvendosja”, kryetari Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e ka shprehur disa herë këtë çështje dhe prapë po më duhet ta përsëris këtu, por është shumë e padrejtë ndaj disave individëve që po na vijnë për t’i votuar me një pako prej katër personash, të cilët natyrisht as nga përgatitja

profesionale e as nga përgatitjet tjera nuk janë të njëjtë. Rrjedhimisht ne po obligohemi ta marrim një qëndrim të caktuar karshi disa personave, të cilët sigurisht se e meritojnë një qëndrim tjetër, mirëpo, meqenëse janë pjesë e pakos, nuk po mundemi ta ndryshojmë atë qëllim.

Unë mendoj që këto çështje duhen votuar, e kam thënë disa herë këtu në Kuvend, duhet votuar një nga një, për shkak se këta janë persona edhe pse po kandidojnë ose po kërkohet këtu që të emërohet për një bord të caktuar të njëjtë, janë persona të cilët vijnë nga prapavijat e ndryshme profesionale, të përvojës e kështu me radhë dhe rrjedhimisht, qëndrimi karshi këtyre nuk mund të jetë i njëjtë edhe njëjtësues.

Për shkak se këta nuk janë të njëjtë e as të njëjtësuar, rrjedhimisht Lëvizja “Vetëvendosje” do të abstenojë në këtë drejtim, meqenëse nuk mund t’i votojmë të katërtit edhe pse do të kishim dashur t’i votojmë disa “për”. Por, një çështje që desha ta ngre këtu është një pyetje më shumë se sa çështje ndoshta, çka vërejta këtu te këtu CV-it që janë dorëzuar, pra as këto nuk janë të një standardi. Së pari nuk janë të një standardi profesional, disa prej CV-ve janë shumë mirë të shkruara, shumë të detajuara, ndërkohë që CV-ja e katërt është një faqe e gjysmë tekst, domethënë, që është si një lloj përshkrimi. Por, çka është interesante që e vërejta unë këtu është që për sa i përket dy anëtarëve shqiptarë të këtij ose dy të propozuarve shqiptarë, pra Artan Çerkinit dhe Refik Ramaj, i kemi CV-të e tyre në gjuhën shqipe dhe serbe, ndërkohë që për të tjerët i kemi vetëm në gjuhën serbe edhe këtë nuk e kuptova pse.

Pra, a nënkupton kjo që kur shqiptarët i drejtohen institucioneve duhet t’u drejtohen në dy gjuhë zyrtare që po konsiderohen në Kosovë, ndërsa, kur të tjerët i drejtohen vetëm në gjuhën e tyre apo çka është kjo? Edhe kjo është pyetje për Qeverinë, meqenëse Qeveria na i ka sjell këta persona si propozim në Kuvend.

Pra, pse nuk i kemi CV-të e tyre po ashtu në gjuhën shqipe?

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të AAK-së, kryetari i Grupit Parlamentar, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Falemnderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës do t’i votojë kandidatët e propozuar. Qëllimi kryesor i kësaj është që të mos ndikojmë edhe më tej në politizimin e njerëzve të njëjtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja e Grupit Parlamentar, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Koalicioni për Kosovë të Re do të përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe do t’ua japë votën këtyre personave. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, deputetja Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Hvala, predsedniče!

I Samostalna Liberalna Stranka podržaće predlog Komisije za Budžet i Financije ovog borda i mi ćemo ga ujedno izglasati.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të grupit “6+”, deputetja Duda Balje.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Parlamentarna Grupa “6+” podržaće sva četiri kandidata, jer smatramo da ispunjavaju sve uslove i da će biti na nivou zadataka. Hvala, Vam!

KRYETARI: Është kryer me grupet parlamentare. Fjalën e ka kërkuar deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem!

Poštovani predsedniče,

Predstavnici vlade,

Kolege poslanici,

Htela bih da se zahvalim svim članovima Komisije za Budžet i Financije na predlogu kandidata za članove u Nezavisnom Odboru za razmatranje žalbi i da zatražim podršku svih poslanika, bez obzira na političko i nacionalno opredeljenje, da podrže kandidata ispred bošnjačke zajednice, gospodina Ćemalja Smajli. Njegova biografija, koja je svima vama postavljena u pismenoj formi, govori o njegovom dugogodišnjem angažovanju i doprinos u celokupnom kosovskom društvu iz sfere ekonomije i socijalne politike, tako da će njegovo imenovanje za člana dati veliki doprinos razvoju demokratskog društva u celini u našoj zemlji. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi të lajmëruar. Shkojmë në votim. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Të pranishëm janë 69 deputetë.

Konstatohet se me 50 vota për, 4 kundër, 12 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave, me mandat deri më 31 dhjetor 2013, si në vijim:

1. Artan Çerkini, anëtar,
2. Refik Ramaj, anëtar,
3. Qemajl Smajli, anëtar,
4. Dragan Gjorgoviq, anëtar.

Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës:

10. Emërimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur, më 25 qershor 2012 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit, që deri në mbledhjen plenare, më 28 qershor 2012, t'i

propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që t'i paraqesin kandidatët për këtë komision.

Adem Grabovci, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar e ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky bord, ka propozuar Idriz Vehapin dhe Xhevahire Izmakun për anëtarë të këtij bordi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Grupit të LDK-së, Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zotni kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka dy propozime për anëtarë për Komisionin ad hoc, dhe atë, zotin Lutfi Haziri dhe Arben Gashi.

Po ashtu, zoti kryetar, ne kemi edhe një kërkesë, që të shqyrtohet mundësia që këtë Komision ad hoc ta udhëheqë opozita, për arsye se të gjitha komisionet tjera ad hoc, realisht i udhëheq pozita. Dhe, ju e dini që edhe në praktikën tonë, gjatë ndarjes së komisioneve kjo është e mundshme dhe po ndodh kemi edhe komisione që i udhëheq opozita. Prandaj, edhe këtë komision, konsiderojmë që është e arsyeshme ta udhëheqë dikush nga opozita. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga “Vetëvendosja”, Visar Ymeri kryetari i Grupit.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë deputetin Afrim Kasolli, si anëtar i këtij komisioni.

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Aleanca propozon deputeten Teuta Haxhiu, për anëtare të Komisionit ad hoc. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Koalicioni për Kosovë të Re, kryetarja e Komisionit, deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar! Për këtë komision, Koalicioni për Kosovë të Re, e propozon zotin Jeton Svircën.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i SLS-së, Sasha, kryetari i Grupit.

SAŠA MILOSAVLEVIČ: Hvala, gospodine predsednič!

I predlog SLS-a za formiranje ad hoc komisije za izbor članova RTK, je Milivoje Stanojević.

KRYETARI: Falemnderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kryetari i Grupit e ka fjalën. Myfera Shinik e ka fjalën!

MUFERRA ŞINIK: Teşekkür ederim sayın başkan,
Bu ad hoc komisyona üye olarak “6+” Parlamenter Grubundan Albert Kinoli’yi öneriyoruz.

KRYETARI: Faleminderit! Sa deputetë i kemi? 68 janë të pranishëm. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, asnjë kundër, Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit Ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radio-Televizionit të Kosovës që të veprojnë në përputhje me nenin 26, pika 2.3 të Ligjit nr. 04/ L 046 për Radio-Televizionin e Kosovës. Dhe, me këtë e kemi përfunduar mbledhjen e sotme. Mirupafshim në mbledhjen e radhës!

E përgatiti: Njësia për Transkriptim dhe Lekturë